



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT



METODOLOGJIA DHE INSTRUMENTET PËR VLERËSIMIN E NIVELIT TË KOMPETENCAVE DIGJITALE TË MËSUESVE NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

KORRIK 2025

www.ascap.edu.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 4850/Prot.
2

Tiranë, më 26.08. 2025

URDHËR

Nr. 410, datë 26.08. 2025

PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË DHE INSTRUMENTET PËR VLERËSIMIN E
NIVELIT TË KOMPETENCAVE DIGJITALE TË MËSUESVE NË ARSIMIN
PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të pikës 2 të nenit 26, të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shkronjës “d” të pikës 5 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 98, datë 27.02.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar” dhe të urdhrit nr. 609, datë 20.12.2024 “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit znj. Orjana Osmani”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e “Metodologjisë dhe instrumentet për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve në arsimin parauniversitar”, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTRI

ORJANA OSMANI



Grupi koordinues:

Gerti Janaqi, Drejtor i Përgjithshëm, ASCAP;

Teuta Çobaj, Drejtor, në Drejtorinë e Vlerësimit të Cilësisë, ASCAP;

Eniana Veli, Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit të Zbatimit të Cilësisë, në Drejtorinë e Vlerësimit të Cilësisë, ASCAP;

Majlinda Ucaj, Përgjegjëse e Sektorit të Vlerësimit të Organizimit dhe Drejtimit në APU, në Drejtorinë e Vlerësimit të Cilësisë, ASCAP.

Bashkëpunuan:

- Shkëlqim Allkaj, Drejtor, në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve, MAS;
- Dorina Rapti, Drejtor, në Drejtorinë e Kurrikulës dhe Kualifikimit, ASCAP;
- Eriksen Mersinllari, Specialist, në Drejtorinë e Kurrikulës dhe Kualifikimit, ASCAP;
- Rezarta Basha, Drejtor në Drejtorinë e Vlerësimit dhe Inspektimit, AKAP;
- Nikolin Gërmenji, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit dhe Vlerësimit të Kurrikulës dhe Zhvillimit Profesional, DRAP Korçë;
- Elira Smakaj, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës, ZVAP Shkodër;
- Emanuela Garuli, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës, ZVAP Berat;
- Sulejman Keta, Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kurrikulës, ZVAP Tiranë;
- Majlinda Ziu, Drejtor i gjimnazit “Sami Frashëri”, Tiranë;
- Ekelejda Alizoti, Drejtor i gjimnazit “Gjergj Kastrioti”, Durrës;
- Entela Burazeri, Nëndrejtor i gjimnazit “Petro Nini Luarasi”, Tiranë;
- Erjeta Laçe, Drejtor i shkollës 9-vjeçare “Ismail Qemali”, Shkodër;
- Laura Shuteriqi, Nëndrejtor i shkollës fillore “Sabahudin Gabrani”, Tiranë ;
- Eralda Marku, Drejtor i shkollës 9-vjeçare “Jani Minga”, Vlorë;
- Violanda Pula, Drejtor i shkollës 9-vjeçare “Hasan Vogli”, Tiranë;
- Trëndafil Guni, Koordinatore e cilësisë, në gjimnazin “Petro Nini Luarasi”, Tiranë;
- Skerdiana Dollani, Mësuese në shkollën 9-vjeçare “Hasan Vogli”, Tiranë.

TABELA E PËRMBAJTJES

TABELA E PËRMBAJTJES	3
HYRJE	5
QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT	6
KONTEKSTI I DIGJITALIZIMIT TË ARSIMIT	7
Panorama globale e digjitalizimit në arsim.....	7
Arsimi shqiptar në epokën digjitale.....	9
<i>Strategjitë dhe politikat</i>	9
<i>Gjendja e tanishme dhe zhvillimet në arsimin digjital</i>	13
AKTORËT DHE ROLET NË ZBATIMIN E METODOLOGJISË.....	16
Përfituesit dhe palët e interesuara.....	16
Detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve	20
PARIMET E VLERËSIMIT	26
FUSHAT E VLERËSIMIT TË NIVELIT TË KOMPETENCAVE DIGJITALE	28
Fusha 1: Angazhimi profesional	29
<i>Treguesit dhe përshkruesit për fushën 1: Angazhimit Profesional</i>	31
Fusha 2: Burimet digjitale.....	33
<i>Treguesit dhe përshkruesit e fushës: Burimet digjitale</i>	35
Fusha 3: Mësimdhënia dhe të nxënit e pajisur me teknologji.....	38
<i>Treguesit dhe përshkruesit për fushën: Mësimdhënia dhe të nxënit e pajisur me teknologji</i>	40
Fusha 4: Vlerësimi.....	43
<i>Treguesit dhe përshkruesit për fushën: Vlerësimi</i>	45
Fusha 5: Fuqizimi i nxënësve.....	49
<i>Treguesit dhe përshkruesit për fushën: Fuqizimi i nxënësve</i>	50
Fusha 6: Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve	55
SHKALLËT E VLERËSIMIT	59
NIVELET E KOMPETENCAVE DIGJITALE TË MËSUESVE	63

Nivelet e vlerësimit të fushës 1: Angazhimi profesional	63
Nivelet e vlerësimit të fushës 2: Burimeve digjitale	72
Nivelet e vlerësimit të fushës 3: Mësimdhënia dhe të nxënësve të pajisur me teknologji	84
Nivelet e vlerësimit të fushës 4: Vlerësimi	100
Nivelet e vlerësimit të fushës 5: Fuqizimi i nxënësve	118
Nivelet e vlerësimit të fushës 6: Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve	139
METODOLOGJIA E VLERËSIMIT	155
Metodat e vlerësimit	156
Teknika për vlerësimin e kompetencave digjitale të mësuesve	157
Procesi i vlerësimit	160
Instrumentet e vlerësimit të kompetencave digjitale	162
SFIDAT NË VLERËSIMIN E KOMPETENCAVE DIGJITALE TË MËSUESVE.....	168
PËRKUFIZIMET DHE TERMINOLOGJIA	176
BAZA LIGJORE	182
BURIME DHE REFERENCA	185
SHTOJCA.....	189
Instrumenti i vlerësimit/vetëvlerësimit	189
Formati i platformës së vlerësimit.....	209
Formati i raportit të vlerësimit	213
Pyetësorë për prindërit, nxënësit dhe mësuesit	218



HYRJE

Në Shqipëri, rruga drejt integritit evropian dhe përballja me sfidat e globalizimit dhe digjitalizimit kanë bërë që zhvillimi profesional i mësuesve të marrë një rëndësi të veçantë. Në një epokë të transformimit të shpejtë socio-ekonomik dhe digjitalizimit të pandërprerë, arsimi parauniversitar në Shqipëri gjendet përballë detyrës madhore për të përgatitur brezat e rinj për një të ardhme ku teknologjitë digjitale janë të ndërthurura me çdo aspekt të jetës, nga komunikimi dhe bashkëpunimi, deri te krijimi i përmbajtjes dhe zgjidhja e problemeve komplekse. Për të përmbushur këtë detyrë, mësuesit, si shtylla kryesore e sistemit arsimor, duhet të pajisen me kompetencat e nevojshme digjitale, jo vetëm për përdorimin e thjeshtë të teknologjisë, por transformimin e tyre në udhëheqës dhe lehtësues të procesit të të nxënit.

Përtej thjesht zotërimit të mjeteve digjitale, mësuesve u kërkohet të thellojnë vizionin e tyre, duke kuptuar plotësisht si teknologjia mund të bëhet një katalizator për transformimin e pedagogjisë, personalizimin e përvojës mësimore dhe kultivimin e aftësive kyçe të shekullit 21, siç janë mendimi kritik, krijimtaria e shpalosur, bashkëpunimi efektiv dhe komunikimi i qartë. Përdorimi i teknologjisë në arsim nuk është një qëllim në vetvete, por një urë drejt arritjes së objektivave më të larta arsimore: përgatitjen e brezave të rinj për tregun e punës, fuqizimin e tyre për pjesëmarrje aktive në shoqëri dhe zhvillimin e plotë personal.

Në këtë kuadër, dhe në përputhje me kuadrin ligjor e strategjik kombëtar, përfshirë pikën 2.1.2. “Përditësimi i kurrikulave në arsimin parauniversitar” të VKM-së Nr. 621, datë 10.10.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda kombëtare e reformave 2024–2027”, e cila buron nga “Plani i Rritjes” i Komisionit European për Ballkanin Perëndimor (në kuadër të instrumentit të Bashkimit European “Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor”), Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) ka hartuar këtë "Metodologji për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve në arsimin parauniversitar".

Për rrjedhojë, vlerësimi i kompetencave digjitale të mësuesve është hapi i parë dhe i domosdoshëm për të kuptuar nivelin aktual të tyre, për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, si dhe për të planifikuar programe zhvillimi profesional të synuara. Ky vlerësim duhet të jetë i bazuar në një metodologji të qartë, të strukturuar dhe shkencore, si dhe në instrumente të besueshme dhe të vlefshme që matin kompetencat digjitale në mënyrë objektive dhe të drejtë.



QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi kryesor i kësaj metodologjie është të ofrojë një mjet të fuqishëm dhe të besueshëm për të vlerësuar nivelin e kompetencave digjitale të mësuesve në arsimin parauniversitar, duke u bazuar në përvojat ndërkombëtare dhe realitetin shqiptar. Kjo metodologji synon të ndihmojë mësuesit të kuptojnë dhe përdorin potencialin e teknologjisë për të transformuar mësimdhënien dhe të nxënit, si dhe të zhvillojnë kompetencat e nevojshme për të përdorur teknologjinë në mënyrë efektive, etike dhe të përgjegjshme.

Objektivat specifike të kësaj metodologjie janë:

- Përcaktimi i qartë i fushave të kompetencave digjitale, në të cilat të identifikohen dhe të përshkruhen konceptet kryesore të tyre, që janë të rëndësishme për mësuesit e arsimit parauniversitar, duke përfshirë dimensionet pedagogjike, profesionale dhe etike.
- Hartimi i instrumenteve të vlerësimit të besueshme dhe të vlefshme (pyetësorë, anketa, intervista etj.), të lidhura ngushtë me kompetencat specifike që mbulojnë të gjitha nivelet e arritjes së kompetencave digjitale.
- Ofrimi i një metodologjie të qartë dhe të lehtë për t'u zbatuar, me qëllim vlerësimin e kompetencave digjitale të mësuesve, duke përfshirë udhëzime për zbatimin e instrumenteve të vlerësimit, analizimin e të dhënave dhe interpretimin e rezultateve.
- Analizimi i rezultateve të vlerësimit, nëpërmjet metodave statistikore dhe analitike për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të mësuesve në fushën e kompetencave digjitale.
- Informimi i politikave arsimore dhe hartimi i programeve profesionale të synuara që adresojnë nevojat specifike të mësuesve.
- Mbështetja e shkollave në procesin e integritit të teknologjisë dhe sigurimi i burimeve për të integruar teknologjinë në mënyrë efektive në procesin e të nxënit, duke përfshirë trajnime, mentorim dhe shkëmbim të praktikave të mira.



KONTEKSTI I DIGJITALIZIMIT TË ARSIMIT

Panorama globale e digjitalizimit në arsim

Transformimi digjital është një dukuri globale që ka hyrë në të gjitha sferat e jetës, prej të cilave arsimi nuk bën përjashtim. Në arenën ndërkombëtare, ekziston një mirëkuptim i gjerë lidhur me domosdoshmërinë e ndërthurjes së teknologjisë në arsim, me qëllim përgatitjen e nxënësve për sfidat dhe mundësitë e shekullit 21, duke nxitur zhvillimin e një sërë kornizash, standardesh dhe politikash, të cilat synojnë të çojnë para kompetencat digjitale të mësuesve. Ato ofrojnë një pikënisje të vlefshme për shtetet që synojnë të hartojnë politika dhe programe kombëtare për zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve.

Një numër organizatash dhe institucionesh ndërkombëtare kanë dhënë ndihmesën ndjeshëm në përcaktimin e kompetencave digjitale të mësuesve, të tilla si:

Digital Competence Framework for Educators (DigCompEdu)

Korniza Evropiane për Kompetencat Digjitale të Edukatorëve, e zhvilluar nga Komisioni Evropian, ofron një model të detajuar të kompetencave të organizuara në gjashtë fusha: angazhimi profesional, burimet digjitale, mësimi dhe mësimdhënia, vlerësimi, fuqizimi i nxënësve dhe lehtësimi i kompetencave digjitale të nxënësve. DigCompEdu është një mënyrë e strukturuar për të kuptuar dhe zhvilluar aftësitë dhe zotësitë që mësuesit kanë nevojë për të përdorur në mënyrë efektive teknologjitë digjitale në praktikën e tyre profesionale.

Në vend që të fokusohet vetëm në aftësitë bazë teknike (si përdorimi i një kompjuteri ose i një programi të caktuar), korniza merr një qasje më të gjerë. Ajo paraqet një vizion të një mësuesi me aftësi digjitale që mund t'i integrojë pa problem mjetet dhe burimet digjitale në mësimdhënien e tij për të përmirësuar procesin e të nxënësve. Kjo përfshin jo vetëm përdorimin e teknologjisë për detyra administrative ose paraqitjen e informacionit, por edhe për hartimin e përvojave mësimore tërheqëse, nxitjen e bashkëpunimit midis nxënësve, ofrimin e reagimeve të personalizuara dhe vlerësimin e të nxënësve në mënyra të reja origjinale.



Korniza i ndan kompetencat digjitale në dimensione ose fusha të ndryshme, përkatësisht:

- *Angazhimi Profesional:* Përdorimi i teknologjisë për komunikim, bashkëpunim dhe zhvillim profesional.
- *Burimet Digjitale:* Gjetja, krijimi dhe shpërndarja e materialeve digjitale të mësimdhënies dhe të nxënit.
- *Mësimdhënia dhe të nxënit:* Përdorimi i mjeteve dhe strategjive digjitale për të menaxhuar, ofruar dhe mbështetur udhëzimet.
- *Vlerësimi:* Përdorimi i teknologjisë për vlerësimin e vazhduar dhe përmbledhës të të nxënit të nxënësve.
- *Fuqizimi i nxënësve:* Shfrytëzimi i teknologjisë për të personalizuar të nxënit, për të nxitur përfshirjen dhe për të mbështetur autonominë e nxënësve.
- *Zhvillimi i kompetencës digjitale të nxënësve:* Ndihma e nxënësve për të zhvilluar aftësitë e tyre digjitale dhe përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë.

Korniza synon të fuqizojë mësuesit të bëhen përdorues të sigurt dhe krijues të teknologjisë, duke i aftësuar ata të transformojnë praktikatat e tyre të mësimdhënies dhe t'i përgatisin nxënësit për sukses në një botë të drejtuar nga teknologjia digjitale. Ajo ofron fusha, tregues dhe nivele vlerësimi me një gjuhë të përbashkët që mund të përdoren për të mbështetur trajnimin e mësuesve, zhvillimin e kurrikulave dhe nismat e politikave që lidhen me arsimin digjital.

UNESCO ICT Competency Framework for Teachers (ICT-CFT)

Kjo kornizë, e zhvilluar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO), ofron një strukturë të gjerë për zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve. Ajo përfshin tre qasje (njohuri, thellim i njohurive dhe krijim i njohurive) dhe gjashtë aspekte (politika, kurrikula dhe vlerësimi, pedagogjia, përdorimi i TIK, organizimi dhe administrimi, dhe zhvillimi profesional i mësuesve). Dokumenti synon të udhëzojë zhvillimin profesional të mësuesve në integrimin efektiv të teknologjisë në procesin e të nxënit dhe është përdorur gjerësisht si bazë për zhvillimin e standardeve dhe programeve trajnuese për mësuesit në shumë vende.

Korniza përcakton nivele të ndryshme të kompetencave, duke filluar nga njohuritë bazë të teknologjisë deri te aftësitë për krijimin e njohurive dhe inovacionin pedagogjik. Ajo trajton aspekte të ndryshme të përdorimit të teknologjisë në arsim, duke përfshirë planifikimin e

mësimit, vlerësimin e nxënësve, dhe zhvillimin e aftësive të shekullit 21. Në thelb, dokumenti shërben si një mjet referimi për politikat arsimore, programet e trajnimit të mësuesve dhe praktikatat e shkollave në lidhje me integrimin e TIK-ut.

ISTE Standards for Educators

Standardet e Shoqatës Ndërkombëtare për Teknologji në Arsim (ISTE) ofrojnë një vizion për përdorimin e teknologjisë në arsim për të fuqizuar nxënësit dhe për të transformuar mësimdhënien dhe nxënien. Këto standarde nuk janë vetëm për përdorimin e mjeteve teknologjike, por më tepër për të transformuar praktikatat pedagogjike në një mënyrë që i përgjigjet nevojave të nxënësve në epokën digjitale. Standardet ISTE janë dinamike dhe zhvillohen me teknologjinë, duke siguruar që mësuesit të jenë gjithmonë të përgatitur për të ardhmen e arsimit. Ato theksojnë rëndësinë e:

- *Nxënësit:* Mësuesit duhet të jenë në gjendje të lehtësojnë dhe frymëzojnë të nxënësit dhe krijimtarinë e nxënësve.
- *Udhëheqjes:* Mësuesit duhet të shfaqin aftësi udhëheqëse në vizionin e arsimit digjital, transformimin dhe rritjen e tij.
- *Qytetarisë digjitale:* Mësuesit duhet të modelojnë qytetarinë digjitale në mënyrë që të nxësin një kulturë të sigurt, ligjore dhe etike.
- *Bashkëpunimit:* Mësuesit duhet të bashkëpunojnë me kolegët dhe nxënësit për të përmirësuar praktikën dhe për të zbuluar mjedise të reja të nxënësit.
- *Modelimit:* Mësuesit duhet të modelojnë përvoja të vërteta të të nxënësit që njohin dhe përfshijnë nxënësit.
- *Vlerësimi:* Mësuesit duhet të përdorin të dhëna për të udhëhequr mësimin e nxënësve dhe për të vlerësuar efektivitetin e mësimit.

Arsimi shqiptar në epokën digjitale

Strategjitë dhe politikat

Qeveria shqiptare ka vënë në krye të axhendës së saj rëndësinë e padiskutueshme të digjitalizimit në arsim, duke e shprehur këtë qartë në strategjitë dhe politikat kombëtare.

Strategjia Kombëtare e arsimit parauniversitar (SAPU) 2021-2026

SAPU përcakton përparësitë dhe objektivat për zhvillimin e arsimit në Shqipëri, duke përfshirë edhe digjitalizimin e arsimit. Vizioni i strategjisë është krijimi i një sistemi arsimor të mbështetur të TIK-u, që fuqizon nxënësit dhe mësuesit, duke vënë theksin në zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve dhe nxënësve, krijimin e përmbajtjeve arsimore digjitale cilësore dhe sigurimin e shërbimeve të TIK-ut të besueshme dhe të qëndrueshme. Mësuesit janë në qendër të këtij ndryshimi, të pajisur me aftësitë e nevojshme për të ndërthurur teknologjinë në mënyrë efektive në mësimdhënie dhe për të udhëhequr nxënësit në zhvillimin e kompetencave të shekullit 21. SAPU parashikon trajnim të vazhdueshëm për mësuesit dhe përfshirjen e kompetencave digjitale në performancën e tyre.

Njëkohësisht, strategjia i kushton rëndësi të veçantë sigurisë online të fëmijëve, duke parashikuar masa për edukimin e nxënësve, mësuesve dhe prindërve për përdorimin e sigurt dhe të përgjegjshëm të internetit. SAPU e sheh digjitalizimin e arsimit si një proces tërësor, që kërkon një qasje të integruar, duke përfshirë krijimin e një mjedisi mësimor që nxit risinë, bashkëpunimin dhe nxënien aktive, duke përdorur teknologjinë si një mjet për të përmirësuar cilësinë e arsimit dhe për të përgatitur nxënësit për të ardhmen. Strategjia synon të sigurojë që çdo nxënës në Shqipëri të ketë mundësinë të zhvillojë kompetencat digjitale të nevojshme për të ecur përpara në një botë gjithnjë e më të ndërlidhur dhe të drejtuar nga teknologjia.

Strategjia digjitale e edukimit dhe plani i veprimit 2025-2029

Ky dokument synon të transformojë sistemin arsimor në Shqipëri përmes integritit të teknologjisë digjitale, duke u përqendruar në përmirësimin e infrastrukturës digjitale, zhvillimin e aftësive digjitale të nxënësve dhe mësuesve, si dhe krijimin e një mjedisi mësimor të ri dhe tërheqës. Strategjia kërkon të përgatisë brezin e ri për sfidat dhe mundësitë e epokës digjitale, duke siguruar që arsimi të jetë cilësor dhe i mundshëm për të gjithë.

Plani i veprimit që shoqëron strategjinë ofron një udhërrëfyes praktik për realizimin e këtij vizioni. Ai përmban një sërë politikash dhe objektivash konkrete, të shoqëruara me veprimtari specifike, tregues të matshëm dhe afate kohore. Këto politika synojnë të adresojnë sfidat ekzistuese në sistemin arsimor, si p.sh. mungesën e infrastrukturës përkatëse digjitale, nivelin e ulët të aftësive digjitale të një pjesë të mësuesve, dhe nevojën për përmirësimin e metodave

të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Nëpërmjet zbatimit të këtij plani, dokumenti synon të krijojë një sistem arsimor më dinamik, efikas dhe të përshtatur me nevojat e shekullit 21.

Strategjia kombëtare për sigurinë kibernetike 2025 -2030

Ky dokument, ka për qëllim krijimin e një Shqipërie të sigurt, të qëndrueshme dhe të besueshme në hapësirën kibernetike. Strategjia synon të mbrojë infrastrukturën digjitale të vendit, qytetarët e tij online si dhe të sigurojë vazhdimësinë e shërbimeve jetike përballë kërcënimeve gjithnjë në rritje. Kjo nuk është thjesht një strategji mbrojtëse, por një plan veprimi parandalues për të ndërtuar një kulturë të fortë kibernetike, për të nxitur risinë në fushën e sigurisë dhe për të adresuar sfidat globale të sigurisë kibernetike.

Dokumenti e sheh sigurinë kibernetike si një çështje shumëdimensionale, që kërkon një qasje tërësore dhe thekson rëndësinë e hartimit të një kuadri ligjor të fortë, forcimit të kapaciteteve monitoruese, rritjes së ndërgjegjësimit të publikut për rreziqet kibernetike, dhe krijimit të mekanizmave efektivë për të reaguar ndaj incidenteve. Për më tepër, strategjia njeh nevojën për të adresuar kërcënimet që përbëhen nga sulme kibernetike me informacione të rreme dhe taktika të tjera dhe për këtë arsye, i kushton një vëmendje të veçantë bashkërendimit ndërinstytucional dhe ndërkombëtar.

Strategjia Kombëtare e Specializimit Inteligjent (S3) 2025-2030

Strategjia përcakton prioritetet e Shqipërisë në fushën e zhvillimit ekonomik dhe inovacionit dhe ka për qëllim kryesor të identifikojë dhe të fokusohet në ato sektorë dhe fusha ku vendi ka potencialin më të madh për të zhvilluar avantazhe konkurruese, si përmes kërkimit dhe inovacionit, ashtu edhe përmes shfrytëzimit të pikave të forta ekzistuese. Kjo strategji synon të drejtojë investimet publike dhe private drejt këtyre fushave prioritare, duke maksimizuar ndikimin e tyre në rritjen ekonomike dhe në krijimin e vendeve të punës me vlerë të shtuar.

S3 ndihmon Shqipërinë të bëjë zgjedhje strategjike për të mos shpërndarë burimet në shumë drejtime, por për t'u përqendruar në ato pak fusha ku mund të ketë një ndikim të vërtetë. Ajo gjithashtu inkurajon bashkëpunimin ndërmjet botës akademike, biznesit, qeverisë dhe shoqërisë civile, duke synuar krijimin e një ekosistemi inovativ dhe rritjen e konkurrueshmërisë së vendit në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare.

Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e TIK

Ky dokument është një udhërrëfyes i rëndësishëm për të përcaktuar se si mësuesit duhet të përdorin TIK-un në mënyrë efektive. Ai nuk është thjesht një listë aftësish teknike, por një vizion i integruar i mësimdhënies dhe nxënies në kontekstin digjital. Dokumenti thekson që këto standarde u drejtohen mësuesve, drejtuesve të shkollave, institucioneve arsimore dhe politikëbërësve. Ai ofron një strukturë të qartë për të kuptuar pritshmëritë ndaj mësuesve në përdorimin e TIK-ut, duke filluar nga njohja e politikave arsimore dhe duke kulmuar me zbatimin e metodologjive inovative të mësimdhënies.

Standardet e përcaktuara në këtë dokument janë:

1. *Njohja dhe zbatimi i politikave arsimore në lidhje me TIK-un:* Mësuesit duhet të jenë të njohur me politikat arsimore që rregullojnë përdorimin e TIK-ut dhe t'i zbatojnë ato në praktikën e tyre. Kjo përfshin kuptimin e rregulloreve, udhëzimeve dhe strategjive që synojnë integrimin e teknologjisë në arsim.
2. *Përdorimi i TIK-ut në zbatimin e kurrikulës:* Mësuesit duhet të përdorin TIK-un për të zbatuar kurrikulën në mënyrë efektive, duke përfshirë përdorimin e mjeteve digjitale për të krijuar materiale mësimore dhe për të ofruar udhëzime.
3. *TIK dhe metodologjitë e mësimdhënies-nxënies:* Mësuesit duhet të përdorin TIK-un për të zbatuar metodologji inovative të mësimdhënies-nxënies që nxisin angazhimin e nxënësve, bashkëpunimin, krijimtarinë dhe aftësitë e të menduarit kritik.
4. *Vlerësimi i nxënësve me TIK:* Mësuesit duhet të përdorin TIK-un për të vlerësuar nxënësit në mënyrë të drejtë dhe të vlefshme, duke përdorur mjete dhe platforma digjitale për të monitoruar përparimin e nxënësve dhe për të dhënë reagime.
5. *Fuqizimi i nxënësve me anë të TIK-ut:* Mësuesit duhet të përdorin TIK-un për të fuqizuar nxënësit, duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësitë digjitale, të bëhen qytetarë digjitalë të përgjegjshëm dhe të përgatiten për jetën dhe punën në epokën digjitale.
6. *Lehtësimi i kompetencave digjitale të nxënësve:* Mësuesit duhet të lehtësojnë zhvillimin e kompetencave digjitale të nxënësve, duke i udhëzuar ata në përdorimin efektiv dhe etik të teknologjisë, duke përfshirë aftësitë e informacionit, komunikimit, bashkëpunimit dhe krijimtarisë digjitale.

Këto standarde synojnë të krijojnë një kulturë të përdorimit efektiv dhe të qëllimshëm të TIK-ut në arsim, duke përgatitur mësuesit dhe nxënësit për sfidat dhe mundësitë e botës digjitale.

Gjendja e tanishme dhe zhvillimet në arsimin digjital

Qeveria shqiptare i ka dhënë një rëndësi të veçantë transformimit digjital të arsimit, duke e parë këtë si një hap drejt përgatitjes së brezave të rinj dhe mësuesve për sfidat e shekullit të 21-të. Ky përkushtim është konkretizuar në investime dhe reforma të mirëkoordinuara në arsimin parauniversitar.

Një nga arritjet më të rëndësishme është sigurimi i aksesit në internet për të gjitha shkollat në vend. Krahas kësaj, pajisja e 200 shkollave 9-vjeçare me laboratorë inteligjentë “SmartLab” dhe 100 të tjera me “ElementIT”, po sjellin një ndryshim të dukshëm, duke pajisur klasat me teknologji moderne dhe duke përmirësuar raportin e pajisjeve për nxënës. Po ashtu, projekte si klasat inteligjente në gjimnaze (“*AI for Youth*”), të cilat ofrojnë teknologji moderne dhe qasje në burime të avancuara digjitale, po zgjerojnë mundësitë e mësimdhënies dhe të nxënës.

Këto përpjekje shoqërohen nga sisteme të avancuara si SMIP, të cilat jo vetëm digjitalizojnë menaxhimin e të dhënave shkollore, por edhe lehtësojnë komunikimin e menjëhershëm mes të gjithë aktorëve të shkollës.

Përtej infrastrukturës, zhvillimi i kurrikulës së re të TIK-ut që në klasat e para të arsimit bazë tregon një vizion të qartë për ndërtimin e kompetencave digjitale që në hapat e parë të shkollimit. Po ashtu, programet kombëtare të zhvillimit profesional, po ofrojnë trajnime gjithëpërfshirëse për mësuesit, duke i ndihmuar ata të zotërojnë aftësitë digjitale dhe të integrojnë metodologjitë mësimore inovative.

Për të kuptuar më mirë dhe për të matur efektin e këtyre nismave, si dhe për të krijuar një bazë të qëndrueshme për zhvillimin e mëtejshëm, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP) ndërmori hartimin dhe administrimin e një pyetësoi diagnostikues.

Në pyetësor morën pjesë 332 mësues, me një përfaqësim të gjerë gjeografik në nivel DRAP dhe ZVAP. Konkretisht, u përfshinë mësues nga shkollat e Tiranës, Shkodrës, Pogradecit, Maliqit, Kolonjës, Durrësit dhe Vlorës, duke garantuar një shumëllojshmëri në profile, përvojë dhe kontekste mësimore.



Përdorimi i teknologjisë në procesin mësimor

Të dhënat tregojnë se rreth 60% e mësuesve raportojnë përdorim të rregullt të TIK në procesin mësimor, ndërkohë që 40% e tyre shfaqin një përdorim më të kufizuar apo rastësor. Përdorimet më të zakonshme përfshijnë kërkimin e informacionit (82%), përgatitjen e materialeve mësimore (79%) dhe komunikimin me nxënësit (63%). Megjithatë, përdorimi i teknologjisë për qëllime më të përparuara, si projektet bashkëpunuese apo vlerësimin e vazhduar, mbetet ende në nivele të ulëta.

Vetëvlerësimi i mësuesve për kompetencat digjitale

Vetëvlerësimi i mësuesve në fushën e kompetencës digjitale pasqyron një nivel të lartë të aftësive bazike, me mbi 70% të tyre që ndihen të aftë në përdorimin e mjeteve standarde teknologjike. Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për integrimin pedagogjik të teknologjisë apo përdorimin kritik dhe krijues të saj, vetëbesimi bie dukshëm. Vetëm 34% e të anketuarve kishin ndjekur trajnime të strukturuar në këtë fushë, çka tregon për një hendek të qartë mes njohurive teknike dhe kompetencave pedagogjike të integruara.

Ndikimi i faktorëve demografikë dhe profesionalë

Rezultatet sugjerojnë një lidhje të qartë midis nivelit të kompetencës digjitale dhe faktorëve si mosha, përvoja profesionale dhe profili i mësuesit. Mësuesit më të rinj dhe ata që japin lëndë tekniko-shkencore kanë prirje të jenë më të sigurt dhe më të shkathët në përdorimin e TIK, ndërsa mësuesit me në moshë dhe të lëndëve shoqërore raportojnë më shumë vështirësi.

Sfidat strukturore dhe burimet teknologjike

Një ndër pengesat që vihet re në analizë është mungesa e infrastrukturës së përshtatshme teknologjike. Rreth 48% e mësuesve pohuan se shkollat e tyre nuk kanë pajisje të mjaftueshme apo kanë probleme të vazhdueshme me lidhjen në internet. Kjo pengesë ndikon drejtpërdrejt në aftësinë e mësuesve për të përfshirë teknologjinë në mënyrë të qëndrueshme dhe krijuese në orët e mësimi.

Qëndrimet dhe kërkesat për zhvillim profesional

Një numër i ndjeshëm mësuesish (rreth 74%) shfaqin qëndrime pozitive ndaj përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie. Ata e shohin TIK-un si një mjet për rritjen e motivimit të nxënësve dhe përmirësimin e rezultateve të të nxënit. Megjithatë, njëkohësisht, ata nënvizojnë nevojën për mbështetje të strukturuar përmes trajnimeve praktike dhe politikave institucionale që nxisin përdorimin risi të teknologjisë në mësimdhënie.



AKTORËT DHE ROLET NË ZBATIMIN E METODOLOGJISË

Përfituesit dhe palët e interesuara

Metodologjia për vlerësimin e nivelit të kompetencave të mësuesve shërben si një udhërrëfyes i plotë dhe i përshtatshëm për një sërë përdoruesish të përfshirë në sistemin arsimor. Ajo ofron një kornizë të qartë dhe të strukturuar për zhvillimin, vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave digjitale të mësuesve.

Kjo metodologji nuk është thjesht një mjet vlerësimi, por një kornizë e gjithanshme që synon të fuqizojë të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin arsimor. Ajo ofron atyre një gjuhë dhe një rrugë të përbashkët për të arritur një arsim cilësor dhe të përshtatur me epokën digjitale.

Rezultatet dhe analizat e ofruara nga ky proces vlerësimi do të shfrytëzohen për të informuar vendimmarrje strategjike dhe për të mbështetur zhvillimin profesional të mësuesve, duke dhënë ndihmesë drejtpërdrejt në digjitalizimin e arsimit parauniversitar.

Mësuesit në qendër të procesit të zhvillimit profesional

Në thelb, kjo metodologji është krijuar për vetë mësuesit. Ajo u ofron atyre një mjet vetëreflektimi dhe vetëvlerësimi, duke i ndihmuar të identifikojnë pikat e tyre të forta dhe fushat ku kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Përmes përshkruesve të detajuar të kompetencave dhe niveleve të qarta të vlerësimit, mësuesi mund të:

- *Vetëreflektojë dhe vetëvlerësojë:* Mundëson çdo mësues të bëjë një vetëvlerësim objektiv të nivelit të tij aktual të kompetencave digjitale, duke identifikuar pikat e forta dhe fushat specifike ku kanë nevojë për përmirësim.
- *Rritë vetëdijen:* Nxit vetëdijen mbi rëndësinë e kompetencave digjitale në praktikën mësimore dhe angazhimin profesional.
- *Planifikojë zhvillimin e tij profesional:* Shërben si një bazë për të hartuar plane vetjake të zhvillimit profesional, duke i udhëzuar drejt veprimtarive të zhvillimit profesional, burimeve apo praktikave që adresojnë nevojat individuale.



- *Përmirësojë praktikat e tij mësimore:* Metodologjia ofron një kornizë për integrimin efektiv të teknologjive digjitale në mësimdhënie dhe nxënie, duke nxitur mësuesin të eksperimentojë me qasje të reja dhe të përmirësojë cilësinë e mësimin në klasë.
- *Rritë vetëbesimin dhe motivimin:* Duke parë qartë ecurinë e tij dhe duke u pajisur me aftësitë e nevojshme, mësuesi do të ndihet më i sigurt dhe më i motivuar për të përdorur teknologjinë në punën e vet.

Drejtuesit e shkollave, si udhëheqës në transformimin digjital të shkollave

Drejtuesit e shkollave luajnë një rol kyç në krijimin e një mjedisi që mbështet zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve. Kjo metodologji u ofron atyre mjetet dhe udhëzimet e nevojshme për të:

- *Vlerësuar nevojat e shkollës:* Ofron një pasqyrë të qartë të nivelit të kompetencave digjitale të stafit mësimdhënës në nivel shkolle, duke identifikuar nevojat e përbashkëta të shkollës për zhvillim profesional dhe duke planifikuar strategji për t'i adresuar ato.
- *Planifikuar zhvillimin profesional të mësuesve:* Metodologjia ofron një kornizë për planifikimin e programeve të trajnimit dhe veprimtarive të zhvillimit profesional që janë të përshtatura me nevojat e mësuesve dhe të shkollës.
- *Mbështetur risinë pedagogjike:* Lehtëson ofrimin e mbështetjes së synuar për mësuesit dhe krijimin e një mjedisi shkollor që nxit zhvillimin e kompetencave digjitale, duke nxitur mësuesit të përdorin teknologjinë në mënyrë efektive.
- *Monitoruar ecurinë e shkollës:* Metodologjia u mundëson drejtuesve të monitorojnë ecurinë e shkollës në zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve dhe të vlerësojnë ndikimin e këtij zhvillimi në cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënës.
- *Planifikuar burimet:* Ndihmon në planifikimin efektiv të burimeve (p.sh., trajnime, pajisje, mbështetje teknike) për të mbështetur digjitalizimin e shkollës.

Institucionet monitoruese/vlerësuese, si garantues të cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm

Institucionet monitoruese dhe vlerësuese, kanë një rol të rëndësishëm në sigurimin e cilësisë dhe efektivitetin e përdorimit të kësaj metodologjisë. Ato e përdorin këtë metodologji për:

- *Standardizimin e proceset e vlerësimit:* Metodologjia ofron një kornizë të standardizuar për vlerësimin e kompetencave digjitale të mësuesve, duke siguruar përputhshmëri dhe krahasueshmëri në të gjithë sistemin arsimor.
- *Monitorimin e zbatimit të politikave:* Ajo u mundëson institucioneve monitoruese/vlerësuese të vlerësojnë nëse politikat dhe programet e zhvillimit profesional në fushën e teknologjisë po zbatohen në mënyrë efektive.
- *Identifikimin e pikave të forta dhe dobësitë:* Metodologjia ndihmon në identifikimin e pikave të forta dhe dobësive në zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve në nivel shkolle dhe në nivelin e sistemit arsimor në tërësi.
- *Dhënien e rekomandimeve për përmirësim:* Bazuar në rezultatet e vlerësimit, institucionet monitoruese/vlerësuese mund të ofrojnë rekomandime të bazuara në prova për përmirësimin e programeve të trajnimit, politikave arsimore dhe praktikave të mësimdhënies.
- *Sigurimin e llogaridhënies:* Metodologjia ndihmon në rritjen e llogaridhënies në sistemin arsimor, duke ofruar një mënyrë transparente dhe të besueshme për të vlerësuar zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve.
- *Informimin e vendimmarrësve:* Ofron të dhëna sasiore dhe cilësore për gjendjen aktuale të kompetencave digjitale të mësuesve në shkallë kombëtare, duke shërbyer si bazë për hartimin e politikave dhe strategjive efektive të digjitalizimit të arsimit.
- *Hartimin e programeve të veprimtarive të zhvillimit profesional:* Ofron të dhëna të vlefshme për hartimin dhe përmirësimin e programeve të trajnimit për kompetencat digjitale, duke siguruar që ato të jenë të përshtatura me nevojat reale të mësuesve në nivel kombëtar

Ministria përgjegjëse për arsimin, si hartuese e politikave dhe reformave arsimore

Ministria përgjegjëse për arsimin mund ta përdorë këtë metodologji për të ndërmarrë reforma arsimore në fushën e teknologjisë. Ajo u ofron atyre një bazë të fortë për të:

- *Monitoruar objektivat strategjike:* Mundëson monitorimin e ecures drejt objektivave strategjike kombëtare në fushën e digjitalizimit të arsimit dhe vlerësimin e efikasitetit të reformave të zbatuara.

- *Identifikuar prioritetet:* Ndhmon në identifikimin e përparësive kombëtare për investime në teknologji, zhvillim kurrikular, dhe trajnime të mësuesve.
- *Përcaktuar standarde kombëtare:* Metodologjia mund të përdoret si një bazë për përcaktimin e standardeve kombëtare për kompetencat digjitale të mësuesve.
- *Orientuar investimet:* Ndhmon në orientimin e investimeve në infrastrukturën dhe burimet digjitale, për të mbështetur nismat e digjitalizimit në arsim.

Institucionet e arsimit të lartë, si përgatitës të mësuesve të ardhshëm

Institucionet e arsimit të lartë që përgatisin mësuesit e ardhshëm mund të përdorin këtë metodologji për të siguruar që programet e tyre të studimit t'i pajisin studentët me kompetencat e nevojshme digjitale. Ajo u ofron atyre një kornizë për të:

- *Rishikuar kurrikulat:* Metodologjia mund të përdoret për të rishikuar kurrikulat e programeve të studimit për mësuesi dhe për të siguruar që ato të përfshijnë kompetencat digjitale.
- *Zhvilluar materiale mësimore:* Ajo mund të informojë zhvillimin e materialeve mësimore që mbështesin zhvillimin e kompetencave digjitale të studentëve.
- *Vlerësuar arritjet e studentëve:* Metodologjia mund të përdoret për të vlerësuar arritjet e studentëve në fushën e kompetencave digjitale.
- *Bashkëpunuar me shkollat:* Ajo mund të lehtësojë bashkëpunimin midis institucioneve të arsimit të lartë dhe shkollave në fushën e zhvillimit të kompetencave digjitale të mësuesve.

Organizatat joqeveritare dhe partnerët ndërkombëtarë, si mbështetës të risisë në arsim

Organizatat joqeveritare dhe partnerët ndërkombëtarë që punojnë në fushën e arsimit mund të përdorin këtë metodologji për të mbështetur risinë në arsim dhe për të përkrahur përdorimin efektiv të teknologjisë në arsim. Ajo u ofron atyre një kornizë për të:

- *Hartuar projekte:* Metodologjia mund të përdoret për të hartuar projekte që synojnë zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve.
- *Vlerësuar ndikimin e projekteve:* Ajo mund të përdoret për të vlerësuar ndikimin e projekteve në zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve dhe në përmirësimin e cilësisë së arsimit.



- *Shkëmbyer praktika të mira:* Metodologjia mund të lehtësojë shkëmbimin e praktikave të mira në fushën e zhvillimit të kompetencave digjitale të mësuesve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- *Mbështetur politika arsimore të bazuara në prova:* Ajo mund të përdoret për të mbështetur politikat arsimore të bazuara në prova në fushën e teknologjisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë e aktorëve

Për të garantuar një proces efektiv, transparent dhe të besueshëm të vlerësimit të nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve, është e domosdoshme të përcaktohen me qartësi detyrat dhe përgjegjësitë e secilit aktor të përfshirë. Më poshtë, përshkruhen rolet përkatëse të institucioneve dhe strukturave përgjegjëse, të cilat bashkëpunojnë për të ngritur dhe matur aftësitë digjitale të mësuesve në arsimin parauniversitar, përkatësisht rolet specifike të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP), Agjencisë Kombëtare të Arsimit parauniversitar (AKAP), Drejtorive Rajonale Arsimore Parauniversitare (DRAP), Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), Rrjeteve profesionale në nivel ZVAP-je, Drejtorit të shkollës, Grupit qendror të vlerësimit të brendshëm të shkollës, Ekipeve lëndore si edhe të koordinatorit të cilësisë në shkollë.

ASCAP	▶ Harton dokumentin kombëtar për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve. ▶ Vlerëson dhe akrediton programet dhe veprimtaritë trajnuese për zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve, të ofruara nga institucione të ndryshme, për të siguruar cilësinë dhe përputhshmërinë e tyre me standardet. ▶ Trajnon dhe këshillon specialistët e DRAP-it, ZVAP-ve, drejtuesit e shkollave, rrjetet profesionale, ekipet lëndore për njohjen dhe zbatimin e metodologjisë së vlerësimit të nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve. ▶ Monitoron dhe vlerëson rregullisht zbatimin e metodologjisë së vlerësimit të nivelit të kompetencave digjitale në nivel kombëtar, duke siguruar respektimin e procedurave dhe objektivitetin e rezultateve.
--------------	---

	‣ Mbledh dhe analizon të dhëna mbi nivelet e kompetencave digjitale të mësuesve në nivel kombëtar, për të identifikuar prirjet, nevojat për përmirësim dhe për të informuar politikat arsimore. ‣ Brenda muajit dhjetor të çdo viti, në bashkëpunim me AKAP-in hartojnë raportin kombëtar në lidhje me monitorimet dhe vlerësimet e shkollave për zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve. ‣ Bazuar në analizat dhe monitorimet/vlerësimet, propozon rekomandime për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit lidhur me përmirësimin e politikave për digjitalizimin e arsimit dhe zhvillimin profesional të mësuesve.
AKAP	‣ Siguron zbatimin e udhëzimeve, metodologjive dhe strategjitë kombëtare për zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve. ‣ Monitoron ecurinë e zbatimit të kurrikulave dhe programeve që integrojnë kompetencat digjitale në mësimdhënie, duke siguruar që mësuesit po përdorin dhe zhvillojnë këto aftësi. ‣ Vlerëson performancën e mësuesve në përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve digjitale në procesin mësimor, si pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të cilësisë së mësimdhënies. ‣ Mbledh dhe përpunon të dhënat e vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve, të raportuara nga DRAP-et dhe ZVAP-të, duke i përdorur ato për analiza kombëtare. ‣ Analizon të dhënat e mbledhura për të identifikuar nevojat për aktivitete trajnuese dhe zhvillimin e mëtejshëm në fushën e kompetencave digjitale të mësuesve. ‣ Propozon programe dhe iniciativa për zhvillimin profesional të mësuesve, duke u përqendruar në përmirësimin e aftësive të tyre digjitale, bazuar në analizat e nevojave. ‣ Këshillon dhe mbështet DRAP-et dhe ZVAP-et në interpretimin dhe zbatimin e politikave lidhur me kompetencat digjitale të mësuesve. ‣ Propozon ndryshime apo përmirësime në kuadrin rregullator dhe udhëzuesit për kompetencat digjitale të mësuesve, bazuar në gjetjet nga monitorimi dhe vlerësimi në terren.

	‣ Brenda muajit dhjetor të çdo viti, në bashkëpunim me ASCAP-in hartojnë raportin kombëtar në lidhje me monitorimet dhe vlerësimet e shkollave për zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve.
DRAP	‣ Bashkërendon zbatimin e metodologjisë së vlerësimit në ZVAP-të nën juridiksionin e tij dhe ofron mbështetje teknike dhe logjistike për procesin. ‣ Organizon këshillime/trajnime për drejtorët e shkollave, specialistët e TIK-ut dhe anëtarët e grupeve të vlerësimit të brendshëm, mbi metodologjinë dhe instrumentet e vlerësimit të kompetencave digjitale. ‣ Monitoron dhe vlerëson rregullisht zbatimin e procesit të vlerësimit nëpër shkolla, duke ofruar këshillim për të zgjidhur problematikat e hasura. ‣ Mbledh të dhënat e vlerësimit nga ZVAP-të nën juridiksionin e tyre dhe i përpunon ato, duke i raportuar rregullisht në AKAP dhe ASCAP. ‣ Identifikon nevojat specifike për zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve dhe propozojnë programe trajnimi të përshtatshme.
ZVAP	‣ Bashkërendon zbatimin e metodologjisë së vlerësimit në shkollat nën juridiksionin e tyre dhe ofrojnë mbështetje teknike dhe logjistike për procesin. ‣ Organizon këshillime/trajnime për drejtorët e shkollave, specialistët e TIK-ut dhe anëtarët e grupeve të vlerësimit të brendshëm, mbi metodologjinë dhe instrumentet e vlerësimit të kompetencave digjitale. ‣ Monitoron rregullisht zbatimin e procesit të vlerësimit nëpër shkolla, duke ofruar konsulencë dhe zgjidhur problematikat e hasura. ‣ Mbledh të dhënat e vlerësimit nga shkollat nën juridiksionin e tyre dhe i përpunon ato, duke i raportuar rregullisht në DRAP/AKAP/ASCAP.

	▶ Identifikojnë nevojat specifike për zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve dhe propozojnë programe trajnimi të përshtatshme.
Rrjeti profesional në nivel ZVAP-je	▶ Ndërton dhe mirëmban një komunitet praktikash ku mësuesit mund të ndajnë përvoja, sfida dhe zgjidhje lidhur me zhvillimin e kompetencave digjitale. ▶ Organizon sesione shkëmbimi eksperience dhe workshop-e specifike mbi tematika të avancuara të digjitalizimit në mësimdhënie. ▶ Identifikon mësues ekspert në lidhje me kompetencat të digjitale për t'i kthyer ata në mentorë për kolegët e tjerë. ▶ Propozon nevojat për trajnime dhe burime digjitale, bazuar në feedback-un e mësuesve dhe tendencat e reja teknologjike. ▶ Bashkëpunon me DRAP/ZVAP-et për të siguruar që trajnimet dhe burimet janë të përshtatshme dhe të aksesueshme për të gjithë mësuesit.
Drejtori i shkollës	▶ Planifikon dhe organizon procesin e vlerësimit të nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve në shkollën e tij, në përputhje me udhëzimet dhe udhëzuesit zyrtarë. ▶ Angazhohet për të siguruar infrastrukturën e nevojshme (pajisje, internet etj.) dhe mbështetjen teknike brenda mundësive të shkollës për zhvillimin dhe vlerësimin e kompetencave digjitale. ▶ Krijon një mjedis mbështetës dhe motivues për mësuesit, duke inkurajuar angazhimin e tyre në procesin e vlerësimit dhe zhvillimit profesional digjital. ▶ Identifikon mësues ekspertë në lidhje me kompetencat të digjitale për t'i kthyer ata në mentorë për kolegët e tjerë. ▶ Analizon rezultatet e vlerësimit të brendshëm dhe i përdor ato për të hartuar plane zhvillimi profesional për mësuesit, për të orientuar veprimtaritë trajnuese dhe për të përmirësuar praktikën mësimore në shkollë. ▶ Harton plane veprimi për përmirësimin e kompetencave digjitale të stafit mësimor të shkollës.



	› Siguron raportimin e saktë dhe në kohë të të dhënave të vlerësimit në ZVAP.
Grupi qendror i vlerësimit të brendshëm të shkollës	› Zbaton procesin e vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve në shkollë, duke përdorur instrumentet e miratuara (vetëvlerësim, anketa/pyetësorë, vëzhgime, analiza portofolat etj.). › Ofron asistencë dhe këshillim për mësuesit gjatë procesit të vetëvlerësimit dhe zhvillimit të portofolave digjitale. › Mbledh, përpunon dhe analizon të dhënat e vlerësimit në nivel shkolle. › Siguron feedback të dobishëm për mësuesit mbi nivelet e tyre të kompetencave digjitale dhe formulon rekomandime për zhvillimin e tyre të mëtejshëm. › Harton raporte rregullisht me përfundime dhe propozime për drejtorin e shkollës lidhur me nevojat për trajnime dhe burime.
Ekipet lëndore	› Identifikojnë nevojat specifike për kompetencat digjitale në kuadër të fushës/lëndës të tyre. › Organizojnë takime dhe sesione praktike brenda ekipit lëndor për të shkëmbyer praktika të mira në përdorimin e mjeteve dhe burimeve digjitale specifike për lëndën. › Ofrojnë mentorim dhe mbështetje praktike për kolegët e ekipit lëndor për integrimin e teknologjisë në mësimdhënien e fushës/lëndës. › Angazhohen në zhvillimin dhe përshtatjen e burimeve digjitale mësimore specifike për fushën/lëndën, duke i ndarë ato me anëtarët e tjerë të ekipit. › Propozojnë nevojat për aktivitete trajnuese specifike të fushës/lëndës në fushën digjitale drejtuesve të shkollës.
Koordinatori i cilësisë	› Ndërton një urë lidhëse ndërmjet drejtorisë së shkollës, Grupit qendror të vlerësimit të brendshëm, ekipeve lëndore dhe stafit mësimor në lidhje me politikat, udhëzimet dhe proceset e vlerësimit të kompetencave digjitale. › Ofron mbështetje dhe asistencë për mësuesit në kuptimin dhe zbatimin e metodologjisë së vlerësimit të nivelit të kompetencave

	digjitale, përfshirë përdorimin e instrumenteve të vlerësimit (vetëvlerësimi, anketat, portofolat digjitale etj.). ‣ Monitoron ecurinë e mësuesve në zhvillimin e nivelit të kompetencave digjitale, duke identifikuar sfidat dhe duke propozuar zgjidhje. ‣ Në bashkëpunim me drejtorin e shkollës dhe Ekipet lëndore, identifikon nevojat për trajnime dhe zhvillim profesional specifik në fushën e kompetencave digjitale, duke ndihmuar në organizimin e veprimtarive përkatëse. ‣ Mbështet grupin qendror të vlerësimit të brendshëm në mbledhjen, përpunimin dhe analizën e të dhënave të vlerësimit të nivelit të kompetencave digjitale në nivel shkolle, duke siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit. ‣ Ndihmon në hartimin e raporteve periodike për drejtorin e shkollës, duke ofruar përfundime dhe rekomandime të bazuara në të dhënat e vlerësimit. ‣ Nxit dhe përkrah shkëmbimin e praktikave më të mira në përdorimin e teknologjisë dhe mjeteve digjitale në procesin mësimor midis mësuesve. ‣ Vlerëson në mënyrë të vazhdueshme efikasitetin e proceseve të vlerësimit dhe zhvillimit të kompetencave digjitale, duke propozuar masa për përmirësimin e cilësisë së tyre.
--	---



PARIMET E VLERËSIMIT

Vlerësimi i saktë dhe i drejtë i nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve është thelbësor për të identifikuar nevojat për zhvillim profesional, për të mbështetur rritjen e mësuesve dhe për të siguruar që nxënësit të përfitojnë nga mësimdhënia efektive e ndërthurur me teknologjinë.

Ky kapitull paraqet parimet themelore që duhet të udhëheqin procesin e vlerësimit të nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve. Këto parime ofrojnë një kuadër etik dhe metodologjik për të siguruar që vlerësimi të jetë i drejtë, i vlefshëm, i besueshëm dhe i dobishëm. Ato marrin parasysh vështirësinë e përcaktimit të kompetencës digjitale, rolet e ndryshme që mësuesit luajnë në mjedise të pasura me teknologji dhe nevojën për zhvillim profesional të vazhdueshëm.

Duke zbatuar këto parime, ne mund të krijojmë një sistem vlerësimi që, jo vetëm mat aftësitë digjitale të mësuesve, por edhe përkrah rritjen e tyre profesionale dhe përmirëson cilësinë e shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit.

Më poshtë janë disa parime të rëndësishme që duhet të udhëheqin vlerësimin e kompetencave digjitale të mësuesve:


Parimet	Përshkrimi
Besueshmëria dhe cilësia e vlerësimit	Vlerësimi duhet të jetë paanshëm dhe transparent, duke shmangur çdo paragjykim dhe duke siguruar që procesi, nga hartimi i instrumenteve deri te raportimi, është i qartë dhe i kuptueshëm për të gjitha palët. Njëkohësisht, ai duhet të jetë i vlefshëm (të masë saktë atë që synon) dhe i besueshëm (të japë rezultate konsistente), duke garantuar cilësinë dhe saktësinë e të dhënave.
Gjithëpërfshirja	Vlerësimi duhet të mbulojë të gjitha dimensionet kyçe të kompetencës digjitale të mësuesit, duke përfshirë njohuritë teknike, aftësitë pedagogjike digjitale, menaxhimin e informacionit, komunikimin dhe bashkëpunimin online, sigurinë digjitale, dhe zhvillimin e qytetarisë digjitale. Këto dimensione

	duhet të vlerësohen në mënyrë të ndërthurur, duke reflektuar ndërlikimin që ato kanë dhe ndërvarësinë e tyre.
Lidhja me situatat reale dhe zhvillimi i vazhdueshëm	Vlerësimi duhet të jetë i ndjeshëm ndaj rrethanave të veçanta të punës së mësuesit (p.sh., lënda, niveli i arsimit, infrastruktura shkollore) dhe të njohë natyrën dinamike të zhvillimit të kompetencave digjitale. Ai duhet të jetë një proces i vazhdueshëm, i cili monitoron ecurinë, identifikon nevojat e reja dhe ofron bazën për zhvillim profesional të personalizuar dhe të vazhdueshëm.
Pjesëmarrja dhe reflektimi	Vlerësimi duhet të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të mësuesve në procesin e tyre të vlerësimit, duke përfshirë vetëvlerësimin dhe vlerësimin nga kolegët. Ai duhet të nxisë reflektimin e thellë mbi praktikatat e tyre digjitale, arritjet dhe fushat për përmirësim, duke i fuqizuar mësuesit të marrin në dorë zhvillimin e tyre profesional.
Lidhja me Kurrikulën dhe Pedagogjinë	Vlerësimi nuk duhet të izolohehet, por të lidhet ngushtë me kurrikulën e shkollës dhe rezultatet e të nxënësve. Ai duhet të theksojë përdorimin e teknologjisë si një mjet për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënësve, për të rritur angazhimin e nxënësve dhe për të zhvilluar kompetencat e tyre digjitale, jo thjesht si zëvendësim të metodave tradicionale.
Vlerat, etika dhe qytetaria digjitale	Vlerësimi duhet të sigurojë që mësuesit përdorin teknologjinë në përputhje me parimet etike dhe vlerat thelbësore të profesionit, duke e përdorur atë për të mbështetur të gjithë nxënësit, për të ruajtur standarde të larta, për të promovuar barazinë dhe përfshirjen, dhe për ta përdorur atë në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme. Ai duhet të vlerësojë gjithashtu aftësitë e mësuesve për të modeluar sjellje të qytetarisë digjitale dhe për të krijuar një mjedis pozitiv mësimor digjital.

FUSHAT E VLERËSIMIT TË NIVELIT TË KOMPETENCE DIGJITALE

Në kontekstin dinamik të arsimit parauniversitar shqiptar, i cili po përballlet me imperativat e digjitalizimit të shoqërisë dhe kërkesat e tregut të punës së shekullit 21, përcaktimi i fushave të vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve merr një rëndësi strategjike. Këto fusha nuk janë thjesht një listë aftësish teknike, por një kornizë e integruar që reflekton kompleksitetin e rolit të mësuesit në një mjedis të pasur me teknologji.

Duke u mbështetur në modelet dhe kornizat ndërkombëtare të kompetencave digjitale për mësuesit, si dhe duke marrë parasysh reformat kombëtare në kurrikul dhe sfidat specifike të kontekstit shqiptar, janë identifikuar gjashtë fusha kryesore që duhet të përfshijnë vlerësimin e kompetencave digjitale të mësuesve:



Këto fusha të ndërlidhura përbëjnë një kornizë të plotë për vlerësimin dhe zhvillimin e nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve, duke i pajisur ata me mjetet dhe aftësitë e nevojshme për të përgatitur brezin e ri për sfidat dhe mundësitë e botës digjitale.

Fusha 1: Angazhimi profesional

Në realitetin e sotëm arsimor, zhvillimi i vazhdueshëm profesional i mësuesve është një nevojë thelbësore për sigurimin e cilësisë në procesin mësimor, dhe jo një zgjedhje e lirë. Teknologjia luan një rol të rëndësishëm në këtë proces, duke ofruar shumë mundësi dhe burime për mësuesit që kërkojnë të përmirësojnë kompetencat e tyre digjitale dhe pedagogjike. Për mësuesit, të cilët po përballen me sfidat e një sistemi arsimor gjithnjë e më të digjitalizuar, zhvillimi profesional i pajisur me teknologji është një nevojë e menjëhershme për të pasur sukses.

Interneti është një minierë e pashtershme burimesh për zhvillimin profesional të mësuesve. Kurset online masive të hapura (MOOCs)¹, seminarët në rrjet, materialet mësimore të hapura (OER)², platformat e zhvillimit profesional, revistat shkencore online, forumet e diskutimit dhe rrjetet sociale profesionale janë vetëm disa shembuj të shumëllojshmërisë së burimeve që mund të shfrytëzohen. Këto burime ofrojnë mundësi të shumta për mësuesit për të mësuar në ritmin e tyre, nga kudo dhe në çdo kohë. Ata mund të ndjekin kurse të ofruara nga universitete të njohura ndërkombëtare, të marrin pjesë në seminare në rrjet të mbajtura nga ekspertë të fushës, të shkëmbejnë ide dhe materiale me kolegët dhe të qasen në literaturë shkencore të re.

Megjithatë, qasja në këto burime nuk mjafton, pasi mësuesit duhet të zhvillojnë aftësi të caktuara për të gjetur, vlerësuar dhe përdorur këto burime në mënyrë efektive. Ata duhet të jenë në gjendje të identifikojnë burimet e besueshme dhe të cilësisë së lartë, të vlerësojnë përmbajtjen e tyre në lidhje me nevojat e tyre specifike dhe të integrojnë njohuritë dhe aftësitë e reja të fituara në praktikën e tyre të përditshme. Kjo kërkon një qasje parashikuese dhe të vetëdrejtuar ndaj të nxënit, si dhe një ndërgjegjësim për qëllimet e zhvillimit profesional.

Zhvillimi profesional i pajisur me teknologji duhet të ketë një qëllim të dyfishtë: përmirësimin e kompetencave digjitale dhe atyre pedagogjike të mësuesve. Nga njëra anë, mësuesit duhet të zhvillojnë aftësi të nevojshme për të përdorur teknologjinë në mënyrë efektive, duke përfshirë aftësitë për të përdorur mjete digjitale, për të krijuar materiale mësimore ndërvepruese, për të menaxhuar klasën në një mjedis digjital dhe për të vlerësuar përparimin e nxënësve nëpërmjet

¹ MOOCs janë kurse trajnimi apo mësimi që ofrohen në mënyrë digjitale për një numër të madh njerëzish, pa kufizime hyrëse (si moshë, vendndodhje apo kualifikime të mëparshme), zakonisht falas ose me kosto të ulët.

² Burimet e Hapura Edukative (OER) janë materiale mësimore, mësimdhënieje apo trajnimi që janë në dispozicion falas për këdo dhe mund të përdoren, përshtaten, shpërndahen dhe ripërdoren ligjërisht, zakonisht nën një licencë të hapur (si p.sh. Creative Commons).



mjeteve digjitale. Nga ana tjetër, mësuesit duhet të përdorin teknologjinë si një mjet për të përmirësuar praktikën e tyre pedagogjike, duke zbuluar qasje të reja, duke personalizuar mësimin për çdo nxënës dhe duke nxitur bashkëpunimin dhe krijimtarinë në klasë.

Zhvillimi profesional i vazhdueshëm i pajisur me teknologji nuk është vetëm një përgjegjësi individuale e mësuesve, por edhe një investim në të ardhmen e arsimit shqiptar. Duke u pajisur me kompetencat e nevojshme digjitale dhe pedagogjike, mësuesit mund të transformojnë mësimdhënien dhe të nxënës, të angazhojnë nxënësit në një mënyrë më ndërvepruese dhe tërheqëse dhe t'i përgatisin ata për sukses në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar dhe të digjitalizuar. Ky është një rrugëtim i gjatë dhe sfidues, por një rrugëtim që ia vlen të ndiqet.

Mësuesit kanë në dispozicion një sërë mjedesh digjitale për të komunikuar dhe bashkëpunuar me kolegët, nxënës, prindërit dhe komunitetin e gjerë. Këtu përfshihen platformat e komunikimit online siç janë email-i, aplikacionet e mesazheve të çastit, rrjetet sociale profesionale siç janë LinkedIn, forumet e diskutimit, mjetet e bashkëpunimit në distancë siç janë Google Workspace³ (hapësira e Google) ose Microsoft Teams⁴, (Skudra e Microsoft) etj.

Vlerësimi i kompetencës së komunikimit dhe bashkëpunimit të mësuesve përfshin një analizë të praktikave të tyre të komunikimit me kolegët, nxënës dhe prindërit, si dhe vlerësimin e angazhimit të tyre në bashkëpunime online dhe komunitete profesionale. Ai përqendrohet në mënyrën se si mësuesit përdorin mjetet digjitale për të komunikuar me të gjithë aktorët e interesuar. A janë këto komunikime të efektshme, të qarta, të përshtatshme dhe të respektueshme? A përdorin ata platforma të ndryshme, duke marrë parasysh pëlqimet dhe mundësitë e tyre? Për shembull, a janë mësuesit të vetëdijshëm për faktin se jo të gjithë prindërit kanë qasje të rregullt në internet dhe a ofrojnë ata alternativa për komunikim?

Vlerësimi i bashkëpunimit online shqyrton nëse mësuesit janë të angazhuar në bashkëpunime online me kolegët e tyre, brenda dhe jashtë Shqipërisë. A shkëmbejnë ata ide, materiale dhe praktika të mira? A janë ata të hapur për të mësuar nga të tjerët dhe për të ndarë përvojat e tyre?

³ Google Workspace (më parë i njohur si G Suite) është një paketë aplikacionesh të integruara nga Google, e krijuar për bashkëpunim, komunikim dhe prodhimtari, veçanërisht për shkollat, biznese dhe organizata.

⁴ Microsoft Teams është një platformë e zhvilluar nga Microsoft për bashkëpunim në grup, komunikim në kohë reale dhe menaxhim pune, e përdorur gjerësisht në arsimin parauniversitar, universitar dhe në administratë publike apo sektorin privat.

A përdorin ata mjete bashkëpunimi online për të punuar në projekte të përbashkëta, për të zhvilluar materiale mësimore ose për të organizuar aktivitete profesionale? Etj.

Treguesit dhe përshkruesit për fushën 1: Angazhimit Profesional

Treguesit	Përshkruesit
1.1. Mësuesi përdor në mënyrë efektive teknologjinë e informacionit për të komunikuar dhe bashkëpunuar me kolegët, nxënësit, prindërit dhe komunitetin e gjerë, duke ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme dhe duke nxitur një mjedis arsimor bashkëpunues.	1.1.1. Mësuesi përdor platforma dhe mjete digjitale (e-mail, rrjete sociale profesionale, platforma bashkëpunimi) për të komunikuar qartë, në kohë dhe me respekt me kolegët, nxënësit dhe prindërit.
	1.1.2. Mësuesi përshtat stilin dhe mjetin e komunikimit digjital sipas audiencës, qëllimit dhe mundësive të palëve (p.sh., ofron alternativa për qasje të kufizuar në internet).
	1.1.3. Mësuesi merr pjesë dhe ndihmon aktivisht në bashkëpunime online me kolegët (brenda/jashtë shkollës) për shkëmbimin e ideve, burimeve dhe praktikave të mira, duke përdorur mjete bashkëpunimi.
	1.1.4. Mësuesi shfaq etikë profesionale dhe sjellje të përgjegjshme në të gjitha ndërveprimet digjitale, duke ndërtuar marrëdhënie pozitive dhe duke ruajtur të dhënat vetjake dhe privatësinë.
1.2. Mësuesi angazhohet në zhvillimin profesional të vazhdueshëm duke shfrytëzuar teknologjinë.	1.2.1 Mësuesi ndjek rregullisht dhe angazhohet aktivisht në kurse online seminare web dhe veprimtari të tjera digjitale të zhvillimit profesional.
	1.2.2. Mësuesi identifikon, vlerëson në mënyrë kritike dhe përdor burime arsimore të hapura (OER) dhe literaturë shkencore online për përmirësimin e kompetencave lëndore, pedagogjike dhe digjitale.

	1.2.3. Mësuesi reflekton në mënyrë të vazhdueshme mbi praktikën e tij/saj profesionale duke përdorur mjete digjitale (blogje, platforma reflektimi, portofolin digjital) për të dokumentuar përparimin dhe për të marrë feedback.
	1.2.4. Mësuesi është i vetëdijshëm për licencat e hapura (p.sh., Creative Commons) dhe të drejtat e autorit në kontekstin digjital, duke i respektuar dhe zbatuar ato gjatë përdorimit të materialeve dhe burimeve.
1.3. Mësuesi ndihmon në risinë pedagogjike dhe shfaq udhëheqjen në arsimin digjital.	1.3.1. Mësuesi është i hapur dhe eksperimenton me metoda të reja të mësimdhënies me teknologji, duke marrë parasysh rreziqe të llogaritura dhe duke mësuar nga rezultatet.
	1.3.2. Mësuesi ndan në mënyrë të vetëdijshme praktikatat e mira dhe burimet e reja me kolegët, duke ndihmuar në zhvillimin e kurrikulave dhe materialeve mësimore të reja.
	1.3.3. Mësuesi merr pjesë në projekte kombëtare ose ndërkombëtare që mbështetin rinisë në arsimin digjital, duke kërkuar vazhdimisht mundësi për zhvillim.
	1.3.4. Mësuesi tregon aftësi udhëheqëse duke ndihmuar kolegët të zhvillojnë kompetencat digjitale dhe duke ndikuar në procesin e vendimmarrjes në shkollë në lidhje me integrimin e teknologjisë.



Fusha 2: Burimet digjitale

Në epokën digjitale, burimet mësimore nuk kufizohen më në librat e shtypur dhe materialet tradicionale. Interneti ka hapur një botë të re mundësish për mësuesit, duke u ofruar qasje të menjëhershme në një tërësi të pafund burimesh digjitale. Aftësia për të shfrytëzuar në mënyrë efektive këto burime jo vetëm që pasuron procesin mësimor, por gjithashtu u lejon mësuesve të personalizojnë mësimin, të nxisin krijimtarinë e nxënësve dhe t'i përgatitin ata për një të ardhme të suksesshme.

Gjetja e burimeve digjitale të përshtatshme është një hap i parë kritik. Mësuesit duhet të jenë të aftë të përdorin motorë kërkimi, baza të të dhënave arsimore dhe platforma të specializuara për të gjetur materiale mësimore, video, imazhe, infografi, simulime, lojëra edukative dhe shumë lloje të tjera burimesh. Kjo kërkon aftësi të mira kërkimi, njohuri për fjalët kyçe të duhura dhe aftësi për të vlerësuar cilësinë dhe besueshmërinë e burimeve të gjetura, si edhe mund të përfshijë kërkimin në platforma kombëtare dhe ndërkombëtare, duke marrë parasysh praninë e burimeve në gjuhën shqipe ose duke shfrytëzuar përkthyesit online kur është e nevojshme.

Mësuesit nuk duhet të jenë thjesht konsumatorë të informacionit, por duhet të zhvillojnë aftësinë për të shqyrtuar me kujdes çdo burim, duke vlerësuar saktësinë, besueshmërinë, vlefshmërinë dhe përshtatshmërinë e tij. Kjo është një detyrë që kërkon vëmendje dhe një sy kritik, pasi jo çdo informacion i gjetur në internet është i vërtetë apo i përshtatshëm për t'u përdorur në klasë.

Së pari, mësuesit duhet të hetojnë saktësinë dhe besueshmërinë e burimit. A është informacioni i paraqitur i saktë dhe i bazuar në fakte të verifikuara? A mbështetet ai nga burime të tjera të besueshme? A është autori i kualifikuar dhe i njohur në fushën e tij? Këto janë pyetje që mësuesit duhet t'i bëjnë vetes për të siguruar që informacioni të jetë i besueshëm dhe i vlefshëm.

Më pas, vëmendja zhvendoset te vlefshmëria dhe aktualiteti i informacionit. A është informacioni i përditësuar dhe i vlefshëm për qëllimin e synuar? A përputhet ai me kurrikulën dhe standardet mësimore? Në një botë që ndryshon me shpejtësi, informacioni mund të vjetërohet shpejt, ndaj mësuesit duhet të jenë të vëmendshëm ndaj datës së publikimit dhe të përditësimeve të fundit.



Një tjetër aspekt i rëndësishëm është përshtatshmëria me nxënësit. A janë burimet e përshtatshme për nivelin e moshës, aftësitë dhe interesat e nxënësve? A ofrojnë ato sfida të përshtatshme dhe mbështetje të nevojshme? Mësuesit duhet të jenë të ndjeshëm ndaj nevojave të ndryshme të nxënësve dhe të zgjedhin burime që janë të përshtatshme për të gjithë, duke marrë parasysh larminë e stilit të të nxënësve dhe aftësive.

Së fundi, mësuesit duhet të vlerësojnë aspektet teknike dhe pedagogjike të burimeve. A janë burimet e lehta për t'u përdorur dhe integruar në procesin mësimor? A ofrojnë ato ndërvëprim, angazhim dhe mundësi për të nxënë aktiv? Një burim i shkëlqyer nga pikëpamja e përmbajtjes mund të jetë i paefektshëm nëse është teknikisht i vështirë për t'u përdorur ose nuk ofron mundësi për ndërvëprim dhe angazhim të nxënësve. Ky proces i vlerësimit kritik është një hap i domosdoshëm për të siguruar që burimet digjitale që mësuesit përdorin në klasë janë të besueshme, të vlefshme, të përshtatshme dhe efektive.

Për mësuesit, vlerësimi mund të përfshijë gjithashtu shqyrtimin e cilësisë së përkthimeve, nëse burimet janë në një gjuhë tjetër, dhe vlerësimin e rëndësisë kulturore të burimeve për rrethanat e realitetit shqiptar. Përveç gjetjes dhe vlerësimit të burimeve ekzistuese, mësuesit duhet të jenë gjithashtu të aftë të krijojnë materiale të reja digjitale. Kjo mund të përfshijë krijimin e prezantimeve interaktive, videove edukative, infografikëve, kuiceve online, detyrave të personalizuar dhe shumë lloje të tjera burimesh. Krijimi i burimeve digjitale u lejon mësuesve të përshtatin materialet mësimore me nevojat specifike të nxënësve, të integrojnë teknologjinë në mënyrë efektive në mësimdhënie dhe të nxisin krijimtarinë e tyre dhe të nxënësve.

Mësuesit duhet të jenë të aftë të shpërndajnë burimet digjitale me kolegët, nxënësit dhe komunitetin e gjerë. Kjo mund të bëhet nëpërmjet platformave të ndryshme, siç janë faqet e internetit të shkollave, platformat e menaxhimit të të nxënësve (LMS⁵), rrjetet sociale profesionale dhe depozitat e burimeve arsimore të hapura (OER). Shpërndarja e burimeve digjitale jo vetëm që lehtëson qasjen në materiale mësimore cilësore, por gjithashtu nxit bashkëpunimin dhe shkëmbimin e përvojave midis mësuesve.

Zhvillimi i kompetencave në fushën e burimeve digjitale paraqet sfida për mësuesit (qasja e kufizuar në internet, pajisje digjitale në disa shkolla, mungesa e trajnimeve të specializuara dhe

⁵ LMS është një platformë digjitale që përdoret për planifikimin, ofrimin, ndjekjen dhe vlerësimin e procesit të të nxënësve dhe mësimdhënies, si në arsimin zyrtar ashtu edhe në trajnimet profesionale.

mbështetja e pamjaftueshme nga institucionet arsimore), por ata duhet të shfrytëzojnë burimet ekzistuese, të kërkojnë trajnime online, të bashkëpunojnë me kolegët dhe të synojnë për një qasje më të integruar ndaj arsimit digjital.

Treguesit dhe përshkruesit e fushës: Burimet digjitale

Treguesit	Përshkruesit
2.1. Mësuesi njih dhe përdor motorë kërkimi dhe të dhëna arsimore, për të gjetur burime digjitale të përshtatshme, në funksion të mësimdhënies dhe të të nxënit.	2.1.1. Mësuesi përdor në mënyrë efektive motorë kërkimi të ndryshëm dhe baza të të dhënave arsimore (ERIC, JSTOR etj.).
	2.1.2. Mësuesi përdor fjalë kyçe të duhura dhe strategji të përparuara kërkimi.
	2.1.3. Mësuesi njih dhe përdor platforma të ndryshme dhe burime të nxëni arsimore të hapura për të gjetur materiale mësimore, video, imazhe dhe lloje të tjera burimesh.
	2.1.4. Mësuesi përdor burime në gjuhë të ndryshme ose shfrytëzon përkthyesit online për të kuptuar dhe përdorur burime në gjuhë të tjera.
2.2. Mësuesi vlerëson, identifikon dhe përdor burime digjitale të sakta, të besueshme dhe të përshtatshme.	2.2.1. Mësuesi vlerëson në mënyrë kritike saktësinë e informacionit nga burimet digjitale, duke shqyrtuar faktet dhe duke krahasuar me të paktën dy burime të tjera të besueshme.
	2.2.2. Mësuesi analizon burimin e informacionit (autorin, datën e publikimit, besueshmërinë e platformës/faques së internetit) për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit.
	2.2.3. Mësuesi vlerëson vlefshmërinë dhe aktualitetin e informacionit në raport me qëllimet mësimore dhe standardet kurrikulare, duke siguruar që burimi është i rëndësishëm dhe i përditësuar.

	2.2.4. Mësuesi përzgjedh burime digjitale që janë të përshtatshme për nivelin e moshës, aftësitë, interesat dhe sfidat e të nxënësve, duke marrë parasysh larminë e tyre.
	2.2.5. Mësuesi ndërthur burime digjitale që nxisin ndërveprimin, angazhimin dhe të nxënin aktiv të nxënësve, të cilat janë lehtësisht të përdorshme dhe nga ana teknologjike të përshtatshme me pajisjet në dispozicion.
2.3. Mësuesi shfaq aftësinë për të vlerësuar aspektet teknike dhe pedagogjike të burimeve digjitale.	2.3.1. Mësuesi vlerëson burimet digjitale duke marrë parasysh lehtësinë e përdorimit të tyre, integrimin efektiv në procesin mësimor.
	2.3.2. Mësuesi vlerëson ndikimin e burimeve digjitale në ndërveprimin, angazhimin dhe të nxënit aktiv të nxënësve.
	2.3.3. Mësuesi shqyrton cilësinë teknike të burimeve, duke analizuar faktorin pamor si qartësia e imazheve, cilësia e audios dhe videos.
	2.3.4. Mësuesi shqyrton përshtatshmërinë e burimeve digjitale me pajisjet që ka në dispozicion shkolla apo nxënësit.
2.4. Mësuesi shfaq aftësinë për të krijuar materiale mësimore digjitale, si dhe aftësinë për t'i shpërndarë ato me kolegët dhe nxënësit.	2.4.1. Mësuesi krijon materiale mësimore digjitale (p.sh., prezantime interaktive, video, kuice) të përshtatshme për nevojat e nxënësve dhe objektivat e kurrikulës, duke siguruar cilësinë e përmbajtjes dhe përshtatshmërinë pedagogjike.
	2.4.2. Mësuesi krijon dhe shpërndan burime të hapura edukative (OER), duke përdorur licenca të hapura dhe ndihmon aktivisht në komunitetin arsimor duke i bërë ato të mundshme për përdorim nga të tjerët.
	2.4.3. Mësuesi shpërndan burime digjitale përmes platformave të ndryshme (p.sh., faqet e internetit të shkollave, LMS, rrjetet

	sociale profesionale) dhe zgjedh mjetet/platformën më të përshtatshme për audiencën dhe qëllimin.
	2.4.4. Mësuesi është i vetëdijshëm për rëndësinë e burimeve digjitale të hapura dhe bashkëpunimit në përmirësimin e cilësisë së arsimit.



Fusha 3: Mësimdhënia dhe të nxënit e pajisur me teknologji

Fusha e “Mësimdhënies dhe të Nxënit” në kontekstin e kompetencave digjitale të mësuesve përfaqëson thelbin e integritit të teknologjisë në arsim. Ajo përqendrohet në aftësinë e mësuesve për të planifikuar, zbatuar dhe menaxhuar procesin mësimor në mënyrë efektive duke përdorur teknologjinë. Kjo nuk nënkupton vetëm përdorimin e mjeteve digjitale në klasë, por një transformim të tërësishëm të qasjes pedagogjike, duke krijuar mjedise mësimore ndërvepruese dhe tërheqëse, duke mbështetur të nxënit e personalizuar dhe duke nxitur bashkëpunimin dhe krijimtarinë e nxënësve.

Planifikimi i mësimit në epokën digjitale kërkon një qasje afatgjatë. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të identifikojnë qëllimet e qarta të të nxënit dhe t'i përshtatin ato me përdorimin e teknologjisë. Kjo përfshin zgjedhjen e mjeteve dhe platformave të duhura digjitale që do të mbështesin më mirë arritjen e këtyre qëllimeve. Për shembull, një mësues që dëshiron të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik të nxënësve mund të zgjedhë të përdorë platforma online që ofrojnë simulime dhe studime rastesh, ndërsa një mësues që synon të nxisë bashkëpunimin mund të përdorë mjete bashkëpunimi online si Google Workspace ose Microsoft Teams.

Për mësuesit, planifikimi i mësimit të pajisur me teknologji mund të përfshijë gjithashtu marrjen parasysh të infrastrukturës digjitale në shkollë dhe qasjen e nxënësve në pajisje dhe internet. Në disa raste, mund të jetë e nevojshme të ndërthuren metodat tradicionale me ato digjitale, duke krijuar një qasje të përzier që rrit efektivitetin e mësimit.

Zbatimi i mësimit i pajisur me teknologji duhet të jetë ndërveprues dhe tërheqës për nxënësit. Mësuesit mund të përdorin teknologjinë për të krijuar paraqitje tërheqëse, video edukative, infografi dhe materiale të tjera që e bëjnë mësimin më vizual dhe të kuptueshëm.

Platformat online dhe aplikacionet mobile mund të ofrojnë mundësi për të nxënë ndërveprues, duke përfshirë kuice, lojëra edukative dhe simulime që i angazhojnë nxënësit në mënyrë aktive në procesin e të nxënit.

Përdorimi i teknologjisë në klasë mund të jetë një mënyrë për të kapërcyer mungesën e burimeve të tjera mësimore dhe për t'i bërë mësimet më tërheqëse dhe me rëndësi për nxënësit. Për shembull, mësuesit e historisë mund të përdorin realitetin virtual për t'i çuar nxënësit në



vende historike, ndërsa mësuesit e shkencës mund të përdorin simulime ndërvepruese për t'u shpjeguar koncepte të vështira.

Menaxhimi i klasës në një mjedis digjital kërkon aftësi të reja nga mësuesit. Ata duhet të jenë në gjendje të organizojnë dhe menaxhojnë pajisjet digjitale, të sigurojnë qasje të barabartë për të gjithë nxënësit dhe të mbajnë një mjedis të sigurt dhe të respektueshëm online. Kjo përfshin gjithashtu menaxhimin e kohës dhe vëmendjes së nxënësve, duke i ndihmuar ata të përkushtohen në detyrë dhe të shmangin shpërqendrimin nga teknologjia.

Për mësuesit, menaxhimi i klasës në një mjedis digjital mund të jetë një sfidë, por edhe një mundësi për të përmirësuar efektivitetin e mësimit. Përdorimi i platformave të menaxhimit të nxënës (LMS) mund të lehtësojë organizimin e detyrave, komunikimin me nxënësit dhe prindërit dhe vlerësimin e përparimit të nxënësve. Mësuesit mund të përdorin platforma online dhe aplikacione mobile për të ofruar burime dhe veprimtari të përshtatura me nivelin e aftësive, interesat dhe stilin e të nxënës të çdo nxënësi. Kjo u lejon atyre të ofrojnë mbështetje shtesë për nxënësit që kanë vështirësi, si dhe sfida për nxënësit që janë më të përparuar.

Të nxënës të personalizuar dhe i diferencuar mund të jetë një mënyrë për të adresuar larminë e madhe në klasa dhe për të siguruar që çdo nxënësi të ketë mundësinë të arrijë aftësinë e tij/saj të plotë. Përdorimi i teknologjisë mund të ndihmojë mësuesit të identifikojnë nevojat individuale të nxënësve dhe të ofrojnë mbështetje të personalizuar.

Teknologjia mund të jetë një mjet i fuqishëm për të nxitur bashkëpunimin dhe krijimtarinë e nxënësve. Mësuesit mund të përdorin mjete bashkëpunimi online për t'i lejuar nxënësit të punojnë së bashku në projekte, të shkëmbejnë ide dhe të ndajnë materiale.

Platformat online dhe aplikacionet mobile mund të ofrojnë mundësi për nxënësit të shprehin krijimtarinë e tyre nëpërmjet krijimit të videove, infografikëve, prezantimeve dhe projekteve të tjera digjitale.

Nxitja e bashkëpunimit dhe krijimtarisë është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e një tregu pune që kërkon aftësi të tilla. Përdorimi i teknologjisë mund t'i ndihmojë mësuesit t'i përgatisin nxënësit për sfidat e shekullit 21, duke u ofruar atyre mundësi për të zhvilluar aftësitë e tyre të komunikimit, bashkëpunimit, të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve.



Teknologjia ofron mjete të ndryshme për të vlerësuar përparimin e nxënësve në mënyrë më efikase dhe efektive. Mësuesit mund të përdorin platforma online për të krijuar kuice, teste dhe detyra që vlerësojnë të kuptuarin e koncepteve dhe aftësive të nxënësve. Këto platforma shpesh ofrojnë feedback të menjëhershëm për nxënësit, duke i ndihmuar ata të identifikojnë pikat e tyre të forta dhe të dobëta.

Treguesit dhe përshkruesit për fushën: Mësimdhënia dhe të nxënit e pajisur me teknologji

Treguesit	Përshkruesit
3.1. Mësuesi planifikon dhe zgjedh në mënyrë strategjike mjetet dhe platformat digjitale për të arritur qëllimet e qarta të të nxënit dhe për të mbështetur një integrim funksional të teknologjisë.	3.1.1. Mësuesi përcakton qëllime SMART (<i>Specifike, të Matshme, të Arritshme, të Rëndësishme, të Kufizuara në Kohë</i>) të të nxënit për çdo njësi mësimore dhe planifikon përdorimin e teknologjisë si një mjet thelbësor për arritjen e tyre.
	3.1.2. Mësuesi përzgjedh në mënyrë të ndërgjegjshme mjetet dhe platformat digjitale (aplikacione, programe, faqe interneti, LMS) që mbështesin më mirë arritjen e objektivave të të nxënit dhe i njeh përparësitë/vështirësitë e secilës.
	3.1.3. Mësuesi siguron që përdorimi i teknologjisë të jetë i integruar në mënyrë funksionale dhe pedagogjike, jo thjesht si një shtesë, duke ndihmuar në transformimin e qasjes mësimore.
	3.1.4. Mësuesi vlerëson rregullisht (p.sh., në fund të çdo kapitulli/teme) ndikimin e teknologjisë në procesin e të nxënit, angazhimin dhe ecurinë e nxënësve, duke përdorur feedback zyrtar dhe jozyrtar.

3.2. Mësuesi zbaton me efektivitet mësimin e përzier (blended learning), duke përshtatur metodologjitë dhe burimet digjitale me infrastrukturën dhe qasjen e nxënësve në teknologji.	3.2.1. Mësuesi planifikon dhe zbaton qasje të mësimin të përzier, duke drejtpeshuar metodat tradicionale me ato digjitale për të rritur efektivitetin e të nxënësve.
	3.2.2. Mësuesi analizon dhe merr parasysh realitetin e infrastrukturës digjitale në shkollë dhe qasjen e nxënësve në pajisje dhe internet gjatë planifikimit, duke përshtatur planet mësimore.
	3.2.3. Mësuesi ofron në mënyrë paraprake alternativa për nxënësit që nuk kanë qasje të rregullt në teknologji (p.sh., materiale offline, orë shtesë, punë në grup), duke siguruar qasje të barabartë për të gjithë.
	3.2.4. Mësuesi monitoron dhe vlerëson efektivitetin e metodave të përziera në fund të çdo moduli ose projekti të madh, duke analizuar të dhënat e performancës dhe feedback-un për përmirësim të vazhdueshëm.
	3.2.5. Mësuesi hulumton risi teknologjike dhe përshtat praktikatat e tij për të përmirësuar përvojën mësimore.
	3.2.6. Mësuesi planifikon dhe zbaton qasje të mësimin të përzier, duke drejtpeshuar metodat tradicionale me ato digjitale për të rritur efektivitetin e të nxënësve.
3.3. Mësuesi krijon dhe menaxhon mjedise mësimore interaktive, tërheqëse dhe të sigurta duke përdorur teknologjinë, duke nxitur bashkëpunimin dhe krijimtarinë.	3.3.1. Mësuesi përdor teknologjinë për të krijuar prezantime dinamike, video edukative, infografi dhe materiale të tjera që e bëjnë mësimin më vizual, ndërveprues dhe tërheqës për nxënësit.
	3.3.2. Mësuesi shfrytëzon platforma online dhe aplikacione për të ofruar mundësi për të nxënë ndërveprues (p.sh., kuice, lojëra edukative, simulime) dhe krijon veprimtari që nxitin nxënësit të zbulojnë në mënyrë të pavarur.

	3.3.3. Mësuesi menaxhon në mënyrë efektive pajisjet digjitale, siguron qasje të barabartë dhe mban një mjedis të sigurt dhe respektueshëm online, duke përfshirë menaxhimin e vëmendjes së nxënësve.
	3.3.4. Mësuesi përdor mjete digjitale për të ofruar detyra sfiduese dhe të personalizuar që adresojnë nevojat dhe nivelet e ndryshme të nxënësve, duke nxitur të nxënit e diferencuar.
	3.3.5. Mësuesi përdor mjete bashkëpunimi online (p.sh., Google Docs, Teams etj.) për t'i lejuar nxënësit të punojnë së bashku në projekte, të shkëmbejnë ide dhe të ndajnë materiale, duke nxitur kreativitetin e tyre nëpërmjet krijimit të produkteve digjitale.
	3.3.6. Mësuesi përdor platforma online për të krijuar dhe administruar kuice, teste dhe detyra, duke ofruar feedback të menjëhershëm dhe duke vlerësuar përparimin e nxënësve në mënyrë efikase.



Fusha 4: Vlerësimi

Në epokën digjitale, vlerësimi i përparimit të nxënësve ka evoluar nga një proces statik në një proces dinamik, të gjithanshëm dhe thellësisht transformues. Përdorimi i teknologjisë për të matur, personalizuar dhe thelluar të nxënit, krijon një pasqyrë më të plotë të rrugëtimit arsimor të çdo nxënësi. Kjo fushë vlerëson aftësinë e mësuesve për të shfrytëzuar potencialin e teknologjisë për vlerësimin formues dhe përmbledhës, portofolin digjital, ofrimin e feedback-ut dhe analizën e të dhënave. Në kuadër të kompetencave digjitale të mësuesve nuk është thjesht një listë mjetesh apo platformash, por një filozofi e re pedagogjike. Ajo fton mësuesit të shfrytëzojnë mundësinë e jashtëzakonshme të teknologjisë jo vetëm për të matur, por edhe për të personalizuar, përmirësuar dhe thelluar procesin e të nxënit. Është një ndërthurje e artit të pedagogjisë me fuqinë e teknologjisë, duke krijuar një harmonizim që ndikon në zhvillimin dhe suksesin e çdo nxënësi.

Përfytyroni një mjedis mësimor ku mësuesi ka qasje të vazhdueshme dhe të menjëhershëm në treguesit e të kuptuarit të çdo nxënësi. Një qasje e tillë mishëron kapacitetin transformues të vlerësimit formues digjital në procesin e të nxënit. Përmes platformave ndërvepruese dhe aplikacioneve, mësuesit mund të ndërtojnë kuize të shpejta, sondazhe apo pyetësorë me përgjigje të hapura, duke shndërruar çdo veprimtari mësimore në një burim të vlefshëm informacioni. Të dhënat mbledhen dhe analizohen menjëherë, duke i lejuar mësuesit të identifikojnë mangësitë në njohuri apo konceptet e vështira dhe të reagojnë në kohë reale. Kjo aftësi për të përshtatur menjëherë mësimdhënien, për të ofruar mbështetje të diferencuar për ata që hasin vështirësi dhe për të sfiduar nxënësit më të përparuar, është thelbi i një procesi mësimor efektiv dhe gjithëpërfshirës. Është si të kesh një hartë të vazhdueshme të “terrenit të të nxënit”, duke të lejuar të drejtosh “anijen mësimore” drejt suksesit.

Përtej monitorimit të vazhdueshëm, teknologjia transformon edhe vlerësimin përmbledhës, atë që mat të nxënit në fund të një kapitulli, një periudhe apo një viti shkollor. Platformat online ofrojnë mundësinë për të krijuar teste dhe provime digjitale që vlerësojnë thellësinë e të kuptuarit, aftësitë komplekse dhe njohuritë e grumbulluara. Përfitimi është i dyfishtë: korrigjimi automatik i pyetjeve me zgjedhje të shumëfishta dhe llojeve të tjera objektive çliron kohën e çmuar të mësuesve, duke u lejuar atyre të përqendrohen te detyrat që kërkojnë vlerësim më cilësor, ndërsa objektiviteti i rritur siguron një matje të drejtë dhe të paanshme.



Për më tepër, këto platforma ofrojnë analiza të detajuara, duke ndihmuar në identifikimin e prirjeve dhe modeleve afatgjata në të nxënit e nxënësve, duke shërbyer si një udhërrëfyes i vlefshëm për planifikimet e ardhshme pedagogjike.

Në vend të një note të vetme, portofoli digjital ofron një pamje të pasur dhe të gjithanshme të rrugëtimit të të nxënit të çdo nxënësi. Përfytyroni dosjen virtuale ku nxënësit dhe mësuesit grumbullojnë dëshmi të ndryshme: ese, projekte multimediale, video prezantime, skica, madje edhe reflektimet personale mbi procesin e të nxënit të tyre. Platformat kushtuar portofolit bëjnë të mundur këtë mbledhje dhe organizim të lehtë. Ky mjet i fuqishëm shkon përtej vlerësimit tradicional duke theksuar vlerësimin më të vërtetë që mat aftësi reale në rrethana reale. Ai nxit nxënësit të bëhen zotërues të të nxënit të tyre, duke i shtyrë ata të reflektojnë mbi përparimin e tyre, të identifikojnë pikat e forta dhe fushat për përmirësim, duke kultivuar vetëdijen dhe vetë-rregullimin. Për mësuesit, portofoli digjital bëhet një dritare transparente drejt mendjes së nxënësit, duke treguar jo vetëm “çfarë” ka mësuar, por edhe “si” është zhvilluar.

Një element i rëndësishëm i vlerësimit efektiv është feedback-u, si reagim cilësor dhe i orientuar drejt përmirësimit. Teknologjia e ka revolucionarizuar mënyrën se si mësuesit mund ta ofrojnë këtë feedback. Ata kanë mundësinë të ofrojnë komente të personalizuar dhe në kohë për detyra ose vlerësime, duke ulur ndjeshëm kohën e pritjes dhe duke rritur efikasitetin e ndërveprimit pedagogjik. Për detyrat më të vështira, mjetet digjitale lejojnë ofrimin e feedback-ut të detajuar në formate të ndryshme: komente të shkruara, mesazhe zanore, madje edhe video. Ky feedback i menjëhershëm dhe i pasur nuk shërben vetëm për korrigjim; ai është një mjet i fuqishëm për të rritur motivimin dhe angazhimin e nxënësve.

Të dhënat e mbledhura nëpërmjet vlerësimeve digjitale janë shumë më tepër se shifra; ato janë një burim i paçmuar informacioni që zbulon histori dhe prirje. Mësuesit, duke analizuar këto të dhëna, mund të identifikojnë modele në të nxënit e nxënësve: cilat koncepte janë më sfiduese, ku përqendrohen vështirësitë, apo cilat metoda mësimore janë më efektive. Kjo qasje i fuqizon mësuesit të marrin vendime të informuara, të përshtatin programet mësimore, të personalizojnë burimet dhe të përmirësojnë vazhdimisht praktikën e tyre pedagogjike.

Vlerësimi i të nxënit i pajisur me teknologji nuk është vetëm një proces matjeje, por një mjet i fuqishëm për rritje dhe përmirësim të vazhdueshëm.

Duke shfrytëzuar kapacitetin e teknologjisë në mënyrë afatgjatë, mësuesit mund të krijojnë një mjedis mësimor më të drejtë, më efikas dhe thellësisht mbështetës, duke u siguruar që çdo nxënës të ketë mundësinë të shkëlqejë dhe të arrijë arritjet më të larta.

Treguesit dhe përshkruesit për fushën: Vlerësimi

Treguesit	Përshkruesit
4.1.Mësuesi zhvillon dhe zbaton vlerësimin formues digjital, duke e përshtatur nga ana pedagogjike dhe duke përdorur të dhënat për të përmirësuar në mënyrë dinamike mësimdhënien.	4.1.1. Mësuesi përdor platforma online dhe aplikacione (si Google Forms, Kahoot, Mentimeter, Socrative) për të krijuar dhe menaxhuar veprimtari të vlerësimit të vazhduar ndërvepruese.
	4.1.2. Mësuesi harton detyra vlerësimi formues që monitorojnë ecurinë e nxënësve, duke përfshirë lloje të ndryshme pyetjesh (p.sh., të hapura, me alternativa, zgjidhje problemesh).
	4.1.3. Mësuesi siguron që aktivitetet e vlerësimit të jenë të përshtatura me nivelin dhe nevojat individuale të nxënësve, duke marrë parasysh ndryshueshmërinë e klasës.
	4.1.4. Mësuesi ndërthur metodat tradicionale të vlerësimit (p.sh., vëzhgimi, diskutimi në klasë) me ato digjitale për të mbledhur informacion të gjithanshëm mbi të nxënit.
	4.1.5. Mësuesi përdor të dhënat nga vlerësimet formuese për të identifikuar vështirësitë e nxënësve dhe i adreson ato në kohë reale.
	4.1.6. Mësuesi përshtat teknikat e vlerësimit për të nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe për të rritur motivimin e tyre.

4.2. Mësuesi ofron feedback të menjëhershëm, të personalizuar dhe cilësor duke shfrytëzuar mjetet digjitale.	4.2.1. Mësuesi përdor aplikacione dhe platforma për të dhënë feedback të shpejtë dhe specifik mbi performancën e nxënësve.
	4.2.2. Mësuesi ofron feedback në formate të ndryshme (p.sh., komente të shkruara, mesazhe zanore, video) për të siguruar qartësi dhe përshtatje me stilin e të nxënësit të nxënësve.
	4.2.3. Mësuesi përdor mjete automatike të korrigjimit për të dhënë përgjigje të menjëhershme dhe për të liruar kohë për feedback cilësor.
	4.2.4. Mësuesi ofron mundësi për vlerësim nga bashkëmoshatarët dhe vetëvlerësim përmes platformave digjitale, duke nxitur reflektimin e nxënësve.
	4.2.5. Mësuesi siguron që feedback-u digjital të jetë i dobishëm, i kuptueshëm dhe i orientuar drejt përmirësimit të aftësive dhe njohurive.
	4.2.6. Mësuesi monitoron mënyrën si nxënësit përdorin feedback-un dhe përshtat strategjitë bazuar në efektivitetin e tij.
4.3. Mësuesi analizon thellësisht të dhënat e vlerësimit digjital dhe i përdor ato në mënyrë të planifikuar për të përshtatur dhe	4.3.1. Mësuesi përdor teknologjinë për të mbledhur, ruajtur, organizuar dhe analizuar të dhënat e vlerësimit në mënyrë efektive.
	4.3.2. Mësuesi analizon prirjet dhe modelet në performancën e nxënësve për të identifikuar konceptet dhe aftësitë ku ata kanë nevojë për mbështetje shtesë.

diferencuar mësimdhënien.	4.3.3. Mësuesi përdor të dhënat për të diferencuar mësimin dhe për të personalizuar strategjitë mësimore sipas nevojave individuale të nxënësve.
	4.3.4. Mësuesi planifikon dhe zbaton ndërhyrje specifike për nxënësit me performancë të ulët ose nevoja të veçanta, duke përdorur të dhënat me efikasitet.
	4.3.5. Mësuesi përdor vizualizime të të dhënave (grafikë, tabela, raporte nga sistemet digjitale) për të reflektuar mbi sukseset, sfidat dhe për të komunikuar ecurinë.
	4.3.6. Mësuesi ndërvepron me nxënësit dhe prindërit duke përdorur platforma të përshtatshme digjitale për të ndarë rezultatet dhe për të diskutuar strategjitë për përmirësim.
4.4. Mësuesi përdor portofolin digjital si një mjet gjithëpërfshirës për vlerësimin e vërtetë, reflektimin dhe komunikimin e ecurisë së nxënësve.	4.4.1. Mësuesi përdor platforma të dedikuara (p.sh., Seesaw, Google Sites, OneNote) për të krijuar dhe menaxhuar portofolet digjitale të nxënësve.
	4.4.2. Mësuesi nxit dhe udhëzon nxënësit të ruajnë dhe organizojnë në portofol materiale të ndryshme që pasqyrojnë zhvillimin dhe thellësinë e të nxënit (p.sh., ese, projekte, video, prezantime, refleksione).
	4.4.3. Mësuesi vlerëson performancën e nxënësve bazuar në përmbajtjen e portofolit digjital, duke marrë parasysh zhvillimin e tyre kohor dhe cilësinë e punës.
	4.4.4. Mësuesi përdor portofolin digjital për të nxitur reflektimin e nxënësve mbi arritjet dhe sfidat e tyre akademike.
	4.4.5. Mësuesi shfrytëzon mundësinë e portofoleve digjitale për të mbështetur një qasje të vlerësimit alternativ, duke

	lejuar nxënësit të tregojnë aftësitë dhe përparimin në mënyra krijuese dhe të ndryshme.
	4.4.6. Mësuesi përdor portofolet digjitale si një mjet transparent dhe bashkëpunues për të ndarë ecurinë e nxënësve me prindërit dhe palët e tjera të interesuara.



Fusha 5: Fuqizimi i nxënësve

Në shekullin 21, fuqizimi i nxënësve është një nga përparësitë kryesore të arsimit. Teknologjia, me fuqinë e saj shndërruese, ofron mjete dhe mundësi të reja për të nxitur përfshirjen e të gjithë nxënësve, për të mbështetur të nxënit e personalizuar dhe për të zhvilluar aftësitë e tyre digjitale. Fusha e “Fuqizimit të Nxënësve” në kuadër të kompetencave digjitale të mësuesve, përqendrohet në aftësinë e tyre për të përdorur teknologjinë për të krijuar mjedise mësimore që janë të mundshme, gjithëpërfshirëse dhe që mbështesin zhvillimin e çdo nxënësi, pavarësisht nga aftësitë apo prejardhja e tij.

Krijimi i një mjedisi mësimor të drejtë dhe të barabartë është tepër i rëndësishëm për përfshirjen e plotë të nxënësve. Teknologjia luan një rol kyç këtu. Mësuesit mund të përdorin mjete digjitale për të ofruar mbështetje shtesë për nxënësit me nevoja të veçanta, për të përkthyer materiale mësimore në gjuhë të ndryshme, për të ofruar titra në video dhe për të krijuar veprimtari që janë të mundshme për nxënësit me aftësi të ndryshme. Për shembull, nxënësit me disleksi mund të përdorin programe që shndërrojnë tekstin në audio, ndërsa nxënësit me probleme shikimi mund të përdorin lexues ekranit për të dëgjuar tekstin. Përdorimi i teknologjisë i ndihmon mësuesit të krijojnë një mjedis mësimor që i përgjigjet nevojave të ndryshme të nxënësve dhe që përkrah barazinë dhe gjithëpërfshirjen, veçanërisht në kontekstin e një shoqërie gjithnjë e më të larmishme.

Personalizimi i të nxënit është një tjetër mundësi që ofron teknologjia, duke iu përshtatur nevojave individuale të çdo nxënësi. Kjo përfshin edhe Inteligjencën Artificiale (IA), e cila mund të ofrojë feedback të menjëhershëm, të përshtasë materialet mësimore në kohë reale bazuar në ecurinë e nxënësit, dhe të krijojë shtigje mësimore të veçanta. Mësuesit mund të përdorin platforma online dhe aplikacione mobile me IA për të ofruar burime dhe veprimtari të ndryshme që korrespondojnë me nivelin e aftësive, interesat dhe stilin e të nxënit të çdo nxënësi. Kjo u lejon atyre të ofrojnë mbështetje shtesë për nxënësit që kanë vështirësi, si dhe sfida për nxënësit më arritje më të larta.

Për mësuesit, të nxënit e personalizuar, i mbështetur nga teknologjia dhe IA, është një mënyrë për të kapërcyer sfidat e mësimin të diferencuar, duke nxitur zhvillimin e plotë të potencialit të çdo nxënësi.



Zhvillimi i aftësive digjitale është i domosdoshëm për fuqizimin e nxënësve në epokën moderne. Mësuesit duhet t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të jetuar, punuar dhe përparuar në botën digjitale. Kjo përfshin aftësinë për të përdorur mjetet digjitale në mënyrë efektive, për të gjetur, vlerësuar dhe menaxhuar informacionin online, për të komunikuar dhe bashkëpunuar në mjedise digjitale, si dhe për të qenë qytetarë digjitalë të përgjegjshëm. Po ashtu, është e rëndësishme që nxënësit të zhvillojnë një kuptim bazë të funksionimit të Inteligjencës Artificiale dhe aftësinë për të ndërvepruar në mënyrë efektive dhe etike me sistemet e IA-së. Përgatitja e nxënësve për një treg pune që kërkon aftësi digjitale dhe për një shoqëri gjithnjë e më të digjitalizuar, kërkon një qasje të integruar që përfshin mësimin e aftësive digjitale në të gjitha lëndët dhe nivelet e arsimit.

Në thelb, fuqizimi i nxënësve është një qëllim kryesor i arsimit në shekullin 21. Teknologjia, përfshirë Inteligjencën Artificiale, ofron mjete dhe mundësi të reja për të nxitur përfshirjen, për të personalizuar të nxënit, për të zhvilluar aftësitë digjitale dhe për të krijuar mjedise mësimore gjithëpërfshirëse. Duke shfrytëzuar teknologjinë në mënyrë strategjike, mësuesit jo vetëm që do të fuqizojnë nxënësit e tyre, por edhe do t'i përgatisin ata në mënyrë sa më të mirë për sfidat dhe mundësitë e së ardhmes.

Treguesit dhe përshkruesit për fushën: Fuqizimi i nxënësve

Treguesit	Përshkruesit
5.1. Mësuesi përdor teknologjinë për të fuqizuar aftësitë e nxënësve për të komunikuar dhe bashkëpunuar.	5.1.1. Mësuesi përdor platforma digjitale që mundësojnë komunikimin në kohë reale dhe punën në grup, siç janë forume dhe biseda online.
	5.1.2. Mësuesi nxit nxënësit të përdorin mjetet digjitale për të ndarë ide, krijuar projekte të përbashkëta dhe për të bashkëpunuar në mënyrë efektive.
	5.1.3. Mësuesi siguron mundësi për nxënësit të komunikojnë me mësuesit dhe njëri-tjetrin përmes mjeteve digjitale në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar.

	5.1.4. Mësuesi organizon veprimtari bashkëpunimi që nxisin përdorimin e teknologjisë për të zhvilluar ide të reja dhe për të zgjidhur probleme në grup.
5.2. Mësuesi nxit nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre digjitale për të krijuar, menaxhuar dhe shpërndarë përmbajtje digjitale.	5.2.1. Mësuesi integron mjete dhe aplikacione për krijimin e materialeve digjitale (video, blogje, prezantime multimediale, infografika, etj.) në funksion të rezultateve të të nxënit.
	5.2.2. Mësuesi siguron mundësi për nxënësit të krijojnë dhe të shpërndajnë përmbajtje digjitale që lidhen me lëndën e përkatëse, duke përdorur platforma të ndryshme (LMS, blogje, galeri online etj.).
	5.2.3. Mësuesi ndihmon nxënësit të organizojnë dhe menaxhojnë efektivisht përmbajtjen digjitale që ata krijojnë, duke përdorur mjete dhe strategji për ruajtjen, renditjen dhe përdorimin e informacionit.
	5.2.4. Mësuesi planifikon aktivitete që lejojnë nxënësit të ndajnë punën e tyre me audienca të ndryshme (bashkëmoshatarë, prindër, komuniteti), duke nxitur ndërveprimin dhe marrjen e feedback-ut.
	5.2.5. Mësuesi vlerëson cilësinë dhe krijimtarinë në përmbajtjen digjitale të nxënësve si një mënyrë për të treguar kuptimin e lëndës dhe zotërimin e aftësive digjitale.
	5.2.6. Mësuesi udhëzon nxënësit si të përdorin mjete të Inteligjencës Artificiale (IA) (p.sh., gjeneratorë teksti, pamjesh apo paraqitjesh) për të ndihmuar në procesin e krijimit të përmbajtjes digjitale, duke theksuar

	përgjegjësinë për verifikimin dhe përshtatjen e rezultatit të IA-së.
5.3. Mësuesi nxit nxënësit për të krijuar përmbajtje digjitale origjinale, të sigurt dhe etike.	5.3.1. Mësuesi udhëzon nxënësit për rëndësinë e origjinalitetit, shmangien e plagjiaturës dhe respektimin e etikës digjitale dhe të drejtave të autorit gjatë krijimit dhe ndarjes së përmbajtjes.
	5.3.2. Mësuesi nxit nxënësit të jenë të kujdesshëm në shpërndarjen e informacionit vetjak në internet dhe të përdorin mjete të sigurta për komunikim.
	5.3.3. Mësuesi zhvillon veprimtari që nxisin ndërgjegjësimin për sigurinë online, siç janë trajnimet mbi ndihmën për të identifikuar rreziqe dhe për të shmangur bullizmin kibernetik.
	5.3.4. Mësuesi përfshin nxënësit në diskutime mbi rregullat dhe përgjegjësitë e përdorimit të teknologjisë dhe internetit në mënyrë të etike.
5.4. Mësuesi përdor teknologjinë për të krijuar mjedise mësimore gjithëpërfshirëse dhe të arritshme.	5.4.1. Mësuesi përdor mjete për të përkthyer dhe përshtatur materialet mësimore për nxënësit me nevoja të veçanta.
	5.4.2. Mësuesi përdor teknologji të përshtatshme që mundësojnë qasje për nxënësit me vështirësi në shikim, dëgjim ose aftësi motorike.
	5.4.3. Mësuesi krijon mundësi për nxënësit që kanë aftësi të veçanta të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësim, duke ofruar mundësi për mësim të personalizuar.
	5.4.4. Mësuesi përdor teknologji që mundësojnë përkthimin e materialeve mësimore në gjuhë të tjera për nxënësit që nuk flasin shqipen si gjuhë të parë.

5.5.Mësuesi nxit zhvillimin e aftësive të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve tek nxënësit përmes përdorimit të mjeteve digjitale.	5.5.1. Mësuesi udhëzon nxënësit të përdorin mjete digjitale për të kërkuar, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike informacionin nga burime të shumta online, përfshirë ato të gjeneruara nga IA, duke identifikuar besueshmërinë dhe paragjykimet.
	5.5.2. Mësuesi nxit nxënësit të përdorin simulime digjitale, programe modelimi ose mjete vizualizimi për të eksploruar skenarë, testuar hipoteza dhe zhvilluar zgjidhje të reja për problemet.
	5.5.3. Mësuesi zhvillon veprimtari që kërkojnë nga nxënësit të argumentojnë, vlerësojnë dhe reflektojnë në mënyrë kritike mbi informacionin dhe zgjidhjet e gjetura përmes burimeve digjitale.
	5.5.4. Mësuesi udhëzon nxënësit të përdorin mjete digjitale për të mbledhur dhe analizuar të dhëna, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të informuara dhe të bazuar në fakte.
	5.5.5. Mësuesi nxit nxënësit të reflektojnë mbi procesin e tyre të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve gjatë punës me mjete digjitale, duke identifikuar strategjitë e suksesshme dhe fushat për përmirësim.
	5.5.6. Mësuesi angazhon nxënësit në veprimtari ku ata vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin dhe zgjidhjet e gjeneruara nga sistemet e Inteligjencës Artificiale (IA), duke dalluar saktësinë, paragjykimet dhe kufizimet e tyre.

	5.5.7. Mësuesi nxit nxënësit të përdorin IA-në si një mjet për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, duke formuluar pyetje efektive, duke kërkuar ide dhe duke përmbledhur informacione të ndërlikuara për të arritur në zgjidhje të reja.
--	---



Fusha 6: Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve

Në një botë që po digjitalizohet me ritme të shpejta, kompetencat digjitale janë bërë po aq të rëndësishme sa shkrimi, leximi dhe aritmetika. Mësuesit duhet të jenë të aftë për të ndihmuar nxënësit të zhvillojnë këto kompetenca, duke i pajisur me aftësitë e nevojshme për të lundruar, krijuar dhe bashkëvepruar në botën digjitale në mënyrë të sigurt, efektive dhe etike.

Nxënësit duhet të jenë në gjendje të përdorin motorë kërkimi, baza të të dhënave dhe burime të tjera online për të gjetur informacionin që u nevojitet. Vetëm thjesht gjetja e informacionit nuk mjafton. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje të vlerësojnë në mënyrë kritike cilësinë, besueshmërinë dhe vlefshmërinë e informacionit që gjejnë. Kjo përfshin aftësinë për të dalluar midis fakteve dhe opinioneve, për të identifikuar burimet e besueshme dhe për të shmangur informacionin e rremë. Përveç kësaj, nxënësit duhet të jenë në gjendje të organizojnë dhe menaxhojnë informacionin digjital që gjejnë, duke përdorur mjete dhe teknika të ndryshme.

Për mësuesit, zhvillimi i këtyre aftësive të nxënësit është një sfidë dhe një mundësi. Ata mund t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë strategji efektive kërkimi, t'u mësojnë atyre si të vlerësojnë burimet online dhe t'i pajisin ata me mjetet e nevojshme për të menaxhuar informacionin digjital, në kontekstin e një interneti që është i mbushur me informacion të pasaktë dhe të rremë.

Aftësia për të komunikuar dhe bashkëpunuar nëpërmjet mjeteve digjitale është një tjetër kompetencë jetike. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të përdorin email-in, mesazhe të çastit, platforma të rrjeteve sociale dhe mjete të tjera digjitale për të komunikuar me njëri-tjetrin, mësuesit dhe të tjerët. Po ashtu, ata duhet të bashkëpunojnë në mënyrë efektive nëpërmjet mjeteve digjitale, duke ndarë dokumente, duke punuar në projekte të përbashkëta dhe duke shkëmbyer ide dhe informacione.

Mësuesit mund t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë këto aftësi duke u ofruar atyre mundësi për të komunikuar dhe bashkëpunuar nëpërmjet mjeteve digjitale në klasë. Për shembull, ata mund t'i nxitin nxënësit të punojnë në projekte të grupeve online, të përdorin platforma bashkëpunimi për të ndarë materiale mësimore dhe të komunikojnë me mësuesit dhe bashkëmoshatarët nëpërmjet email-it ose mesazheve të çastit.

Krijimi dhe shpërndarja e përmbajtjes digjitale është u lejon nxënësve të shprehin krijimtarinë e tyre dhe të ndajnë idetë dhe informacionin me të tjerët. Nxënësit duhet të jenë në gjendje të



krijojnë materiale digjitale të ndryshme, siç janë dokumente, prezantime, video, audio dhe imazhe. Ata gjithashtu duhet të jenë në gjendje t'i shpërndajnë këto materiale nëpërmjet mjeteve digjitale, duke marrë parasysh të drejtat e autorit dhe çështjet e privatësisë.

Mësuesit mund t'i ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë këto aftësi duke u ofruar atyre mundësi për të krijuar dhe shpërndarë përmbajtje digjitale në klasë. Për shembull, ata mund t'i nxitin nxënësit të krijojnë prezantime digjitale për projektet e tyre, të xhirojnë video edukative për të shpjeguar koncepte të ndryshme ose të krijojnë blogje për të ndarë mendimet dhe idetë e tyre.

Aftësia për të qenë të vetëdijshëm për çështjet e sigurisë dhe privatësisë në internet është jetike për çdo qytetar digjital. Nxënësit duhet të jenë të informuar për risqet e mundshme në internet, siç janë bullizmi kibernetik, mashtrimet online dhe vjedhja e identitetit. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre të privatësisë dhe të dinë se si t'i mbrojnë ato.

Mësuesit kanë një rol të rëndësishëm në edukimin e nxënësve për çështjet e sigurisë dhe privatësisë në internet. Ata mund t'u mësojnë atyre si të krijojnë fjalëkalime të forta, si të mbrojnë informacionin e tyre personal dhe si të raportojnë sjelljet e pahijshme online. Kjo është një pjesë e rëndësishme e përgatitjes së nxënësve për të qenë qytetarë digjitalë të përgjegjshëm. Treguesit dhe përshkruesit për fushën: Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve

Treguesit	Përshkruesit
6.1. Nxënësit kërkojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin digjital.	6.1.1. Nxënësit përdorin strategji efektive kërkimi (fjalë kyçe të sakta, operatorë logjikë, filtra) për të gjetur informacion specifik dhe të përshtatshëm nga burime të shumta digjitale.
	6.1.2. Nxënësit analizojnë besueshmërinë dhe autoritetin e burimeve digjitale (përfshirë datën e publikimit dhe autorësinë) për të vlerësuar cilësinë e informacionit.
	6.1.3. Nxënësit dallojnë mes fakteve, opinioneve dhe informacioneve të rreme, si dhe vlerësojnë paanësinë dhe saktësinë e atyre që kanë gjetur online.

	6.1.4. Nxënësit shfrytëzojnë burimet dhe mjetet e ndryshme (përfshirë IA-në) për të shqyrtuar informacionin nga më shumë se një burim dhe për të siguruar saktësinë e tij.
6.2. Nxënësit krijojnë përmbajtje digjitale origjinale, të përshtatshme, etike dhe të sigurt.	6.2.1. Nxënësit përdorin mjete digjitale për të krijuar materiale të ndryshme (prezantime, video, audio, infografika, blogje) në funksion të rezultateve të të nxënit.
	6.2.2. Nxënësit zbatojnë parimet e origjinalitetit dhe shmangin plagjiaturën, duke respektuar të drejtat e autorit dhe duke cituar burimet siç duhet gjatë krijimit të përmbajtjes.
	6.2.3. Nxënësit përdorin mjete të Inteligjencës Artificiale (IA) për të ndihmuar në procesin e krijimit të përmbajtjes digjitale, duke shqyrtuar dhe duke përshtatur në mënyrë kritike rezultatin (output) e IA-së.
	6.2.4. Nxënësit shpërndajnë përmbajtjen digjitale në platforma të përshtatshme, duke marrë parasysh audiencën e synuar dhe duke siguruar respektimin e çështjeve të privatësisë dhe sigurisë.
6.3. Nxënësit menaxhojnë dhe organizojnë efektivisht informacionin dhe projektet digjitale.	6.3.1. Nxënësit përdorin aplikacione dhe mjete të menaxhimit të informacionit për të organizuar të dhënat, dokumentet dhe skedarët e tyre digjitalë.
	6.3.2. Nxënësit krijojnë dhe menaxhojnë dosje dhe nëndosje në mënyrë të strukturuar për ruajtjen dhe përdorimin e lehtë të informacionit.
	6.3.3. Nxënësit ruajnë informacionin digjital në mënyrë të sigurtë, duke përdorur mjete dhe platforma (p.sh., cloud storage) që mundësojnë kopje rezervë dhe rikthim të lehtë.

	6.3.4. Nxënësit analizojnë, vlerësojnë dhe interpretojnë informacionin digjital në mënyrë objektive dhe të informuar për t'i përdorur në projekte të ardhshme ose vendimmarrje.
6.4. Nxënësit komunikojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë efektive përmes mjeteve digjitale.	6.4.1. Nxënësit përdorin mjete digjitale (e-mail, mesazhe, video-konferenca) për të komunikuar qartë, në kohë reale dhe në mënyrë të respektueshme me bashkëpunëtorët.
	6.4.2. Nxënësit bashkëpunojnë në projekte grupore duke përdorur mjete digjitale (platforma ndarjeje dokumentesh, menaxhim projekti) për ndarjen e ideve, detyrave dhe feedback-ut.
	6.4.3. Nxënësit komunikojnë në mënyrë të përshtatshme dhe profesionale përmes mjeteve të rrjeteve sociale, duke kuptuar ndikimin e gjurmës së tyre digjitale.
	6.4.4. Nxënësit përdorin mjete digjitale për të bashkëpunuar dhe diskutuar në lidhje me projektet, duke ruajtur etikën, respektin për mendimet e të tjerëve dhe duke zgjidhur mosmarrëveshjet.
6.5. Nxënësit mbrojnë sigurinë dhe privatësinë online dhe demonstrojnë sjellje etike digjitale.	6.5.1. Nxënësit krijojnë fjalëkalime të forta dhe i menaxhojnë ato në mënyrë të sigurt, duke kuptuar rëndësinë e tyre.
	6.5.2. Nxënësit përdorin cilësimet e privatësisë në platformat online për të mbrojtur informacionin e tyre personal dhe janë të vetëdijshëm për gjurmën e tyre digjitale.
	6.5.3. Nxënësit identifikojnë rreziqet e mundshme të përdorimit të internetit (p.sh., bullizmi kibernetik, mashtrimet, informacioni i rremë) dhe dinë si të mbrohen/raportojnë.
	6.5.4. Nxënësit shfaqin sjellje të përgjegjshme, etike dhe të sigurt në mjediset digjitale, duke respektuar të drejtat e të tjerëve dhe normat sociale online.

SHKALLËT E VLERËSIMIT

Vlerësimi i kompetencave digjitale të mësuesve është një proces i ndërlikuar që kërkon përdorimin e një kuadri të qartë vlerësimi për të kuptuar dhe interpretuar përparimin dhe zhvillimin e aftësive digjitale të mësuesve. Duke u bazuar kryesisht në kornizën DigCompEdu dhe duke e përshtatur atë me nevojat dhe specifikat e realitetit arsimor shqiptar, janë përcaktuar nivelet e mëposhtme të vlerësimit.

Shkalla e vlerësimit është një metodë e përdorur për të vlerësuar gjykimin *me shprehje* ose *me numra*, në lidhje me një aspekt, objekt, karakter ose një cilësi të nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve. Shkalla e vlerësimit dhe normat përkatëse të vlerësimit përbëjnë sistemin që përdoret për vlerësimin e nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve.

Përshkruesit praktikë vlerësohen me shkallën numerike sipas niveleve të vlerësimit nga 1 në 4, ku shkalla 1 është niveli më i ulët i cilësisë dhe shkalla 4 është niveli më i lartë i saj.

Vlerësimi efektiv i nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve kërkon përcaktimin e niveleve të qarta të vlerësimit. Këto nivele shërbejnë si një kuadër referimi për të matur dhe interpretuar progresin e mësuesve në zhvillimin e këtyre kompetencave, dhe duhet të jenë të lidhura ngushtësisht me përshkruesit e kompetencave të përcaktuara më parë. Në këtë dokument, duke u bazuar kryesisht nivelet e përcaktuara në kornizën DigCompEdu dhe duke e përshtatur atë me specifikat e kontekstit arsimor shqiptar, janë përcaktuar nivelet e vlerësimit

Nivelet e vlerësimit

Nivelet e vlerësimit		Nivelet e Taksonomisë së Bloom-it	Përshkrimi
1	Fillestar	Njohës (Remembering)	Mësuesi gjendet në fazat fillestare të zhvillimit të kompetencave digjitale. Ai zotëron njohuri bazë për mjetet dhe teknologjitë digjitale dhe është në gjendje të përdorë vetëm disa mjete të thjeshta si email-i dhe interneti, kryesisht për qëllime personale. Përvoja e tij në përdorimin

			e këtyre mjeteve në rrethanat e mësimdhënies është e kufizuar. Mësuesi është i vetëdijshëm për rëndësinë e kompetencave digjitale në arsim, por përballet me nevojën për mbështetje të konsiderueshme për t'i ndërthurur ato në mënyrë efektive në praktikën e tij/saj të përditshme.
2	Zhvillues	Kuptues dhe zbatues (Understanding & Applying)	Mësuesi ka kaluar fazën fillestare dhe ka filluar të fitojë një kuptim më të mirë të funksionimit të mjeteve digjitale. Ai është në gjendje t'i përdorë këto mjete në mënyrë më efektive dhe mund të shpjegojë përdorimin e tyre, duke bërë lidhje të thjeshta midis tyre. Mësuesi përdor një shumëllojshmëri mjetesh dhe teknologjish digjitale për qëllime personale dhe profesionale, duke treguar një rritje të vetëbesimit dhe aftësive. Megjithatë, në kontekstin e mësimdhënies, ai është ende në fazën e zbulimit dhe mbështetet kryesisht në metodat tradicionale. Ai është i hapur ndaj të mësuarit të gjërave të reja dhe tregon interes për zhvillimin profesional në fushën e teknologjisë. Mësuesi përdor teknologjinë në mënyrë efektive në mësimdhënie, duke integruar mjetet digjitale në planifikimin, zbatimin dhe vlerësimin e mësimin. Ai është në gjendje të krijojë materiale mësimore digjitale dhe t'i përdorë ato për të angazhuar nxënësit dhe për të mbështetur të nxënit e tyre, si dhe është i vetëdijshëm për çështjet e sigurisë dhe privatësisë në internet, si dhe i edukon nxënësit për përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë.

3	Kompetent	Analizues (Analyzing)	Mësuesi ka kaluar fazën e thjesht të kuptuarit dhe përdorimit të mjeteve digjitale dhe tani është në gjendje t'i zbatojë ato në mënyrë efektive në mësimdhënie. Ai jo vetëm që përdor teknologjinë, por edhe analizon efektivitetin e saj, duke e përdorur atë si mjet për të zgjidhur probleme dhe për të krahasuar mundësi të ndryshme. Mësuesi përdor teknologjinë në mënyrë strategjike për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe për të rritur rezultatet e nxënësve. Ai ka aftësinë të analizojë të dhënat e vlerësimit dhe t'i përdorë ato për të përshtatur mësimdhënien me nevojat individuale të nxënësve. Për më tepër, mësuesi është i angazhuar në zhvillimin e tij profesional të vazhdueshëm dhe e sheh ndarjen e përvojave me kolegët si një pjesë integrale të rritjes së tij si mësimdhënës.
4	Ekspert	Vlerësues dhe krijues (Evaluating & Creating)	Mësuesi ka arritur një nivel të lartë të kompetencës digjitale dhe është në gjendje të vlerësojë në mënyrë kritike përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor. Ai nuk është thjesht një përdorues i aftë, por edhe një krijues i qasjeve të reja dhe burim i vlefshëm ekspertize për të tjerët. Ky nivel karakterizohet nga mendimi kritik, krijimtaria e lartë dhe aftësia për të marrë vendime të informuara në lidhje me përdorimin e teknologjisë në kontekstin arsimor. Mësuesi në këtë nivel shpesh shërben si një udhëheqës në përdorimin e teknologjisë, duke kontribuar në zhvillimin e praktikave të reja pedagogjike dhe duke krijuar dhe zbatuar projekte risi që transformojnë mësimin dhe të nxënësve. Ai është i angazhuar në kërkime dhe studime në fushën e

			arsimit digjital dhe ndan me entuziazëm rezultatet e tij/saj me komunitetin arsimor. Për më tepër, mësuesi ekspert shpesh merr rolin e një vizionari në fushën e arsimit digjital, duke ndikuar në politikat dhe strategjitë arsimore në nivel më të gjerë. Ai është i aftë të udhëheqë dhe të mbështesë zhvillimin profesional të mësuesve të tjerë në fushën e kompetencave digjitale, duke luajtur një rol kyç në ndërtimin e një komuniteti arsimor të pajisur me teknologji dhe duke përkrahur përdorimin etik dhe të përgjegjshëm të teknologjisë në arsim.
--	--	--	---

Treguesit e cilësisë vlerësohen sipas shkallëve të cilësisë , në përputhje me normën e vlerësimit të përshkruesve praktikë, përkatësisht:

<i>Fillestar (Dobët):</i>	Kur norma e vlerësimit është 25% - 49% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues.
<i>Zhvillues (Mjaftueshëm):</i>	Kur norma e vlerësimit është 50% - 69% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues.
<i>Kompetent (Mirë):</i>	Kur norma e vlerësimit është 70% - 89% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues.
<i>Ekspert (Shumë mirë):</i>	Kur norma e vlerësimit është 90% - 100% të përshkruesve praktikë të vlerësuar për atë tregues.


Vlerësimi i fushave vlerësohet me mesataren aritmetike të të gjithë treguesve përkatës.

Vlerësimi i përgjithshëm vlerësohet me mesataren aritmetike të të gjitha fushave.

NIVELET E KOMPETENCAVE DIGJITALE TË MËSUESVE

Nivelet e vlerësimit të fushës 1: Angazhimi profesional

Treguesit	Përshkruesit	Nivelet e vlerësimit			
		Fillestar (1)	Zhvillues (2)	Kompetent (3)	Ekspert (4)
1.1. Mësuesi përdor në mënyrë efektive teknologjinë e informacionit për të komunikuar dhe bashkëpunuar me kolegët, nxënësit, prindërit dhe	1.1.1. Mësuesi përdor platforma dhe mjete digjitale (e-mail, rrjete sociale profesionale, platforma bashkëpunimi) për të komunikuar qartë, në kohë dhe me respekt me	Nuk përdor ose përdor në mënyrë rastësore mjete digjitale për komunikim, ose komunikimi është i paqartë, i vonuar, ose joetik.	Përdor ndonjëherë mjete digjitale për komunikim, por me vështirësi në qartësi, kohëzgjatje ose ka mangësi në respektimin e etiketës dhe profesionalizmit online.	Përdor në mënyrë efektive dhe të rregullt mjete digjitale për të komunikuar qartë, në kohë dhe me respekt me të gjithë palët.	Përdor mjete të përparuara në mënyrë të planifikuar, duke shërbyer si model i praktikave më të mira, si dhe mentoron kolegët për një komunikim efektiv.



komunitetin e gjerë, duke ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme dhe duke nxitur një mjedis arsimor bashkëpunues.	kolegët, nxënësit dhe prindërit.				
	1.1.2. Mësuesi përshtat stilin dhe mjetin e komunikimit digjital sipas audiencës, qëllimit dhe mundësive të palëve (p.sh., ofron alternativa për qasje të kufizuar në internet).	Nuk përshtat mjetin e komunikimit me audiencën, ose nuk merr parasysh mundësitë e tyre (p.sh., nuk ofron alternativa për prindërit pa internet).	Përpiqet të përshtatë, por nuk e bën këtë në mënyrë të vazhdueshme ose nuk identifikon të gjitha nevojat e audiencës për qasje.	Përshtat në mënyrë efektive stilin dhe mjetin e komunikimit digjital me audiencën dhe qëllimin, duke ofruar alternativa kur është e nevojshme (p.sh., telefonata, takime fizike).	Shfaq aftësi të larta përshtatjeje të komunikimit, duke krijuar strategji komunikimi gjithëpërfshirëse.
	1.1.3. Mësuesi merr pjesë dhe ndihmon aktivisht në bashkëpunime online me kolegët	Nuk merr pjesë në bashkëpunime online, ose pjesëmarrja e tij është pasive dhe pa ndonjë ndihmesë.	Merr pjesë rastësisht në bashkëpunime online, por ndihmesa e tij është e kufizuar dhe nuk	Merr pjesë dhe ndihmon aktivisht në bashkëpunime online me kolegët (brenda dhe jashtë	Udhëheq dhe frymëzon bashkëpunime online, duke krijuar dhe



	(brenda/jashtë shkollës) për shkëmbimin e ideve, burimeve dhe praktikave të mira, duke përdorur mjete bashkëpunimi.		shkëmben rregullisht ide/burime.	shkollës), duke shkëmbyer ide, burime dhe praktika të mira.	menaxhuar grupe bashkëpunimi, dhe duke nxitur ndarjen e praktikave të reja në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.
	1.1.4. Mësuesi shfaq etikë profesionale dhe sjellje të përgjegjshme në të gjitha ndërveprimet digjitale, duke ndërtuar marrëdhënie pozitive dhe duke ruajtur të dhënat	Nuk shfaq sjellje etike online, shkel rregullat e privatësisë/etikës digjitale ose ndërtimi i marrëdhënieve është negativ.	Shfaq disa elementë të sjelljes etike, por mund të jetë i paqartë mbi konfidencialitetin e të dhënave/respektimin e privatësisë ose ndonjëherë shkakton keqkuptime në ndërveprimet online.	Shfaq në mënyrë të vazhdueshme etikë profesionale dhe sjellje të përgjegjshme në ndërveprimet digjitale, duke ndërtuar marrëdhënie pozitive dhe duke ruajtur	Është një shembull i sjelljes etike digjitale dhe ndërtton një besueshmëri të shkëlqyer online, duke adresuar çështjet etike me kolegët dhe duke ndihmuar në



	vetjake dhe privatësinë.			konfidencialitetin e të dhënave dhe privatësinë.	formulimin e politikave të shkollës për etikën digjitale.
1.2. Mësuesi angazhohet në zhvillimin profesional të vazhdueshëm duke shfrytëzuar teknologjinë.	1.1.1. Mësuesi ndjek rregullisht dhe angazhohet aktivisht në kurse online seminare web dhe veprimtari të tjera digjitale të zhvillimit profesional.	Nuk ndjek veprimtari digjitale të zhvillimit profesional, ose ndjekja është e detyruar dhe pasive.	Ndjek rastësisht veprimtari online, por angazhimi është i kufizuar dhe nuk reflekton një dëshirë të vazhdueshme për zhvillim.	Ndjek rregullisht dhe angazhohet aktivisht në kurse online, seminare web dhe aktivitete të tjera digjitale të zhvillimit profesional.	Kërkon në mënyrë të vetëdijshme dhe angazhohet në kurse online dhe veprimtari të përparuara të zhvillimit profesional, duke identifikuar boshllëqet e veta dhe duke udhëhequr nisma të tilla.
	1.2.1. Mësuesi identifikon,	Nuk identifikon ose nuk përdor burime digjitale	Identifikon disa burime online, por	Identifikon, vlerëson në mënyrë	Është ekspert në gjetjen,



	vlërëson në mënyrë kritike dhe përdor burime arsimore të hapura (OER) dhe literaturë shkencore online për përmirësimin e kompetencave lëndore, pedagogjike dhe digjitale.	(OER, literaturë online) për zhvillimin e tij profesional, ose i përdor pa vlerësim kritik.	vlërësimi i tyre është sipërfaqësor dhe nuk i përdor në mënyrë të rregullt për përmirësimin e kompetencave.	kritike dhe përdor burime arsimore të hapura (OER) dhe literaturë shkencore online për përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave lëndore, pedagogjike dhe digjitale.	vlërësimin dhe përdorimin e burimeve digjitale, duke krijuar arkiv të përzgjedhur të OER-ve ose duke ndihmuar me artikuj në literaturën shkencore online.
	1.2.2. Mësuesi reflekton në mënyrë të vazhdueshme mbi praktikën e tij/saj profesionale duke përdorur mjete digjitale (blogje, platforma	Nuk reflekton mbi praktikën e tij ose nuk përdor mjete digjitale për dokumentim dhe feedback..	Reflekton ndonjëherë, por përdorimi i mjeteve digjitale është i paqëllimtë dhe feedback-u i marrë nuk përdoret për përmirësim.	Reflekton në mënyrë të rregullt mbi praktikën e tij profesionale, duke përdorur mjete digjitale për të dokumentuar përparimin dhe për	Zhvillon një portofol digjital profesional të detajuar, duke shërbyer si shembull i reflektimit dhe zhvillimit të



	reflektimi, portofolin digjital) për të dokumentuar përparimin dhe për të marrë feedback.			të marrë/aplikuar feedback-un.	vazhdueshëm, dhe ndihmon kolegët në proceset e tyre të reflektimit.
	1.2.3. Mësuesi është i vetëdijshëm për licencat e hapura (p.sh., Creative Commons) dhe të drejtat e autorit në kontekstin digjital, duke i respektuar dhe zbatuar ato gjatë përdorimit të	Nuk është i vetëdijshëm për licencat e hapura dhe të drejtat e autorit, ose nuk i zbaton ato.	Është pjesërisht i vetëdijshëm, por ka vështirësi në zbatimin e tyre korrekt ose në kuptimin e ndërlikimeve ligjore dhe etike.	Është i vetëdijshëm për licencat e hapura (p.sh., Creative Commons) dhe të drejtat e autorit në kontekstin digjital, duke i zbatuar ato në mënyrë korrekte në përdorimin dhe ndarjen e burimeve.	Është ekspert në çështjet e licencave të hapura dhe të drejtave të autorit, duke këshilluar kolegët dhe duke përkrahur praktikat më të mira të përdorimit dhe ndarjes së



	materialeve dhe burimeve.				burimeve digjitale.
1.3. Mësuesi ndihmon në risinë pedagogjike dhe shfaq udhëheqjen në arsimin digjital.	1.3.1. Mësuesi është i hapur dhe eksperimenton me metoda të reja të mësimdhënies me teknologji, duke marrë parasysh rreziqe të llogaritura dhe duke mësuar nga rezultatet.	Nuk është i hapur ndaj metodave të reja me teknologji, ose refuzon të eksperimentojë dhe nuk mëson nga sfidat.	Është disi i hapur, por eksperimenton rrallë ose me hezitim, dhe shpesh zhgënjehet nga gabimet.	Është i hapur dhe eksperimenton me metoda të reja të mësimdhënies me teknologji, duke marrë rreziqe të llogaritura dhe duke mësuar në mënyrë të frytshme nga rezultatet.	Është inovator dhe krijon dhe zbaton vazhdimisht metoda të reja pedagogjike të pasuruara me teknologji, duke shërbyer si burim frymëzimi për kolegët.
	1.3.2. Mësuesi ndan në mënyrë të vetëdijshme praktikat e mira dhe burimet e reja me kolegët, duke	Nuk ndan praktikat e mira ose burimet, ose ndarja është e detyruar dhe jo proaktive.	Ndan rastësisht praktika të mira, por nuk është pjesë aktive e zhvillimit të kurrikulave apo	Ndan në mënyrë të vetëdijshme praktikat e mira dhe burimet e reja me kolegët, duke ndihmuar në	Drejton nismat për zhvillimin e kurrikulave dhe materialeve mësimore digjitale, duke



	ndihmuar në zhvillimin e kurrikulave dhe materialeve mësimore të reja.		materialeve të reja me teknologji.	zhvillimin e kurrikulave dhe materialeve mësimore të reja të pasuruara me teknologji.	organizuar trajnime dhe duke ndikuar në nivel shkolle apo më gjerë në ndarjen e dijeve.
	1.3.3. Mësuesi merr pjesë në projekte kombëtare ose ndërkombëtare që mbështetin rinisë në arsimin digjital, duke kërkuar vazhdimisht mundësi për zhvillim.	Nuk merr pjesë në projekte kombëtare/ndërkombëtare ose nuk shfaq interes për të tilla mundësi.	Është në dijeni për projekte, por pjesëmarrja e tij është pasive ose e kufizuar, pa kërkuar me vetëdije mundësi.	Merr pjesë në mënyrë aktive në projekte kombëtare ose ndërkombëtare që përkrahin risinë në arsimin digjital, duke kërkuar vazhdimisht mundësi për zhvillim.	Udhëheq/nis projekte kombëtare ose ndërkombëtare, duke ndihmuar në ecurinë e arsimit digjital dhe duke sjellë praktika globale në shkollë.
	1.3.4. Mësuesi tregon aftësi udhëheqëse duke ndihmuar	Nuk shfaq aftësi drejtuese, nuk ndihmon kolegët ose nuk ka rol në	Ndonjëherë ndihmon kolegët me kërkesë, por nuk	Shfaq aftësi udhëheqëse duke ndihmuar kolegët	Është udhëheqës i njohur në fushën e arsimit



	kolegët të zhvillojnë kompetencat digjitale dhe duke ndikuar në procesin e vendimmarrjes në shkollë në lidhje me integrimin e teknologjisë.	vendimmarrjen për teknologjinë.	është një figurë udhëheqëse dhe ka ndikim të kufizuar në vendimmarrjen e shkollës për teknologjinë.	të zhvillojnë kompetencat digjitale dhe duke ndikuar pozitivisht në procesin e vendimmarrjes në shkollë në lidhje me integrimin e teknologjisë.	digjital dhe propozon dhe zbaton politika për integrimin e teknologjisë në shkollë, duke ndihmuar në strategjitë arsimore në nivel më të gjerë.
--	---	---------------------------------	---	---	---



Nivelet e vlerësimit të fushës 2: Burimeve digjitale

Treguesit	Përshkruesit	Nivelet e vlerësimit			
		Fillestar (1)	Zhvillues (2)	Kompetent (3)	Ekspert (4)
2.1.Mësuesi njeh dhe përdor motorë kërkimi dhe të dhëna arsimore, për të gjetur burime digjitale të përshtatshme, në funksion të mësimdhënies	2.1.1. Mësuesi përdor në mënyrë efektive motorë kërkimi të ndryshëm dhe baza të të dhënave arsimore (ERIC ⁶ , JSTOR ⁷ etj.).	Nuk përdor baza të dhënash arsimore dhe përdor vetëm një motor kërkimi bazë me fjalë kyçe shumë të përgjithshme, duke dështuar të gjejë burime me vlerë.	Përdor disa motorë kërkimi dhe ka filluar të përdorë ndonjë bazë të dhënash, por shpesh me fjalë kyçe të përgjithshme, duke kërkuar ndihmë për strategjitë e përparuara.	Përdor në mënyrë efektive dhe të rregullt (p.sh., çdo javë) motorë kërkimi të ndryshëm dhe baza të të dhënash arsimore, duke shfrytëzuar fjalë kyçe të duhura dhe strategji të përparuara kërkimi për të qartësuar dhe përmirësuar rezultatet.	Është mjeshtër në kërkimin digjital, duke zhvilluar dhe zbatuar strategji kërkimi të reja dhe të përmirësuara (p.sh., bashkime të ndërlikuara të operatorëve, analiza të algoritmeve), dhe duke mbështetur

⁶ ERIC është një bazë të dhënash shkencore dhe qendër kërkimore online, e mbështetur nga Departamenti i Arsimit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (U.S. Department of Education), që ofron qasje të hapur në literaturë dhe burime kërkimore në fushën e arsimit.

⁷ JSTOR është shkurtim për Journal Storage – Arkivë Revistash Akademike JSTOR është një bazë të dhënash digjitale që ruan dhe ofron akses në revista shkencore, libra, dokumente historike dhe burime të tjera akademike nga fusha të ndryshme.



dhe të të nxënit.					kolegët në procesin e kërkimit.
	2.1.2. Mësuesi përdor fjalë kyçe të duhura dhe strategji të përparuara kërkimi.	Përdor fjalë kyçe shumë të përgjithshme dhe nuk njih ose nuk përdor strategji të përparuara kërkimi, duke dështuar të gjejë burime specifike.	Përdor disa fjalë kyçe të duhura dhe ka filluar të eksperimentojë me disa strategji të përparuara kërkimi, por jo gjithmonë në mënyrë efektive apo të qëndrueshme.	Përdor fjalë kyçe të duhura dhe strategji të përparuara kërkimi (p.sh., “filetype:pdf ⁸ ”) për të qartësuar dhe përmirësuar rezultatet e kërkimit.	Zhvillon dhe zbaton strategji të përparuara kërkimi dhe të përshtatura (p.sh., bashkime të ndërlikuara të operatorëve boolean ⁹ , kërkim në API ¹⁰), duke përmirësuar procesin e kërkimit dhe duke ndarë përvojën profesionale me kolegët.
	2.1.3. Mësuesi njih dhe përdor platforma	Nuk njih ose nuk përdor asnjë	Njih dhe përdor disa platforma OER	Njih dhe përdor në mënyrë të	Jo vetëm që përdor OER-të në mënyrë të

⁸ filetype:pdf është një komandë kërkimi që përdoret zakonisht në motorët e kërkimit si Google, për të gjetur dokumente në format PDF.

⁹ Boolean” është një tip të dhënash (data type) që mund të marrë vetëm dy vlera: true (e vërtetë), false (e pavërtetë).

¹⁰ API-ja është një “urë” që lejon aplikacione të ndryshme të shkëmbejnë të dhëna dhe të bashkëveprojnë pa pasur nevojë që përdoruesi të ndërhyjë direkt në kod.



	të ndryshme dhe burime të nxëni arsimore të hapura për të gjetur materiale mësimore, video, imazhe dhe lloje të tjera burimesh.	platformë ose burim të nxëni arsimor të hapur (OER) dhe nuk shfrytëzon përkthyes online për burime në gjuhë të tjera.	(p.sh., Khan Academy, Wikipedia), por me kufizime në llojet e burimeve të gjetura; përdor përkthyes online vetëm kur është shumë e nevojshme dhe me vështirësi.	vazhdueshme një shumëllojshmëri platformash dhe burimesh të nxëni arsimore të hapura për të gjetur materiale të ndryshme dhe shfrytëzon rregullisht dhe në mënyrë efektive përkthyes online për të kuptuar dhe përdorur burime në gjuhë të tjera.	planifikuar, por vlerëson në mënyrë kritike cilësinë dhe besueshmërinë e tyre (duke përfshirë ato në gjuhë të ndryshme), përkrah përdorimin e tyre tek kolegët dhe mund të ndihmojë aktivisht në komunitete OER.
	2.1.4. Mësuesi përdor burime në gjuhë të ndryshme ose shfrytëzon përkthyesit online për të kuptuar dhe	Përdor vetëm burime në gjuhën shqipe dhe nuk shfrytëzon përkthyesit online për të kuptuar burime në gjuhë të tjera.	Përdor kryesisht burime në gjuhën shqipe dhe shfrytëzon përkthyesit online vetëm kur është shumë e nevojshme	Përdor në mënyrë efektive burime në gjuhën shqipe dhe shfrytëzon rregullisht dhe me lehtësi përkthyesit online për të kuptuar dhe	Vlerëson në mënyrë kritike cilësinë dhe besueshmërinë e burimeve në gjuhë të ndryshme dhe përdor përkthyesit online në mënyrë strategjike për



	përdorur burime në gjuhë të tjera.		dhe shpesh me vështirësi.	përdorur burime në gjuhë të tjera.	të përmirësuar procesin e kërkimit dhe përdorimit të burimeve, duke u bërë shembull për kolegët.
2.2.Mësuesi vlerëson, identifikon dhe përdor burime digjitale të sakta, të besueshme dhe të përshtatshme.	2.2.1. Mësuesi vlerëson në mënyrë kritike saktësinë e informacionit nga burimet digjitale, duke shqyrtuar faktet dhe duke krahasuar me të paktën dy burime të tjera të besueshme.	Nuk vlerëson saktësinë, autoritetin, ose aktualitetin e burimeve digjitale. ai/ajo përdor informacion të pavërtetuar ose të vjetruar pa ndonjë kontroll.	Përpiqet të vlerësojë saktësinë dhe autoritetin, por shpesh mund t'i mungojnë detajet (p.sh., datat ose besueshmëria). Shqyrtimi i fakteve me burime të tjera është i kufizuar ose jo vijueshëm.	Vlerëson në mënyrë kritike dhe të rregullt (p.sh., për shumicën e burimeve të reja) saktësinë, autoritetin, dhe aktualitetin e informacionit nga burimet digjitale. ai/ajo shqyrton faktet dhe krahason me të paktën dy burime të tjera të besueshme.	Zhvillon dhe zbaton strategji të përparuara dhe të rregullta për vlerësimin e saktësisë dhe besueshmërisë së informacionit. ai/ajo shërben si burim dhe udhëzues për kolegët në identifikimin e burimeve me cilësi të lartë dhe në luftën kundër informacionit të rremë.
	2.2.2. Mësuesi analizon burimin e	Nuk analizon autorin, datën e	Analizon pjesërisht autorin ose datën,	Analizon në mënyrë efektive autorin, datën	Zbaton kritere të avancuara për



	informacionit (autorin, datën e publikimit, besueshmërinë e platformës/faques së internetit) për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit.	publikimit apo besueshmërinë e platformës, duke pranuar informacionin pa kontrolluar origjinën.	por ka vështirësi në vlerësimin e besueshmërisë së platformës ose burimit, duke lënë hapësira për informacion të pasaktë. angazhimin aktiv.	e publikimit dhe besueshmërinë e platformës/faques, duke siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit të përdorur.	analizën e burimit të informacionit, duke qenë i aftë të identifikojë burime të manipuluar ose me paragjykime, dhe udhëzon kolegët në metodat e verifikimit të besueshmërisë.
	2.2.3. Mësuesi vlerëson vlefshmërinë dhe aktualitetin e informacionit në raport me qëllimet mësimore dhe standardet kurrikulare, duke siguruar që	Nuk e vlerëson informacionin digjital dhe e pranon atë si të vërtetë, pavarësisht burimit apo datës së publikimit, dhe nuk e lidh atë me qëllimet mësimore apo	Fillon të vlerësojë burimet digjitale, por shpesh mbështetet në burime të njohura. Mund të ketë vështirësi në identifikimin e informacionit të vjetruar ose jo të	Vlerëson rregullisht vlefshmërinë, saktësinë dhe aktualitetin e informacionit digjital nga burime të ndryshme, duke e lidhur atë drejtpërdrejt me qëllimet specifike mësimore dhe	Jo vetëm që vlerëson në mënyrë kritike dhe të thelluar vlefshmërinë, saktësinë, objektivitetin dhe aktualitetin e informacionit digjital, por edhe u mëson nxënësve strategji për



	burimi është i rëndësishëm dhe i përditësuar.	standardet kurrikulare.	rëndësishëm për qëllimet mësimore dhe kurrikulare.	standardet kurrikulare. Mund të dallojë informacionin e besueshëm nga ai i pabesueshëm.	vlerësimin e burimeve, si dhe ndan praktikatat më të mira me kolegët.
	2.2.4. Mësuesi përzgjedh burime digjitale që janë të përshtatshme për nivelin e moshës, aftësitë, interesat dhe sfidat e të nxënësve, duke marrë parasysh larminë e tyre.	Nuk merr parasysh nivelin e moshës, aftësitë, interesat, apo larminë e nxënësve kur zgjedh burimet digjitale, duke ofruar materiale të papërshtatshme.	Përpiqet të marrë parasysh nivelin dhe interesat e nxënësve, por zgjedhja e burimeve nuk është gjithmonë e diferencuar ose nuk adreson në mënyrë efektive diversitetin e tyre.	Përzgjedh në mënyrë efektive burime digjitale që janë qartësisht të përshtatshme për nivelin e moshës, aftësitë, interesat dhe sfidat e të nxënësve, duke marrë parasysh larminë e tyre (p.sh., përdor materiale me nivele të ndryshme vështirësie).	Zbaton strategji të personalizuar për zgjedhjen e burimeve, duke përdorur të dhëna për të përmbushur nevojat individuale të çdo nxënësi dhe duke mentoruar kolegët në praktikatat e diferencimit me burime digjitale.
	2.2.5. Mësuesi ndërthur burime digjitale	Nuk integron burime digjitale që nxisin	Përpiqet të integrojë burime	Integron rregullisht burime digjitale që	Krijon dhe udhëheq në integrimin e



	që nxisin ndërveprimin, angazhimin dhe të nxënin aktiv të nxënësve, të cilat janë lehtësisht të përdorshme dhe nga ana teknologjike të përshtatshme me pajisjet në dispozicion.	ndërveprimin ose angazhimin aktiv, ose zgjedh burime që janë të vështira për t'u përdorur dhe jo të përshtatshme me pajisjet në dispozicion.	ndërvepruese, por ato mund të mos jenë gjithmonë lehtësisht të përdorshme ose plotësisht të përshtatshme me pajisjet, duke kufizuar angazhimin.	nxisin ndërveprimin, angazhimin dhe të nxënit aktiv të nxënësve, të cilat janë lehtësisht të përdorshme dhe teknologjikisht të përshtatshme me shumicën e pajisjeve në dispozicion.	burimeve digjitale transformuese, duke maksimizuar ndërveprimin dhe angazhimin, duke përmirësuar përdorimin e pajisjeve, si dhe duke mbështetur kolegët në kapërcimin e sfidave teknike.
2.3.Mësuesi shfaq aftësinë për të vlerësuar aspektet teknike dhe pedagogjike të burimeve digjitale.	2.3.1. Mësuesi vlerëson burimet digjitale duke marrë parasysh lehtësinë e përdorimit të tyre, integrimin efektiv në	Nuk vlerëson burimet digjitale bazuar në lehtësinë e përdorimit ose integrimin në mësim; zgjedh burime që shpesh shkaktojnë vështirësi teknike.	Vlerëson burimet digjitale, por me fokus të kufizuar në lehtësinë e përdorimit ose mund të ketë vështirësi në integrimin e tyre pa	Vlerëson në mënyrë efektive burimet digjitale duke marrë parasysh si lehtësinë e përdorimit ashtu edhe integrimin e tyre pa vështirësi në procesin mësimor.	Zhvillon dhe zbaton kritere të detajuara për vlerësimin e burimeve digjitale, duke përmirësuar përzgjedhjen e burimeve për të



	procesin mësimor.		probleme në procesin mësimor.		maksimizuar lehtësinë e përdorimit.
	2.3.2. Mësuesi vlerëson ndikimin e burimeve digjitale në ndërveprimin, angazhimin dhe të nxënësve.	Nuk vlerëson ndikimin e burimeve digjitale në ndërveprimin, angazhimin, ose të nxënësve, ose i përdor ato pa një qëllim pedagogjik të qartë.	Vlerëson ndikimin e burimeve digjitale në një ose dy nga aspektet (ndërveprimi, angazhimi, të nxënësve), por vlerësimi nuk është i rregullt ose i thellë.	Vlerëson në mënyrë të rregullt dhe efektive ndikimin e burimeve digjitale në ndërveprimin, angazhimin dhe të nxënësve, duke përdorur vëzhgime dhe feedback.	Analizon dhe përmirëson përdorimin e burimeve digjitale për të rritur ndërveprimin, angazhimin dhe të nxënësve, si dhe krijon dhe ndan praktika të reja me kolegët, duke matur ndikimin e tyre.
	2.3.3. Mësuesi shqyrton cilësinë teknike të burimeve, duke analizuar faktorin pamor si qartësia e	Nuk shqyrton cilësinë teknike të burimeve; përdor materiale me cilësi të ulët vizuale, audio ose video, të cilat	Shqyrton disa aspekte të cilësisë teknike, por mund të mos i kushtojë vëmendje të gjitha detajeve (p.sh.,	Shqyrton në mënyrë efektive cilësinë teknike të burimeve, duke analizuar faktorët pamorë (qartësinë), cilësinë e audios dhe	Zhvillon dhe zbaton kritere të qarta dhe të detajuara për vlerësimin e cilësisë teknike të burimeve, dhe i ndan ato me



	imazheve, cilësia e audios dhe videos.	mund të pengojnë procesin mësimor.	qartësia e pamjeve ose cilësisë së audios), duke lejuar përdorimin e materialeve të papërshtatshme.	videos për të siguruar material të qartë dhe profesional.	kolegët, duke ndihmuar në rritjen e standardeve të materialeve digjitale.
	2.3.4. Mësuesi shqyrton përshtatshmërinë e burimeve digjitale me pajisjet që ka në dispozicion shkolla apo nxënësit.	Nuk shqyrton përshtatshmërinë e burimeve digjitale me pajisjet e shkollës ose të nxënësve, duke zgjedhur shpesh burime që nuk funksionojnë në mjedisin e disponueshëm.	Shqyrton përshtatshmërinë e burimeve digjitale me pajisjet, por mund të mos marrë parasysh të gjitha kufizimet teknike ose modelet e ndryshme të pajisjeve, duke shkaktuar probleme herë pas here.	Shqyrton në mënyrë efektive përshtatshmërinë e burimeve digjitale me pajisjet që ka në dispozicion shkolla apo nxënësit, duke siguruar që burimet janë lehtësisht të aksesueshme për të gjithë.	Zhvillon dhe zbaton strategji për përzgjedhjen e burimeve digjitale që janë të mundshme dhe të përshtatshme për të gjithë nxënësit, duke marrë parasysh diversitetin e pajisjeve dhe qasjen në teknologji, si dhe ndihmon për përmirësime në



					infrastrukturën shkollore.
2.4.Mësuesi shfaq aftësinë për të krijuar materiale mësimore digjitale, si dhe aftësinë për t'i shpërndarë ato me kolegët dhe nxënësit.	2.4.1. Mësuesi krijon materiale mësimore digjitale (p.sh., prezantime interaktive, video, kuice) të përshtatshme për nevojat e nxënësve dhe objektivat e kurrikulës, duke siguruar cilësinë e përmbajtjes dhe përshtatshmërinë pedagogjike.	Nuk krijon ose krijon shumë rrallë materiale digjitale. Edhe kur krijon, ato janë përgjithësisht me cilësi të ulët, jo të përshtatshme ose pa synim pedagogjik të qartë.	Krijon disa materiale digjitale bazike, por cilësia ose përshtatshmëria pedagogjike mund të mos jenë gjithmonë të përshtatshme ose përdorimi i mjeteve është i kufizuar.	Krijon rregullisht materiale mësimore digjitale të cilësisë së lartë dhe të përshtatshme për nevojat e nxënësve dhe objektivat kurrikulare, duke përdorur një shumëllojshmëri mjetesh dhe platformash.	Krijon materiale mësimore digjitale me qasje të re, duke zhvilluar burime transformuese dhe interaktive që pasurojnë ndjeshëm përvojën e nxënësve, dhe ndan ekspertizën dhe materialet me kolegët.
	2.4.2. Mësuesi krijon dhe shpërndan	Nuk krijon ose nuk shpërndan OER, dhe	Krijon dhe shpërndan	Krijon dhe shpërndan rregullisht OER duke	Është promotor dhe udhëheqës në lëvizjen



	burime të hapura edukative (OER), duke përdorur licenca të hapura dhe ndihmon aktivisht në komunitetin arsimor duke i bërë ato të mundshme për përdorim nga të tjerët.	nuk është i vetëdijshëm për rëndësinë e licencave të hapura ose ndihmesën në komunitet.	ndonjëherë OER, por mund të mos përdorë gjithmonë licenca të hapura, ose ndihmesa në komunitete është minimal dhe jo e vazhdueshme.	përdorur licenca të hapura dhe ndihmon në mënyrë aktive në komunitetin arsimor duke ndarë burime cilësore dhe të mundshme për përdorim.	OER, duke udhëzuar kolegët në krijimin dhe shpërndarjen e tyre me licenca të hapura, dhe duke përkrahur rëndësinë e tyre në përmirësimin e cilësisë së arsimit.
	2.4.3. Mësuesi shpërndan burime digjitale përmes platformave të ndryshme (p.sh., faqet e internetit të shkollave,	Nuk shpërndan burime digjitale, ose e bën në mënyrë shumë të kufizuar, pa marrë parasysh audiencën apo qëllimin, duke	Shpërndan burime digjitale përmes disa platformave bazë, por mund të mos shfrytëzojë të gjitha mundësitë ose nuk e zgjedh gjithmonë	Shpërndan në mënyrë efektive burime digjitale përmes një shumëllojshmërie platformash, duke zgjedhur në mënyrë të ndërgjegjshme mjetin dhe platformën më të	Harton dhe zbaton strategji të integruara dhe të reja për shpërndarjen e burimeve digjitale, duke përmirësuar përdorimin e platformave të



	LMS, rrjetet sociale profesionale) dhe zgjedh mjetet/platformën më të përshtatshme për audiencën dhe qëllimin.	rezultuar në akses të dobët.	platformën më të përshtatshme për audiencën/qëllimin.	përshtatshme për audiencën dhe qëllimin.	ndryshme dhe duke udhëzuar kolegët në praktikat më të mira.
	2.4.4. Mësuesi është i vetëdijshëm për rëndësinë e burimeve digjitale të hapura dhe bashkëpunimit në përmirësimin e cilësisë së arsimit.	Nuk është i vetëdijshëm për rëndësinë e burimeve të hapura në arsim ose për bashkëpunimin si mjet për përmirësimin e cilësisë.	Ka një vetëdije bazë për rëndësinë e burimeve të hapura dhe bashkëpunimit, por mund të mos e kuptojë plotësisht ndikimin e tyre në cilësinë e arsimit.	Është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e burimeve të hapura dhe bashkëpunimit në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe në nxitjen e zhvillimit profesional.	Përkrah dhe mbështet përdorimin e burimeve të hapura dhe bashkëpunimin në arsim, duke ndërgjegjësuar kolegët dhe institucionet për përfitimet e tyre dhe duke ndihmuar aktivisht në zhvillimin e politikave arsimore.



Nivelet e vlerësimit të fushës 3: Mësimdhënia dhe të nxënit e pajisur me teknologji

Treguesit	Përshkruesit	Nivelet e vlerësimit			
		Fillestar (1)	Zhvillues (2)	Kompetent (3)	Ekspert (4)
3.1.Mësuesi planifikon dhe zgjedh në mënyrë strategjike mjetet dhe platformat digjitale për të arritur qëllimet e qarta të të nxënit dhe për të mbështetur një integrim funksional të teknologjisë.	3.1.1. Mësuesi përcakton qëllime SMART (<i>Specifike, të Matshme, të Arritshme, të Rëndësishme, të Kufizuara në Kohë</i>) të të nxënit për çdo njësi mësimore dhe planifikon përdorimin e teknologjisë si një mjet thelbësor për arritjen e tyre.	Nuk përcakton qartë qëllime të matshme për mësimin, ose përdor teknologjinë në mënyrë të rastësishme pa e lidhur me objektiva konkrete apo pa e marrë parasysh si mjet thelbësor.	Përcakton qëllime mësimore, por ato mund të mos jenë gjithmonë SMART, dhe planifikimi i përdorimit të teknologjisë është bazik dhe jo gjithmonë i integruar plotësisht me qëllimet.	Përcakton në mënyrë të vazhdueshme qëllime SMART për çdo njësi mësimore dhe planifikon në mënyrë afatgjatë përdorimin e teknologjisë si një mjet thelbësor dhe efektiv për arritjen e tyre.	Jo vetëm që përcakton dhe arrin qëllime SMART me ndihmën e teknologjisë, por harton modele të reja të planifikimit të kurrikulës së integruar me teknologji, duke frymëzuar kolegët të adoptojnë qasje inovative.



	3.1.2. Mësuesi përzgjedh në mënyrë të ndërgjegjshme mjetet dhe platformat digjitale (aplikacione, programe, faqe interneti, LMS) që mbështesin më mirë arritjen e objektivave të të nxënit dhe i njeh përparësitë/vështirësitë e secilës.	Nuk përzgjedh mjete digjitale në mënyrë të ndërgjegjshme, ose përdor vetëm ato më të njohurat pa marrë parasysh efektivitetin e tyre për objektivat, dhe ka pak njohuri për përparësitë/mangësitë.	Përzgjedh mjete dhe platforma digjitale që janë pjesërisht të përshtatshme, dhe njeh disa nga përparësitë/mangësitë, por shpesh mund të mos bëjë zgjedhjet më të mira për qëllimet specifike.	Përzgjedh në mënyrë të ndërgjegjshme dhe racionale mjete dhe platforma digjitale që mbështesin në mënyrë më të mirë arritjen e objektivave të të nxënit, dhe ka një njohuri të mirë të përparësive dhe mangësive të tyre.	Është ekspert në përzgjedhjen e mjeteve digjitale, duke eksploruar vazhdimisht mjete të përparuara dhe të reja, dhe duke shfrytëzuar njohuritë e tij për të krijuar zgjidhje të personalizuar, duke ofruar udhëzime dhe trajnime për kolegët.
	3.1.3. Mësuesi siguron që përdorimi i teknologjisë të jetë i integruar në mënyrë	Përdor teknologjinë rrallë ose vetëm si një shtesë të pavarur (p.sh., thjesht shfaq	Përpiqet të integrojë teknologjinë, por kjo mund të jetë ende kryesisht si një shtesë	Siguron që përdorimi i teknologjisë të jetë integruar në	Është vizionar në integrimin e teknologjisë, duke e përdorur



	funkionale dhe pedagogjike, jo thjesht si një shtesë, duke ndihmuar në transformimin e qasjes mësimore.	një video pa diskutim), pa e integruar atë në mënyrë funksionale në procesin mësimor.	ose në mënyrë jo plotësisht funksionale, duke mos ndikuar thellësisht në qasjen pedagogjike.	mënyrë funksionale dhe pedagogjike, duke u bërë pjesë thelbësore e aktivitetit mësimor dhe duke ndihmuar në transformimin pozitiv të qasjes mësimore.	atë për të transformuar rrënjësisht qasjen mësimore dhe për të krijuar përvoja të thella dhe reja të të nxëni, duke nxitur ndryshime pozitive në praktikat e të tjerëve.
	3.1.4. Mësuesi vlerëson rregullisht (p.sh., në fund të çdo kapitulli/teme) ndikimin e teknologjisë në procesin e të nxënit, angazhimin dhe ecurinë e nxënësve,	Nuk vlerëson ndikimin e teknologjisë në mësim, ose nuk përdor feedback për të kuptuar efektin e saj në angazhimin dhe performancën e nxënësve.	Vlerëson herë pas here ndikimin e teknologjisë, duke përdorur feedback bazik, por vlerësimi nuk është i rregullt ose i detajuar, dhe përmirësimet bazohen pak në të dhëna.	Vlerëson në mënyrë të rregullt (p.sh., në fund të çdo kapitulli/teme) ndikimin e teknologjisë në procesin e të nxënit,	Është një analist i përparuar i ndikimit të teknologjisë, duke përdorur metoda të shumanshme të mbledhjes dhe analizës së të



	duke përdorur feedback zyrtar dhe jozyrtar.			angazhimin dhe performancën e nxënësve, duke përdorur feedback zyrtar (p.sh., anketa, rezultate detyrash) dhe jozyrtar (p.sh., vëzhgime, diskutime) për përmirësim.	dhënave për të matur me saktësi angazhimin dhe performancën, dhe duke e përdorur këtë informacion për të përmirësuar vazhdimisht strategjitë e tij dhe për të ndarë njohuritë me kolegët.
3.2.Mësuesi zbaton me efektivitet mësimin e përzier (blended learning), duke përshtatur	3.2.1. Mësuesi planifikon dhe zbaton qasje të mësimin të përzier, duke drejtëpeshuar metodat tradicionale me ato digjitale për të	Nuk zbaton ose zbaton shumë rrallë elemente të mësimin të përzier; metodat digjitale përdoren në mënyrë të izoluar ose	Planifikon dhe zbaton sesione të herëpashershme të mësimin të përzier, por balanca dhe integrimi i metodave nuk janë gjithmonë të	Planifikon dhe zbaton në mënyrë të rregullt (p.sh., në shumicën e njësive mësimore) qasje të mësimin të	Është model në hartimin dhe zbatimin e modeleve të përparuara të mësimin të përzier, duke



metodologjitë dhe burimet digjitale me infrastrukturën dhe qasjen e nxënësve në teknologji.	rritur efektivitetin e të nxënit.	pa lidhje me qëllimet mësimore.	përshtatshme, duke ofruar përfitime të kufizuara.	përzier, duke balancuar me sukses metodat tradicionale dhe digjitale për të rritur efektivitetin e të nxënit.	krijuar përvoja të reja që integrojnë pa vështirësi teknologjinë dhe pedagogjinë për të nxitur angazhim maksimal dhe rezultate të shkëlqyera të nxënies, duke mentoruar kolegët.
	3.2.2. Mësuesi analizon dhe merr parasysh realitetin e infrastrukturës digjitale në shkollë dhe qasjen e nxënësve në pajisje dhe internet	Nuk merr parasysh infrastrukturën digjitale ose qasjen e nxënësve, duke çuar në pengesa të shpeshta në zbatimin	Është i vetëdijshëm për infrastrukturën dhe qasjen, por përshtatjet në planet mësimore janë të kufizuara ose pa masa parandaluese, duke	Analizon në mënyrë parashikuese realitetin e infrastrukturës digjitale në shkollë dhe	Jo vetëm që analizon thellësisht dhe përshtat planet bazuar në infrastrukturë, por edhe



	gjatë planifikimit, duke përshtatur planet mësimore.	e teknologjisë gjatë orës së mësimi.	shkaktojnë ndonjëherë probleme në proces.	qasjen e nxënësve në pajisje/internet, duke përshtatur në mënyrë efektive planet mësimore për të siguruar zbatimin e pandërprerë të mësimi të përzier	ndihmon aktivisht në hartimin e strategjive shkollore për përmirësimin e qasjes dhe infrastrukturës digjitale, duke parashikuar sfidat dhe duke propozuar zgjidhje të reja.
	3.2.3. Mësuesi ofron në mënyrë parashikuese alternativa për nxënësit që nuk kanë qasje të rregullt në teknologji (p.sh., materiale offline, orë	Planifikon dhe zbaton në mënyrë të rregullt (p.sh., në shumicën e njësive mësimore) qasje të mësimi të përzier, duke balancuar me sukses	Ofron alternativa bazike për nxënësit me qasje të kufizuar, por mund të mos jetë gjithmonë parashikues ose zgjidhjet e ofruara	Ofron në mënyrë parashikuese dhe të rregullt (p.sh., identifikon dhe planifikon për të paktën 80% të rasteve)	Është një mbështetës dhe inovator në sigurimin e qasjes së barabartë, duke krijuar zgjidhje të



	shtesë, punë në grup), duke siguruar qasje të barabartë për të gjithë.	metodat tradicionale dhe digjitale për të rritur efektivitetin e të nxënit.	mund të mos jenë largpamëse.	alternativa efektive për nxënësit që nuk kanë qasje të rregullt në teknologji, duke siguruar në mënyrë të qartë mundësi të barabartë dhe gjithëpërfshirje.	qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse (p.sh., banka burimesh offline, partneritete me komunitetin), duke shërbyer si burim frymëzimi dhe udhëzimi për kolegët dhe institucionet e tjera.
	3.2.4. Mësuesi monitoron dhe vlerëson efektivitetin e metodave të përziera në fund të çdo moduli ose projekti të madh, duke analizuar të dhënat e performancës	Monitoron ose vlerëson efektivitetin e mësimit të kombinuar, ose e bën atë pa përdorur të dhëna apo feedback të rregullt, duke mos	Monitoron efektivitetin e metodave të përziera në mënyrë të herëpashershme dhe përdor feedback-un bazik, por analiza e të dhënave mund të jetë	Monitoron dhe vlerëson në mënyrë të rregullt efektivitetin e metodave të përziera, duke analizuar të	Udhëheq në monitorimin dhe vlerësimin e efektivitetit të mësimit të përzier, duke zhvilluar mjete dhe metodologji



	dhe feedback-un për përmirësim të vazhdueshëm.	çuar në përmirësim të praktikës.	e cekët dhe përmirësimet jo gjithmonë të bazuara në prova.	dhënat e performancës së nxënësve dhe feedback-un për të bërë përmirësim të vazhdueshme dhe të argumentuara në praktikën e tij.	të përparuar të analizës së të dhënave dhe i përdor ato për përmirësimin e modeleve pedagogjike dhe për të shpërndarë praktikën më të mira me komunitetin arsimor.
	3.2.5. Mësuesi hulumton risi teknologjike dhe përshtat praktikën e tij për të përmirësuar përvojën mësimore.	Nuk hulumton ndaj risive teknologjike dhe nuk bën përshtatje të praktikave të tij, duke mbetur te metodat ekzistuese.	Hulumton risi teknologjike në mënyrë rastësore, por përshtatja e praktikave është e kufizuar ose bëhet me vonesë.	Hulumton në mënyrë të rregullt (p.sh., të paktën 3-4 risi në vit) risi teknologjike me vlerë dhe në mënyrë aktive	Është inovator dhe kërkues aktiv i risive teknologjike, duke testuar modele të reja pedagogjike bazuar në



				përshtat praktikat e tij/saj për të përmirësuar përvojën mësimore të nxënësve, duke shfaqur një qasje të hapur ndaj risisë.	teknologji, shpesh duke marrë pjesë në pilotime apo duke udhëhequr projekte kërkimore-veprimi për të zhvilluar dhe përshtatur teknologjinë për nevoja specifike arsimore, duke shpërndarë gjetjet me kolegët.
	3.2.6. Mësuesi planifikon dhe zbaton qasje të mësimi të përzier, duke drejtpeshuar metodat tradicionale	Nuk zbaton ose zbaton shumë rrallë elemente të mësimi të përzier; metodat digjitale përdoren në	Planifikon dhe zbaton sesione të herëpashershme të mësimi të përzier, por balanca dhe	Planifikon dhe zbaton në mënyrë të rregullt (p.sh., në shumicën e orëve mësimore)	Është model në hartimin dhe zbatimin e modeleve të përparuara të



	me ato digjitale për të rritur efektivitetin e të nxënit.	mënyrë të izoluar ose pa lidhje me qëllimet mësimore.	integrimi i metodave nuk janë gjithmonë të përshtatshme, duke ofruar përfitime të kufizuara.	qasje të mësimin të përzier, duke balancuar me sukses metodat tradicionale dhe digjitale për të rritur efektivitetin e të nxënit.	mësimin të përzier, duke krijuar përvoja të reja që integrojnë teknologjinë në procesin mësimor për të nxitur angazhim maksimal dhe rezultate të shkëlqyera të nxënësve, duke mentoruar kolegët.
3.3.Mësuesi krijon dhe menaxhon mjedise mësimore interaktive, tërheqëse dhe	3.3.1. Mësuesi përdor teknologjinë për të krijuar prezantime dinamike, video edukative, infografi dhe materiale të tjera	Përdor minimalisht teknologjinë, duke shfaqur materiale ekzistuese (p.sh., prezantime statike të gjetura online) pa	Përdor rregullisht teknologjinë për të krijuar materiale bazike (p.sh., prezantime me animacione të	Krijon rregullisht materiale digjitale dinamike dhe tërheqëse (p.sh., prezantime me	Krijon vazhdimisht materiale digjitale inovative dhe të personalizuar



të sigurta duke përdorur teknologjinë, duke nxitur bashkëpunimin dhe krijimtarinë.	që e bëjnë mësimin më vizual, ndërveprues dhe tërheqës për nxënësit.	ndërveprim ose personalizim të thellë.	thjeshta, video të shkurtra), por ndërveprimi me nxënësit është i kufizuar.	elemente ndërveprues, video edukative të krijuara vetë, infografi) që pasurojnë ndjeshëm aspektin vizual dhe ndërveprues të mëimit, duke përdorur të paktën 3 lloje të ndryshme mjetesh.	(p.sh., simulime virtuale, materiale 3D ndërvepruese), të cilat jo vetëm tërheqin nxënësit, por i nxitin ata të jenë krijues, duke shërbyer si model për kolegët.
	3.3.2. Mësuesi shfrytëzon platforma online dhe aplikacione për të ofruar mundësi për të nxënë ndërveprues (p.sh., kuice, lojëra	Shfaq herë pas here aktivitete ndërvepruese (p.sh., një kuice të thjeshta) të gjetura online, por nuk krijon vetë	Përdor rregullisht (p.sh., çdo javë) platforma dhe aplikacione për të ofruar mundësi ndërvepruese (p.sh.,	Shfrytëzon në mënyrë efektive (p.sh., të paktën 2-3 herë në muaj) platforma dhe aplikacione për të	Është pionier në shfrytëzimin e platformave dhe aplikacioneve për të ofruar përvoja të thella



	edukative, simulime) dhe krijon veprimtari që nxitin nxënësit të zbulojnë në mënyrë të pavarur.	aktivitete apo nuk nxit hulumtimin e pavarur.	kuice me zgjedhje të shumëfishtë), por veprimtaritë e pavarura janë të kufizuara.	krijuar dhe zbatuar veprimtari ndërvepruese (p.sh., lojëra edukative të personalizuar, simulime) dhe harton detyra që nxitin vazhdimisht nxënësit të hulumtojnë dhe të zbulojnë në mënyrë të pavarur.	ndërvepruese dhe të personalizuar të nxëni, duke hartuar në mënyrë të rregullt projekte kërkimore të pavarura dhe eksperimente virtuale që zhvillojnë aftësi të mendimit kritik, shpesh duke i zhvilluar vetë këto aplikacione ose duke përshtatur ato ekzistuese në mënyrë të përparuar.
--	--	--	--	--	--



	3.3.3. Mësuesi menaxhon në mënyrë efektive pajisjet digjitale, siguron qasje të barabartë dhe mban një mjedis të sigurt dhe respektueshëm online, duke përfshirë menaxhimin e vëmendjes së nxënësve.	Ka vështirësi në menaxhimin e pajisjeve digjitale në klasë, has probleme me qasjen e nxënësve, dhe ka mungesë rregullash të qarta për sjelljen online.	Menaxhon thjesht pajisjet, siguron qasje për shumicën e nxënësve dhe ka rregulla minimale për sigurinë online, por mund të hasë vështirësi në menaxhimin e shpërqendrimeve.	Menaxhon në mënyrë kompetente pajisjet digjitale, siguron qasje të barabartë për të gjithë nxënësit, dhe vazhdimisht mban një mjedis të sigurt dhe respektueshëm online, duke zbatuar strategji efektive për menaxhimin e shpërqendrimeve.	Është model në menaxhimin e mjediseve digjitale, duke zhvilluar strategji të reja për sigurinë online, qasjen e barabartë dhe menaxhimin e vëmendjes. ai/ajo shpesh mentoron kolegët dhe përkrah ata për përmirësimin e infrastrukturës dhe politikave shkollore.
	3.3.4. Mësuesi përdor mjete digjitale për të ofruar	Përdor mjete digjitale kryesisht për detyra	Përdor herë pas here mjete digjitale për	Përdor në mënyrë të rregullt mjete	Zhvillon dhe zbaton strategji të



	detyra sfiduese dhe të personalizuar që adresojnë nevojat dhe nivelet e ndryshme të nxënësve, duke nxitur të nxënit e diferencuar.	standarde për të gjithë klasën, duke ofruar pak ose aspak personalizim apo diferencim.	detyra që synojnë nivele të ndryshme nxënësish, por personalizimi është i kufizuar dhe jo i rregullt.	digjitale për të ofruar detyra sfiduese dhe të personalizuar që adresojnë nevojat dhe nivelet e nxënësve, duke lehtësuar të nxënit e diferencuar dhe duke siguruar mbështetje shtesë kur është e nevojshme.	avancuara të të nxënit të personalizuar dhe të diferencuar me teknologji, duke krijuar itinerare mësimore të veçanta për çdo nxënës bazuar në të dhënat e performancës dhe stilin e të nxënit, dhe ndërton sisteme të përshtatshme të mësimimit.
	3.3.5. Mësuesi përdor mjete bashkëpunimi online (p.sh., Google Docs, Teams etj.) për t'i	Nuk përdor mjete bashkëpunimi online ose i përdor ato shumë rrallë për	Përdor herë pas here mjete bashkëpunimi online për projekte të thjeshta, por udhëzimi	Përdor në mënyrë të rregullt (të paktën 2-3 projekte në vit)	Harton dhe drejton projekte të ndërlikuara bashkëpunuese



	lejuar nxënësit të punojnë së bashku në projekte, të shkëmbejnë ide dhe të ndajnë materiale, duke nxitur krijimtarinë e tyre nëpërmjet krijimit të produkteve digjitale.	detyra të thjeshta, pa nxitur krijimtarinë apo shkëmbimin e thellë të ideve.	për bashkëpunim efektiv ose nxitja e krijimtarisë me mjete digjitale është e kufizuar.	mjete bashkëpunimi online për t'i angazhuar nxënësit në to dhe për t'i ndarë këto materiale, duke i udhëzuar ata të krijojnë produkte digjitale krijuese (video, prezantime podkaste etj.).	online që nxisin krijimtarinë e nivelit të lartë dhe zgjidhjen e problemeve, duke mentoruar nxënësit në përdorimin e mjeteve të përparuara digjitale për prodhimin e përmbajtjes dhe duke përkrahur bashkëpunimin ndërlëndor apo me komunitetin e gjerë.
	3.3.6. Mësuesi përdor platforma online për të	Përdor shumë rrallë platforma online për	Përdor herë pas here platforma online për	Përdor në mënyrë të rregullt (p.sh.,	Harton sisteme vlerësimi të



	krijuar dhe administruar kuice, teste dhe detyra, duke ofruar feedback të menjëhershëm dhe duke vlerësuar përparimin e nxënësve në mënyrë efikase.	vlerësim, duke u mbështetur kryesisht te metodat tradicionale dhe pa feedback të menjëhershëm.	kuice të thjeshta, por feedback-u është i kufizuar dhe monitorimi i përparimit nuk është si rregullt.	për çdo njësi/kapitull) platforma online për të krijuar dhe administruar kuice, teste dhe detyra, duke ofruar feedback të menjëhershëm dhe të detajuar për nxënësit dhe duke përdorur të dhënat e performancës për të përmirësuar procesin e të nxënësve.	përshtatura dhe të ndërthurura duke përdorur platforma online, ofron feedback diferencuar dhe mbështetje profesionale (coaching) bazuar në analizën e të dhënave të nxënësve dhe shfrytëzon inteligjencën artificiale ose mjete të përparuara për vlerësim diagnostikues dhe formues.
--	---	---	--	--	--



Nivelet e vlerësimit të fushës 4: Vlerësimi

Treguesit	Përshkruesit	Nivelet e vlerësimit			
		Fillestar (1)	Zhvillues (2)	Kompetent (3)	Ekspert (4)
4.1. Mësuesi zhvillon dhe zbaton vlerësimin formues digjital, duke e përshtatur nga ana pedagogjike dhe duke përdorur të dhënat për të përmirësuar në	4.1.1. Mësuesi përdor platforma online dhe aplikacione (si Google Forms, Kahoot, Mentimeter, Socrative ¹¹) për të krijuar dhe menaxhuar veprimtari të vlerësimit të vazhduar ndërvepruese.	Nuk përdor platforma ose aplikacione digjitale për vlerësim formues, ose e bën vetëm me ndihmë të vazhdueshme dhe me mundësi përdorimi të kufizuar.	Përdor disa platforma ose aplikacione (p.sh., Google Forms) kryesisht për kuicet bazë, shpesh me udhëzim, ose pa shfrytëzuar plotësisht mundësitë e përdorimit ndërveprues dhe analitik.	Përdor rregullisht platforma dhe aplikacione të ndryshme (si Kahoot, Mentimeter, Socrative) për të krijuar kuice, sondazhe dhe pyetësorë ndërveprues, duke testuar njohuritë dhe kuptimin bazë	Zgjedh dhe ndërthur në mënyrë të planifikuar dhe inovative një larmi të gjerë mjetesh digjitale, duke përfshirë ato më të përparuarat, për të krijuar vlerësime formuese të ndërlikuara që diagnostikojnë thellësisht të kuptuarit, aftësitë e mendimit kritik dhe nevojat individuale.

¹¹ Google Forms, Kahoot, Mentimeter dhe Socrative janë mjete digjitale ndërvepruese që përdoren në arsim për të vlerësuar, angazhuar dhe përfshirë nxënësit në mënyrë aktive në procesin mësimor.



mënyrë dinamike mësimdhënien.				të nxënësve në kohë reale.	
	4.1.2. Mësuesi harton detyra vlerësimi formues që monitorojnë ecurinë e nxënësve, duke përfshirë lloje të ndryshme pyetjesh (p.sh., të hapura, me alternativa, zgjidhje problemesh).	Planifikon vlerësime të njëjta ose vetëm me një lloj pyetjeje (p.sh., vetëm zgjedhje të shumëfishta), pa monitoruar ecurinë e nxënësve ose pa lidhje me objektivat mësimore.	Planifikon detyra vlerësimi formues me pak variacion në llojet e pyetjeve (kryesisht të mbyllura), dhe me monitorim rastësor të ecurisë së nxënësve, shpesh duke humbur mundësinë për të diagnostikuar vështirësi të ndryshme.	Harton vlerësime të larmishme formuese me pyetje të hapura dhe të mbyllura, duke përfshirë edhe situata problemore, dhe monitoron rregullisht ecurinë e nxënësve gjatë procesit mësimor për të identifikuar pikat e forta dhe sfidat.	Zhvillon dhe zbaton një qasje të rregullt dhe krijuese të vlerësimit formues, duke hartuar me mjeshtëri detyra që vlerësojnë thellësinë e të kuptuarit, aftësitë e mendimit kritik dhe zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara, duke përdorur modele të larmishme dhe të ndërlidhura të vlerësimit.
	4.1.3. Mësuesi siguron që aktivitetet e vlerësimit të jenë të përshtatura me	Nuk i përshtat veprimtaritë e vlerësimit me nivelin ose	Përpiqet të përshtatë veprimtaritë e vlerësimit, por me vështirësi në	Përshtat aktivitetet e vlerësimit digjital për nivelin dhe nevojat e ndryshme	Krijon dhe zbaton strategji vlerësimi personalizuese dhe të përshtatura duke



	nivelin dhe nevojat individuale të nxënësve, duke marrë parasysh ndryshueshmërinë e klasës.	nevojat e ndryshme të nxënësve, duke ofruar një qasje të njëjtë për të gjithë.	adresimin e plotë të nevojave të veçanta ose diversitetit kulturor/gjuhësor të nxënësve, ose bën diferencim sipërfaqësor.	të nxënësve (p.sh., me detyra të diferencuara, formate të ndryshme përgjigjeje), duke marrë parasysh diversitetin e klasës dhe stilet e të nxënësve.	shfrytëzuar mundësinë e teknologjisë (p.sh. platforma të përshtatura) për të adresuar në mënyrë paraprake dhe gjithëpërfshirëse nevojat e çdo nxënësi dhe për të rritur angazhimin dhe suksesin e tyre.
	4.1.4. Mësuesi ndërthur metodat tradicionale të vlerësimit (p.sh., vëzhgimi, diskutimi në klasë) me ato digjitale për të mbledhur informacion të	Përdor vetëm metoda tradicionale ose vetëm metoda digjitale të vlerësimit, pa i ndërthurur ose duke i parë ato si të shkëputura nga njëra-tjetra.	Përdor disa metoda digjitale dhe tradicionale, por pa një integrim të qartë ose efektiv; mbledhja e informacionit mbetet e copëzuar dhe jo gjithëpërfshirëse.	Ndërthur në mënyrë efektive metodat tradicionale të vlerësimit me ato digjitale (vëzhgimet e nxënësve gjatë punës në platforma digjitale) për të mbledhur një larmi gjerë informacioni	Zhvillon një qasje të integruar dhe tërësore të vlerësimit, duke shfrytëzuar në mënyrë të bashkërenduar pikat e forta të vlerësimit tradicional dhe digjital për të siguruar një pamje të plotë, të balancuar dhe të vërtetë të ecures dhe



	gjithanshëm mbi të nxënit.			dhe për të pasqyruar thellësinë e të nxënit të nxënësve.	kompetencave të nxënësve.
	4.1.5. Mësuesi përdor të dhënat nga vlerësimet formuese për të identifikuar vështirësitë e nxënësve dhe i adreson ato në kohë reale.	Nuk i përdor të dhënat e vlerësimit të vazhduar ose nuk i adreson vështirësitë e nxënësve në mënyrë të rregullt, duke lejuar që problemet të vazhdojnë.	Përdor vlerësimin e vazhduar, por mund të ketë vështirësi në interpretimin e të dhënave, në ofrimin e mbështetjes së menjëhershme dhe efektive, ose adresimi është i vonuar.	Përdor vlerësimet e vazhduara për të identifikuar konceptet ku nxënësit kanë vështirësi dhe i adreson ato menjëherë, duke dhënë mbështetje shtesë dhe duke përshtatur strategjitë e ardhshme.	Shfrytëzon analiza të përparura të të dhënave të vlerësimit të vazhduar për të diagnostikuar shkaqet rrënjësore të vështirësive të nxënësve, duke planifikuar dhe zbatuar ndërhyrje të personalizuar dhe duke monitoruar efektivitetin e tyre në kohë reale.
	4.1.6. Mësuesi përshtat teknikat e vlerësimit për të	Nuk i përshtat teknikat e vlerësimit për të	Përpiqet të përshtatë teknikat, por me sukses të kufizuar në	Përshtat teknikat e vlerësimit digjital (elementë loje,	Harton dhe zbaton strategji vlerësimi jashtëzakonisht



	nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe për të rritur motivimin e tyre.	nxituir pjesëmarrjen ose motivimin e nxënësve, duke përdorur qasje të vjetruara që zbehin angazhimin e nxënësve.	nxitjen e pjesëmarrjes aktive ose rritjen e qëndrueshme të motivimit të nxënësve, ose përdor stimuj të jashtëm.	kuize ndërvepruese, vlerësim nga bashkëmoshatarët) për të nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe për të rritur motivimin e tyre për të nxënë.	tërheqëse dhe ndërvepruese, duke krijuar një mjedis ku nxënësit ndihen të fuqizuar, të motivuar dhe të angazhuar thellë në procesin e tyre të vlerësimit dhe të nxënësve, duke i kthyer sfidat në mundësi rritjeje.
4.2.Mësuesi ofron feedback të menjëhershëm, të personalizuar dhe cilësor duke shfrytëzuar mjetet digjitale.	4.2.1. Mësuesi përdor aplikacione dhe platforma për të dhënë feedback të shpejtë dhe specifik mbi performancën e nxënësve.	Nuk përdor aplikacione ose platforma për të dhënë feedback, ose feedback-u është i përgjithshëm dhe i vonuar.	Përdor disa aplikacione, por feedback-u shpesh është i përgjithshëm, me vonesë, ose i përqendruar vetëm te gabimet pa udhëzime të qarta për përmirësim të thelluar.	Përdor rregullisht aplikacione dhe platforma (p.sh., komente brenda dokumenteve, rubrika digjitale) për të dhënë feedback të shpejtë, specifik dhe të qartë mbi performancën e	Zgjedh dhe integron me mjeshtëri një larmi të gjerë mjetesh digjitale për të ofruar feedback të thelluar, të menjëhershëm dhe të personalizuar, duke e ndërlidhur performancën e nxënësve me rezultatet e të nxënësve, duke nxitur



				nxënësve në detyra dhe veprimtari të ndryshme.	reflektimin dhe duke dhënë udhëzime hap pas hapi.
	4.2.2. Mësuesi ofron feedback në formate të ndryshme (p.sh., komente të shkruara, mesazhe zanore, video) për të siguruar qartësi dhe përshtatje me stilin e të nxënit të nxënësve.	Ofron feedback vetëm në një format të vetëm, pa marrë parasysh pëlqimet ose stilin e të nxënit të nxënësve (p.sh., vetëm me shkrim).	Ofron feedback në disa formate, por mund të mos e përshtatë gjithmonë me stilin e të nxënit të nxënësve, ose thellësia e feedback-ut ndryshon ndjeshëm midis formateve.	Ofron feedback në formate të ndryshme (komente të shkruara, mesazhe zanore, video-komente të shkurtra) për të siguruar qartësi sa më të madhe dhe përshtatje me stilin e të nxënit të nxënësve, duke rritur efikasitetin e të kuptuarit.	Përshtat në mënyrë parashikuese dhe të re formatin e feedback-ut për çdo nxënës, duke eksperimentuar me formate të reja multimediale (p.sh., screencasts - video shpjeguese) dhe duke i përdorur ato për të rritur angazhimin emocional dhe kuptimplotë të nxënësit.
	4.2.3. Mësuesi përdor mjete të programuara të	Nuk përdor mjete të programuara të korrigjimit, duke	Përdor mjete të programuara të korrigjimit në mënyrë	Përdor mjete të programuara të korrigjimit në teste	Ndërthur me zgjuarsia mjetet e programuara të korrigjimit si pjesë e një



	korrigjimit për të dhënë përgjigje të menjëhershme dhe për të liruar kohë për feedback cilësor.	humbur kohë me detyra rutinë të korrigjimit, gjë që mund të ndikojë te cilësia e feedback-ut të thelluar.	të kufizuar (p.sh., vetëm për testet me zgjedhje të shumta), por nuk e shfrytëzon gjithmonë kohën e liruar për feedback më thellë ose më të personalizuar.	dhe pyetësorë digjitalë për të dhënë përgjigje të menjëhershme dhe të sakta, duke kursyer kohë për t'u fërqendruar te feedback-u cilësor dhe i personalizuar për detyrat e vështira dhe krijuese.	strategjie të përgjithshme vlerësimi, duke i përdorur ato për efikasitet dhe duke orientuar burimet e veta drejt ofrimit të feedback-ut të thellë dhe formues për pyetjet e hapura, projektet dhe aftësitë e ndërlikura të mendimit.
	4.2.4. Mësuesi ofron mundësi për vlerësim nga bashkëmoshatarët dhe vetëvlerësim përmes platformave digjitale, duke	Nuk ofron mundësi për vlerësim nga bashkëmoshatarët ose vetëvlerësim përmes platformave digjitale, ose nëse	Ofron mundësi rastësore për vlerësim/vetëvlerësim përmes platformave digjitale, por pa udhëzime të qarta për nxënësit ose pa nxitur	Ofron rregullisht mundësi për vlerësim nga bashkëmoshatarët dhe vetëvlerësim përmes platformave digjitale, duke ndihmuar nxënësit	Zhvillon dhe zbaton strategji inovative dhe të qëndrueshme për vlerësimin nga bashkëmoshatarët dhe vetëvlerësimin, duke përdorur platformat digjitale për të kultivuar



	nxitur reflektimin e nxënësve.	ofron, nuk i udhëzon nxënësit për procesin.	reflektim të thellë mbi mësimin.	të reflektojnë mbi progresin, pikat e forta/dobëta dhe hapat e ardhshëm.	aftësi që ndihmojnë nxënësin të kuptojë si po mëson, reflektim të thellë dhe vetë-rregullim të të nxënësve të nxënësve në mënyrë të pavarur.
	4.2.5. Mësuesi siguron që feedback-u digjital të jetë i dobishëm, i kuptueshëm dhe i orientuar drejt përmirësimit të aftësive dhe njohurive.	Feedback-u i dhënë digjitalisht është shpesh i paqartë, jo i dobishëm, ose i përqendruar vetëm te nota/gabimi pa udhëzime për përmirësim.	Feedback-u është i dobishëm dhe i kuptueshëm, por mund të mos jetë gjithmonë i detajuar apo i orientuar drejt hapave konkretë për përmirësim afatgjatë të nxënësve ose pa shfrytëzuar plotësisht mjetet digjitale.	Feedback-u i dhënë përmes mjeteve digjitale është gjithnjë i dobishëm dhe ofron udhëzime specifike për përmirësimin e aftësive dhe njohurive të nxënësve, duke i lidhur me rezultatet e të nxënësve.	Krijon kulturë feedback-u transformues dhe të personalizuar në klasë, i lidhur me rezultatet e të nxënësve dhe i orientuar drejt zhvillimit të kompetencave digjitale të shekullit 21, duke i fuqizuar nxënësit të ndërmarrin hapa drejt rritjes dhe pavarësisë.
	4.2.6. Mësuesi monitoron	Nuk monitoron se si nxënësit e	Monitoron në mënyrë sipërfaqësore	Monitoron në mënyrë aktive	Përdor analiza të thelluara të të dhënave të



	mënyrën si nxënësit përdorin feedback-un dhe përshtat strategjitë bazuar në efektivitetin e tij.	përdorin feedback-un, duke mos ditur nëse ai është efektiv, ose nuk përshtat metodat e tij.	përdorimin e feedback-ut nga nxënësit, por nuk arrin gjithmonë të përshtatë efektivisht metodat e tij ose burimet shtesë, duke bërë ndryshime rastësore.	mënyrën se si nxënësit përdorin feedback-un e marrë për të përmirësuar punën e tyre dhe përshtat strategjitë e feedback-ut bazuar në nevojat e shfaqura dhe në reagimin e nxënësve.	monitorimit (p.sh., analizat e detyrave të ridorëzuara, cilësia e pyetjeve të nxënësve pas feedback-ut) për të përmirësuar dhe personalizuar vazhdimisht strategjitë e feedback-ut, duke dëshmuar ndikimin pozitiv të tyre në arritjet e nxënësve dhe zhvillimin e tyre të të kuptuarit se si po mëson.
4.3.Mësuesi analizon thellësisht të dhënat e vlerësimit digjital dhe i	4.3.1. Mësuesi përdor teknologjinë për të mbledhur, ruajtur, organizuar dhe analizuar të	Nuk përdor teknologjinë për të mbledhur, ruajtur ose analizuar të dhënat e	Përdor disa mjete teknologjike, por mbledhja, ruajtja ose analiza e të dhënave është shpesh jo e rregullt, e paplotë,	Përdor teknologjinë (p.sh., sistemet e menaxhimit të të nxënit LMS, fletët përlllogaritëse - spreadsheets) për të	Zhvillon dhe zbaton një sistem të përparuara digjitale për menaxhimin e të dhënave të vlerësimit, duke përdorur mjete



përdor ato në mënyrë të planifikuar për të përshtatur dhe diferencuar mësimdhënien.	dhënat e vlerësimit në mënyrë efektive.	vlerësimit në mënyrë të rregullt ose i shkarkon ato në formate të papërshtatshme.	ose jo efektive, duke ndikuar në vlefshmërinë e analizave.	mbledhur, ruajtur dhe analizuar të dhënat e vlerësimit në mënyrë efektive, duke organizuar informacionin në formate të përshtatshme për analizë dhe interpretim.	analitike (p.sh., softuerë statistikore, funksione analitike të platformave LMS) për të nxjerrë informacione të thelluara dhe të vlefshme për vendimmarrje pedagogjike.
	4.3.2. Mësuesi analizon prirjet dhe modelet në performancën e nxënësve për të identifikuar konceptet dhe aftësitë ku ata kanë nevojë për mbështetje shtesë.	Nuk analizon prirjet në performancën e nxënësve, ose i vështirësitë i identifikon vetëm në mënyrë rastësore dhe jo të bazuar në të dhëna.	Analizon vetëm prirjet të dukshme (p.sh., nota mesatare), por mund të mos thellohet në identifikimin e shkaqeve rrënjësore të vështirësive ose të mos dallojë modelet	Analizon prirjet dhe modelet në performancën e nxënësve (pyetjet më të gabuara, fushat e dobëta) për të identifikuar konceptet dhe aftësitë ku ata kanë nevojë për	Përdor analiza të thelluara të të dhënave (përfshirë analizën krahasuese, trendet afatgjata dhe, nëse është e mundur, prediktive) për të parashikuar vështirësitë, për të zbuluar modelet e fshehura në të nxënësve



			më të ndërlikuara në të dhënat.	mbështetje shtesë, duke përdorur raportet e platformave digjitale.	dhe për të planifikuar ndërhyrje parashikuese, të bazuara në të dhëna.
	4.3.3. Mësuesi përdor të dhënat për të diferencuar mësimin dhe për të personalizuar strategjitë mësimore sipas nevojave individuale të nxënësve.	Nuk përdor të dhënat për të diferencuar mësimin ose për të personalizuar strategjitë, duke ofruar një qasje të unifikuar “një masë për të gjithë”.	Përdor të dhënat në një farë mase për diferencim (p.sh., grupime bazë), por pa personalizuar thellësisht strategjitë mësimore për çdo nxënës ose pa efikasitet të plotë në adresimin e nevojave specifike.	Përdor të dhënat e vlerësimit për të diferencuar në mënyrë efektive mësimin dhe për të personalizuar strategjitë mësimore, duke ofruar burime, aktivitete të përshtatura dhe rrugë të ndryshme të të nxënit sipas nevojave të nxënësve.	Zhvillon dhe zbaton programe të personalizuar dhe të përshtatura të të nxënit (Personalized Learning Paths) bazuar në analiza të detajuara të të dhënave, duke optimizuar përvojën mësimore për çdo nxënës dhe duke ndërtuar aftësitë e vetëdrejtimit dhe pavarësisë.



	4.3.4. Mësuesi planifikon dhe zbaton ndërhyrje specifike për nxënësit me performancë të ulët ose nevoja të veçanta, duke përdorur të dhënat me efikasitet.	Nuk planifikon ndërhyrje specifike, ose ato janë të paorganizuara dhe jo të bazuara në të dhëna të vlerësimit, duke mos adresuar shkaqet reale të vështirësive.	Planifikon disa ndërhyrje, por mund të mos i bazojë ato plotësisht në të dhëna ose të mos vlerësojë efektivitetin e tyre në mënyrë të përpiktë, duke pasur rezultate të ndryshueshme.	Planifikon dhe zbaton ndërhyrje specifike (p.sh., orë shtesë, materiale diferencuese, mentorim) për nxënësit me performancë të ulët ose me nevoja të veçanta, duke përcaktuar metodat më efektive dhe duke monitoruar përparimin.	Krijon dhe menaxhon një kuadër strategjik të ndërhyrjeve të diferencuara dhe të bazuara në të dhëna, duke vlerësuar efektivitetin e tyre, si dhe duke përshtatur strategjitë për të siguruar rritjen sa më të madhe të çdo nxënësi, duke bashkëpunuar me specialistë të tjerë.
	4.3.5. Mësuesi përdor vizualizime të të dhënave (grafikë, tabela, raporte nga sistemet digjitale) për të	Nuk përdor vizualizime të të dhënave për reflektim ose komunikim me palët e	Përdor vizualizime bazë, por mund të mos i interpretojë thellësisht ose të mos i shfrytëzojë efektivisht për	Përdor vizualizime të të dhënave (grafikë, tabela, raporte nga sistemet digjitale) për të reflektuar mbi	Harton dhe përdor vizualizime të përparuara dhe ndërvepruese të të dhënave, duke ndërtuar raporte që mundësojnë



	reflektuar mbi sukseset, sfidat dhe për të komunikuar ecurinë.	interesuara, duke u bazuar vetëm te numrat ose notat.	reflektim personal dhe komunikim kuptimplotë me të tjerët.	sukseset dhe sfidat e nxënësve, si dhe për të komunikuar qartë dhe në mënyrë transparente përparimin me palët e interesuara.	një analizë kritike të thelluar të progresit dhe që shërbejnë si një mjet i fuqishëm për dialogun e frytshëm me nxënësit, prindërit dhe kolegët, duke nxitur bashkëpunimin.
	4.3.6. Mësuesi ndërvepron me nxënësit dhe prindërit duke përdorur platforma të përshtatshme digjitale për të ndarë rezultatet dhe për të diskutuar	Nuk ndërvepron me nxënësit ose prindërit përmes platformave digjitale për të ndarë rezultatet ose komunikimi është i kufizuar dhe joefektiv.	Ndërvepron me nxënësit ose prindërit digjitalisht, por komunikimi është i kufizuar në ndarjen e rezultateve, pa diskutime të thelluara për strategjitë e përmirësimit ose pa nxitur bashkëpunim aktiv.	Ndërvepron rregullisht me nxënësit dhe prindërit duke përdorur platforma të përshtatshme (p.sh., platformat e shkollës, email-in, mesazhe të sigurta) për të ndarë rezultatet e vlerësimit dhe për	Krijon një partneritet aktiv, transparent dhe bashkëpunues me nxënësit dhe prindërit, duke përdorur platforma bashkëpunuese (p.sh., forume, video-konferenca) për të ndarë të dhëna të detajuara të ecurisë, për të bashkëkrijuar plane veprimi dhe për të nxitur



	strategjitë për përmirësim.			të diskutuar strategjitë konkrete për përmirësimin e të nxënit.	një kulturë përgjegjësie të përbashkët për suksesin e nxënësit.
4.4.Mësuesi përdor portofolin digjital si një mjet gjithëpërfshirës për vlerësimin e vërtetë, reflektimin dhe komunikimin e ecures së nxënësve.	4.4.1. Mësuesi përdor platforma të dedikuara (p.sh., Seesaw, Google Sites, OneNote ¹²) për të krijuar dhe menaxhuar portofolet digjitale të nxënësve.	Nuk përdor platforma të caktuara për të krijuar ose menaxhuar portofolet digjitale, ose ka një qasje të shkëputur dhe joefektive.	Përdor në mënyrë rastësore një platformë, por menaxhimi është i paorganizuar, veçoritë e përdorimit të saj nuk shfrytëzohen plotësisht, ose ndihma e nevojshme është e lartë.	Përdor rregullisht platforma të caktuara për të krijuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive portofolet digjitale të nxënësve, duke organizuar materialet në mënyrë të qartë dhe të arritshme.	Zgjedh dhe personalizon platforma të përcaktuara të portofolit digjital, duke zhvilluar struktura të reja dhe duke integruar mjete të tjera për të përmirësuar menaxhimin, vlerësimin dhe prezantimin e

¹² Seesaw, Google Sites dhe OneNote janë platforma digjitale që lehtësojnë organizimin, dokumentimin dhe ndarjen e punës së nxënësve në formën e një portofoli.



					punës së nxënësve, shpesh duke trajnuar dhe kolegët.
	4.4.2. Mësuesi nxit dhe udhëzon nxënësit të ruajnë dhe organizojnë në portofol materiale të ndryshme që pasqyrojnë zhvillimin dhe thellësinë e të nxënit (p.sh., ese, projekte, video, prezantime, refleksione).	Nuk nxit nxënësit të ruajnë materiale në portofol, ose mbledhja është pa qëllim të qartë, vetëm detyrë pa kuptim.	Nxit nxënësit të ruajnë disa materiale, por pa shumëllojshmëri të mjaftueshme ose pa udhëzime të qarta se si këto materiale pasqyrojnë ecurinë dhe lidhen me objektivat e të nxënit.	Nxit nxënësit të ruajnë në portofol materiale të ndryshme (ese, projekte, video, prezantime, refleksione) që pasqyrojnë përparimin dhe thellësinë e të nxënit të tyre, duke dhënë udhëzime të qarta.	Udhëzon nxënësit në mënyrë strategjike për të kurojtur një portofol të pasur me prova të ndryshme të nxënit (përfshirë dëshmitë e aftësive ndërlëndore, zhvillimit personal dhe krijimtarinë), duke nxitur vetëpërgjegjësinë dhe pronësinë mbi procesin e të nxënit.
	4.4.3. Mësuesi vlerëson performancën e nxënësve bazuar	Nuk vlerëson performancën e nxënësve bazuar	Vlerëson performancën bazuar në portofolet, por	Vlerëson performancën e nxënësve në bazë të	Përdor portofolet digjitale si mjetin kryesor për një vlerësim



	në përmbajtjen e portofolit digjital, duke marrë parasysh zhvillimin e tyre kohor dhe cilësinë e punës.	në portofolet digjitale, ose e bën në mënyrë sipërfaqësore dhe jo të vazhdueshme, duke u fokusuar vetëm te produkti përfundimtar.	mund të mos thellohet në analizën e përparimit kohor ose të mos zbatojë kritere të qarta vlerësimi për cilësinë e punës, duke e bërë vlerësimin subjektiv.	përmbajtjes së portofolit digjital, duke marrë parasysh zhvillimin e tyre gjatë një periudhe të caktuar dhe duke zbatuar kritere vlerësimi të qarta për cilësinë e punës.	të vërtetë dhe të thelluar të rritjes dhe zhvillimit të nxënësve, duke identifikuar me saktësi pikat e forta, fushat për përmirësim dhe duke ofruar feedback specifik dhe frymëzues që lidh provat me kompetencat.
	4.4.4. Mësuesi përdor portofolin digjital për të nxitur reflektimin e nxënësve mbi arritjet dhe sfidat e tyre akademike.	Nuk përdor portofolet për të nxitur reflektimin e thellë të nxënësve, ose reflektimi është i detyruar dhe sipërfaqësor.	Përdor portofolet për reflektim, por nxënësit mund të mos angazhohen në një reflektim të thellë ose të rregullt, duke e parë atë si një detyrë formale dhe jo si mjet për vetë-njohje.	Përdor portofolin digjital për të nxitur reflektimin e thellë të nxënësve mbi arritjet dhe sfidat e tyre akademike dhe personale, duke i udhëzuar ata në procesin e vetë-analizës dhe	Ndërthur reflektimin si një element thelbësor dhe të vazhdueshëm të procesit të portofolios, duke nxitur nxënësit të zhvillojnë aftësi të larta të vetënjohjes, të vendosin qëllime për veten dhe të shfaqin vetëdrejtim në



				vendosjes së qëllimeve.	rrugëtimin e tyre të nxënit, shpesh duke përdorur pyetje stimuluese dhe modele.
	4.4.5. Mësuesi shfrytëzon mundësinë e portofoleve digjitale për të mbështetur një qasje të vlerësimit alternativ, duke lejuar nxënësit të tregojnë aftësitë dhe përparimin në mënyra krijuese dhe të ndryshme.	Nuk përdor portofolet për të mbështetur vlerësimin alternativ, duke mbetur thellësisht te vlerësimi tradicional dhe duke kufizuar shprehjen e nxënësve.	Përdor portofolet për vlerësim alternativ, por mund të mos e shfrytëzojë plotësisht mundësinë e tyre për të vlerësuar tërësinë e plotë të aftësive (p.sh., vetëm projekte, jo aftësi krijuese) ose krijimtarinë e nxënësve.	Përdor portofolet për të mbështetur një qasje të vlerësimit alternativ, duke i dhënë nxënësve mundësinë të tregojnë aftësitë dhe përparimin e tyre në mënyra të ndryshme dhe krijuese (p.sh., projekte multimediale, krijime digjitale,	Zhvillon dhe zbaton një qasje të përparuar dhe transformuese të vlerësimit të bazuar në portofol, duke e kthyer atë në një platformë gjithëpërfshirëse për nxënësit për të treguar aftësi të ndërlydhura, kompetenca të shekullit 21 (p.sh. bashkëpunimi, komunikimi) dhe pasionet e tyre, duke kapërcyer kufijtë e vlerësimit tradicional.



				simulime, shfaqje talenti).	
	4.4.6. Mësuesi përdor portofolet digjitale si një mjet transparent dhe bashkëpunues për të ndarë ecurinë e nxënësve me prindërit dhe palët e tjera të interesuara.	Nuk përdor portofolet për të ndarë progresin e nxënësve me prindërit ose palët e tjera, ose informacioni i ndarë nuk është transparent ose i qartë.	Përdor portofolet për të ndarë përparimin, por komunikimi mund të jetë i kufizuar, jo plotësisht transparent, ose pa nxitur dialog aktiv dhe bashkëpunues me prindërit për të mbështetur nxënësin.	Përdor portofolet digjitale si një mjet transparent për të ndarë progresin e nxënësve me prindërit dhe palët e tjera të interesuara, duke mundësuar qasje dhe diskutime periodike rreth zhvillimit të tyre dhe hapave të ardhshëm.	Krijon një partneritet aktiv dhe bashkëpunues me nxënësit, prindërit dhe komunitetin dhe përdor portofolet digjitale për të treguar përparimin tërësor të nxënësve, për të nxitur dialogun e dobishëm dhe për të ndërtuar një përgjegjësi të përbashkët për suksesin e çdo nxënësi.



Nivelet e vlerësimit të fushës 5: Fuqizimi i nxënësve

Treguesit	Përshkruesit	Nivelet e vlerësimit			
		Fillestar (1)	Zhvillues (2)	Kompetent (3)	Ekspert (4)
5.1.Mësuesi përdor teknologjinë për të fuqizuar aftësitë e nxënësve për të komunikuar dhe bashkëpunuar.	5.1.1. Mësuesi përdor platforma digjitale që mundësojnë komunikimin në kohë reale dhe punën në grup, siç janë forume dhe biseda online.	Nuk përdor platforma digjitale për komunikim në kohë reale ose punë në grup, ose përdorimi është i kufizuar dhe jo efektiv.	Përdor ndonjëherë platforma digjitale bazike për komunikim, por me vështirësi në menaxhimin e bisedave online ose forumet, duke kufizuar bashkëpunimin.	Përdor në mënyrë efektive platforma digjitale (p.sh., Google Meet, Teams, platforma LMS) që mundësojnë komunikimin në kohë reale dhe punën në grup, duke ndihmuar nxënësit të ndërveprojnë.	Përmirëson përdorimin e platformave digjitale për komunikim dhe bashkëpunim, duke integruar mjete të avancuara (p.sh., dhoma ndarjeje, tabela interaktive) dhe duke mentoruar kolegët për t'i përdorur efektivisht.
	5.1.2. Mësuesi nxit nxënësit të përdorin mjetet	Nuk nxit ose nxit shumë rrallë nxënësit të përdorin mjete	Nxit ndonjëherë nxënësit të përdorin mjete digjitale, por	Nxit në mënyrë aktive nxënësit të përdorin mjete	Krijon mundësi të shumta dhe të reja për nxënësit që të



	digjitale për të ndarë ide, krijuar projekte të përbashkëta dhe për të bashkëpunuar në mënyrë efektive.	digjitale për ndarje idesh apo projekte bashkëpunuese.	nxënësit shpesh kanë vështirësi në bashkëpunim ose mjetet nuk shfrytëzohen plotësisht.	digjitale (p.sh., Google Docs, Miro, Padlet) për të ndarë ide, krijuar projekte të përbashkëta dhe bashkëpunuar në mënyrë efektive.	bashkëpunojnë duke përdorur mjete digjitale. Ai/ajo nxit ndërtimin e komuniteteve të nxënësve dhe zhvillimin e aftësive të ndërlikuara bashkëpunuese digjitale.
	5.1.3. Mësuesi siguron mundësi për nxënësit të komunikojnë me mësuesit dhe njëri-tjetrin përmes mjeteve digjitale në mënyrë të sigurt	Nuk siguron mundësi komunikimi digjital për nxënësit, ose nuk merr masa për sigurinë dhe kontrollin e komunikimit.	Siguron mundësi komunikimi digjital, por nuk i menaxhon gjithmonë në mënyrë efektive aspektet e sigurisë dhe kontrollit, duke lënë hapësira për probleme.	Siguron mundësi të qarta dhe të sigurt për nxënësit të komunikojnë me mësuesit dhe njëri-tjetrin përmes mjeteve digjitale, duke vendosur rregulla	Zhvillon dhe zbaton protokolle të përparuara të sigurisë dhe etiketës digjitale, duke i fuqizuar nxënësit të bëhen përdorues të përgjegjshëm dhe të pavarur të mjeteve të komunikimit



	dhe të kontrolluar.			të qarta dhe duke monitoruar veprimtarinë.	digjital, dhe duke edukuar kolegët për praktikën më të mirë.
	5.1.4. Mësuesi organizon veprimtari bashkëpunimi që nxënësin përdorimin e teknologjisë për të zhvilluar ide të reja dhe për të zgjidhur probleme në grup.	Nuk organizon veprimtari bashkëpunimi me teknologji, ose ato janë shumë bazike dhe nuk nxënësin zhvillimin e ideve të reja apo zgjidhjen e problemeve.	Organizon ndonjëherë veprimtari bashkëpunimi me teknologji, por ato mund të jenë të kufizuara në nxitjen e ideve të reja ose zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara në grup.	Organizon rregullisht veprimtari bashkëpunimi që nxënësin përdorimin e teknologjisë për të zhvilluar ide të reja dhe për të zgjidhur probleme në grup, duke zgjedhur mjete dhe platforma të përshtatshme.	Krijon dhe udhëheq projekte të ndërlikuara bashkëpunuese me teknologji, ku nxënësit zhvillojnë ide origjinale dhe zgjidhin probleme të vërteta. Ai/ajo ndihmon kolegët të zhvillojnë veprimtari të ngjashme.
5.2.Mësuesi nxit nxënësit të zhvillojnë	5.2.1. Mësuesi integron mjete dhe aplikacione për	Nuk integron mjete ose aplikacione për krijimin e materialeve	Integron disa mjete bazike për krijimin e materialeve digjitale,	Integron në mënyrë efektive mjete dhe	Krijon mjedise mësimore të reja ku nxënësit hulumtojnë



aftësitë e tyre digjitale për të krijuar, menaxhuar dhe shpërndarë përmbajtje digjitale.	krijimin e materialeve digjitale (video, blogje, prezantime multimediale, infografika, etj.) në funksion të rezultateve të të nxënit.	digjitale nga nxënësit, ose krijimi i tyre është i kufizuar dhe i palidhur me rezultatet e të nxënit. Nxënësit nuk kanë mundësi të shpërndajnë punën e tyre.	por mundësitë për nxënësit janë të kufizuara në diversitetin e përmbajtjes dhe platformat e shpërndarjes, ose lidhja me rezultatet e nxënit është e dobët.	aplikacione të ndryshme për krijimin e materialeve digjitale (video, blogje, prezantime) në funksion të rezultateve të të nxënit, duke mundësuar që nxënësit të krijojnë dhe shpërndajnë përmbajtje digjitale në platforma të ndryshme (LMS, galeri online).	dhe përdorin një tërësi të gjerë mjetesh dhe platformash për të krijuar përmbajtje digjitale të ndërlikuar, duke shfaqur zotërimin e rezultateve të të nxënit dhe duke udhëhequr bashkëmoshatarët në procesin e krijimit dhe shpërndarjes.
--	--	---	---	---	---



	5.2.2. Mësuesi siguron mundësi për nxënësit të krijojnë dhe të shpërndajnë përmbajtje digjitale që lidhen me lëndën e përkatëse, duke përdorur platforma të ndryshme (LMS, blogje, galeri online etj.).	Nuk siguron mundësi për nxënësit që të krijojnë dhe shpërndajnë përmbajtje digjitale, ose platformat e përdorura janë shumë të kufizuara dhe jo efektive.	Siguron ndonjëherë mundësi për nxënësit të krijojnë dhe shpërndajnë përmbajtje, por diversiteti i platformave është i kufizuar ose nxënësit hasin vështirësi në procesin e shpërndarjes.	Siguron në mënyrë të rregullt mundësi për nxënësit të krijojnë dhe të shpërndajnë përmbajtje digjitale të lidhura me lëndën, duke përdorur platforma të ndryshme (p.sh., LMS, blogje klase, galeri online).	Krijon një kulturë shpërndarjeje ku nxënësit janë të fuqizuar të krijojnë dhe shpërndajnë përmbajtje origjinale në platforma të shumta, duke mentoruar shokët dhe duke shërbyer si model në përdorimin etik dhe efektiv të mjeteve të shpërndarjes.
	5.2.3. Mësuesi ndihmon nxënësit të organizojnë dhe menaxhojnë efektivisht	Nuk ndihmon nxënësit në organizimin dhe menaxhimin e përmbajtjes digjitale,	Ndihmon ndonjëherë nxënësit të organizojnë përmbajtjen, por strategjitë ose mjetet e	Ndihmon nxënësit të organizojnë dhe menaxhojnë në mënyrë efektive përmbajtjen	Udhëzon nxënësit në zhvillimin e sistemeve personale të menaxhimit të përmbajtjes



	përmbajtjen digjitale që ata krijojnë, duke përdorur mjete dhe strategji për ruajtjen, renditjen dhe përdorimin e informacionit.	duke rezultuar në humbje ose vështirësi në aksesimin e punës së tyre.	përdorura mund të jenë të kufizuara, duke sjellë vështirësi në menaxhimin afatgjatë të informacionit.	digjitale (p.sh., përdorimi i dosjeve në cloud, strategjitë e emërimit të skedarëve), duke përdorur mjete dhe strategji për ruajtjen, renditjen dhe përdorimin e informacionit.	digjitale, duke i pajisur ata me aftësi të avancuara organizimi (p.sh., metadata – të dhëna përshkruese, tagim - shenjim, skema të aksesit, qasjes), të cilat i përgatisin për botën digjitale.
	5.2.4. Mësuesi planifikon veprimtari që lejojnë nxënësit të ndajnë punën e tyre me audienca të ndryshme (bashkëmoshatarë prindër,	Nuk planifikon veprimtari për ndarjen e punës së nxënësve me audienca të ndryshme, ose ndarja është shumë e kufizuar dhe pa mundësi feedback-u.	Planifikon ndonjëherë veprimtari për ndarjen e punës, por audiencat janë të kufizuara (p.sh., vetëm klasa) dhe mundësitë për ndërveprim dhe feedback janë të	Planifikon në mënyrë të rregullt veprimtari që lejojnë nxënësit të ndajnë punën e tyre me audienca të ndryshme (prezantime, postime në blogun	Krijon mundësi të shumta dhe autentike për nxënësit që të ndajnë punën e tyre me audienca reale dhe të ndryshme (p.sh., gara kombëtare,



	komuniteti), duke nxitur ndërveprimin dhe marrjen e feedback-ut.		dobëta ose të paorganizuar.	e shkollës), duke nxitur ndërveprimin dhe marrjen e feedback-ut.	bashkëpunime me komunitetin). Ai/ajo lehtëson procese dinamike feedback-u dhe ndërtimin e portofoleve digjitale të nxënësve.
	5.2.5. Mësuesi vlerëson cilësinë dhe krijimtarinë në përmbajtjen digjitale të nxënësve si një mënyrë për të treguar kuptimin e lëndës dhe zotërimitin e aftësive digjitale.	Nuk vlerëson cilësinë dhe krijimtarinë në përmbajtjen digjitale të nxënësve, ose përqendrohet vetëm në përmbajtjen lëndore pa marrë parasysh aftësitë digjitale.	Vlerëson cilësinë dhe krijimtarinë, por mund të ketë vështirësi në integrimin e vlerësimit të aftësive digjitale me të kuptuarit e lëndës, ose kriteret janë të paqarta.	Vlerëson në mënyrë të vazhdueshme cilësinë dhe krijimtarinë në përmbajtjen digjitale të nxënësve, duke e përdorur këtë si një mënyrë për të shfaqur të kuptuarit e lëndës	Zhvillon rubrika vlerësimi të përparuara që integrojnë thellësisht cilësinë e përmbajtjes, krijimtarinë dhe aftësitë digjitale, duke ndihmuar nxënësit të reflektojnë mbi procesin e krijimit



				dhe zotërimin e aftësive digjitale.	dhe zotërimin e kompetencave.
	5.2.6. Mësuesi udhëzon nxënësit si të përdorin mjete të Inteligjencës Artificiale (IA) (p.sh., gjeneratorë teksti, imazhi, apo prezantimesh) për të ndihmuar në procesin e krijimit të përmbajtjes digjitale, duke theksuar përgjegjësinë për verifikimin dhe përshtatjen e	Nuk udhëzon nxënësit për përdorimin e mjeteve të Inteligjencës Artificiale (IA) ose nuk adreson aspektet e përgjegjësisë dhe verifikimit të output-it të IA-së.	Udhëzon ndonjëherë nxënësit për përdorimin e mjeteve bazike të IA-së, por mund të mos theksojë mjaftueshëm rëndësinë e verifikimit dhe përshtatjes, ose të mos trajtojë sfidat etike.	Udhëzon në mënyrë efektive nxënësit si të përdorin mjete të Inteligjencës Artificiale (IA) (p.sh., ChatGPT, Canva IA) për të ndihmuar në procesin e krijimit të përmbajtjes digjitale, duke theksuar qartë përgjegjësinë për verifikimin dhe përshtatjen e output-it (produktit –	Integron IA-në si një mjet strategjik në procesin e krijimit të përmbajtjes, duke edukuar nxënësit mbi përdorimin etik, kritik dhe të përparuara të IA-së, si dhe zhvillon udhëzues dhe praktika më të mira për përdorimin përgjegjës të IA-së, duke ndarë këto njohuri me kolegët.



	rezultatit të IA-së.			rezultatit) të IA-së.	
5.3.Mësuesi nxit nxënësit për të krijuar përmbajtje digjitale origjinale, të sigurt dhe etike.	5.3.1. Mësuesi udhëzon nxënësit për rëndësinë e origjinalitetit, shmangien e plagjiaturës dhe respektimin e etikës digjitale dhe të drejtave të autorit gjatë krijimit dhe ndarjes së përmbajtjes.	Nuk udhëzon nxënësit për origjinalitetin, plagjiaturën, etikën digjitale ose të drejtat e autorit, ose i trajton këto tema shumë rrallë dhe në mënyrë sipërfaqësore.	Udhëzon ndonjëherë nxënësit për këto aspekte, por mund të mos theksojë mjaftueshëm rëndësinë e tyre ose të mos sigurojë udhëzime të qarta për zbatimin praktik, duke lënë vend për paqartësi.	Udhëzon në mënyrë efektive dhe të rregullt nxënësit për rëndësinë e origjinalitetit, shmangien e plagjiaturës dhe respektimin e etikës digjitale dhe të drejtave të autorit, duke ofruar shembuj praktikë dhe burime shtesë.	Integron thellësisht mësimin mbi origjinalitetin, etikën digjitale dhe të drejtat e autorit në kurrikulë, duke nxitur nxënësit të bëhen udhëheqës dhe mbështetës të praktikave digjitale të përgjegjshme dhe etike, duke ndarë praktikat më të mira me kolegët.
	5.3.2. Mësuesi nxit nxënësit të jenë të kujdesshëm në	Nuk nxit nxënësit për kujdesin me informacionin	Nxit ndonjëherë nxënësit për kujdes me informacionin	Nxit në mënyrë të rregullt nxënësit të jenë të	Zhvillon strategji parashikuese për ndërgjegjësimin e



	shpërndarjen e informacionit vetjak në internet dhe të përdorin mjete të sigurta për komunikim.	personal online ose nuk udhëzon për përdorimin e mjeteve të sigurta të komunikimit, duke i lënë nxënësit të ekspozuar ndaj rreziqeve.	personal, por udhëzimi mund të jetë i kufizuar ose jo sistematik, dhe theksimi i mjeteve të sigurta të komunikimit është i dobët.	kujdesshëm në shpërndarjen e informacionit personal në internet dhe i udhëzon për përdorimin e mjeteve të sigurta për komunikim, duke ofruar këshilla praktike.	nxënësve mbi privatësinë dhe sigurinë online, duke i fuqizuar ata të marrin vendime të informuara dhe të përgjegjshme për praninë e tyre digjitale dhe të përdorin mjete të përparuara të sigurisë.
	5.3.3. Mësuesi zhvillon veprimtari që nxisin ndërgjegjësimin për sigurinë online, siç janë trajnimet mbi ndihmën për të	Nuk zhvillon veprimtari për sigurinë online ose ndërgjegjësimin për bullizmin kibernetik, duke e lënë këtë përgjegjësi vetëm tek nxënësit ose prindërit.	Zhvillon ndonjëherë veprimtari bazike për sigurinë online, por mund të mos trajtojë thellësisht identifikimin e rreziqeve ose strategjitë efektive për	Zhvillon në mënyrë të rregullt dhe efektive veprimtari që nxisin ndërgjegjësimin për sigurinë online, duke	Udhëheq nismat për sigurinë online dhe luftën kundër bullizmit kibernetik në nivel shkolle ose komuniteti, duke krijuar burime dhe programe të



	identifikuar rreziqe dhe për të shmangur bullizmin kibernetik.		shmangien/adresimin e bullizmit kibernetik.	përfshirë trajnime për identifikimin e rreziqeve (p.sh., phishing ¹³ , mashtrimet) dhe strategji konkrete për shmangien e bullizmit kibernetik.	specializuara dhe duke mentoruar kolegët për t'u bërë burime ndihmëse për nxënësit.
	5.3.4. Mësuesi përfshin nxënësit në diskutime mbi rregullat dhe përgjegjësitë e përdorimit të teknologjisë dhe internetit në mënyrë të etike.	Nuk përfshin nxënësit në diskutime mbi rregullat ose përgjegjësitë etike të përdorimit të teknologjisë/internetit, ose diskutimet janë shumë të rralla dhe të detyruara.	Përfshin ndonjëherë nxënësit në diskutime, por ato mund të jenë të kufizuara ose të mos nxisin një angazhim të thellë për rregullat dhe përgjegjësitë etike.	Përfshin në mënyrë aktive nxënësit në diskutime të hapura dhe të dobishme mbi rregullat dhe përgjegjësitë e përdorimit të	Lehtëson diskutime të thella dhe kritike mbi mëdyshjet etike në botën digjitale, duke i fuqizuar nxënësit të zhvillojnë kodin e tyre të sjelljes digjitale dhe të

¹³ Phishing (fishing) - mashtrim digjital për marrjen e të dhënave personale.



				teknologjisë dhe internetit në mënyrë etike, duke nxitur reflektimin.	bëhen përkrahës të përdorimit etik dhe përgjegjës të teknologjisë në shkollë dhe komunitet.
5.4.Mësuesi përdor teknologjinë për të krijuar mjedise mësimore gjithëpërfshirëse dhe të arritshme.	5.4.1. Mësuesi përdor mjete për të përkthyer dhe përshtatur materialet mësimore për nxënësit me nevoja të veçanta.	Nuk përdor mjete për përkthimin ose përshtatjen e materialeve për nxënësit me nevoja të veçanta ose ata që nuk flasin shqip, duke lënë pjesë të nxënësve të përjashtuar nga materialet.	Përdor ndonjëherë mjete bazike për përkthimin/përshtatjen e materialeve, por cilësia ose thellësia e përshtatjes mund të mos jetë e mjaftueshme për të adresuar të gjitha nevojat e nxënësve të ndryshëm.	Përdor në mënyrë efektive mjete dhe teknologji (p.sh., titra, lexues ekrani, përkthyes online) për të përkthyer dhe përshtatur materialet mësimore për nxënësit me nevoja të veçanta dhe ata që nuk flasin shqip, duke	Harton dhe zbaton strategji të përparuara për përdorimin e materialeve, duke gjetur zgjidhje të reja (p.sh., përmbajtje ndërvepruese të përshtatshme, video me përshkrime audio) për të përmbushur nevojat specifike të të gjithë



				i bërë materialet lehtësisht të kuptueshme.	nxënësve, dhe udhëzon kolegët në këto praktika.
	5.4.2. Mësuesi përdor teknologji të përshtatshme që mundësojnë qasje për nxënësit me vështirësi në shikim, dëgjim ose aftësi motorike.	Nuk përdor teknologji që mundësojnë qasje për nxënësit me vështirësi, ose teknologjia e përdorur është joefektive ose jo e pranishme, duke krijuar pengesa për disa nxënës.	Përdor ndonjëherë teknologji bazike ndihmëse, por mund të mos jetë plotësisht i njohur me të gjitha mundësitë ose nuk siguron përdorim efektiv për të gjithë nxënësit me vështirësi.	Përdor në mënyrë efektive teknologji të përshtatshme (p.sh., softuer zmadhues, tastierë të modifikuar, platforma me mundësi përdorimi) që krijojnë qasje të plotë për nxënësit me vështirësi në shikim, dëgjim ose aftësi motorike.	Integron dhe përmirëson teknologjitë ndihmëse në mjedisin mësimor, duke përshtatur dhe zhvilluar zgjidhje të personalizuar për nxënësit me nevoja të veçanta. Shërben si ekspert dhe burim për teknologjinë ndihmëse.



	5.4.3. Mësuesi krijon mundësi për nxënësit që kanë aftësi të veçanta të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësim, duke ofruar mundësi për mësim të personalizuar.	Nuk krijon mundësi specifike për nxënësit me aftësi të veçanta për të marrë pjesë aktive, ose mësimi nuk është i personalizuar për nevojat e tyre.	Krijon ndonjëherë mundësi për përfshirje, por ato mund të mos jenë gjithmonë të mjaftueshme ose të personalizuara për të siguruar pjesëmarrje aktive dhe kuptimplotë të të gjithë nxënësve me aftësi të veçanta.	Krijon në mënyrë të rregullt mundësi që nxënësit me aftësi të veçanta të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësim, duke ofruar mësim të personalizuar (p.sh., detyra të diferencuara, ritme individuale) me anë të teknologjisë.	Harton dhe zbaton plane mësimore shumë të personalizuara dhe përdor teknologjinë për të rritur pjesëmarrjen aktive dhe suksesin e nxënësve me aftësi të veçanta, duke ndërtuar një mjedis mësimor gjithëpërfshirës, si dhe shpërndan strategjitë me kolegët.
	5.4.4. Mësuesi përdor teknologji që mundësojnë përkthimin e	Nuk përdor teknologji për të përkthyer materiale mësimore për nxënësit që nuk	Përdor ndonjëherë mjete bazike për përkthimin e materialeve (p.sh.,	Përdor në mënyrë efektive teknologji që mundësojnë	Harton dhe zbaton strategji gjithëpërfshirëse për mbështetjen



	materialeve mësimore në gjuhë të tjera për nxënësit që nuk flasin shqipen si gjuhë të parë.	flasin shqipen, duke lënë këta nxënës të izoluar nga përmbajtja e mësimi.	Google Translate për tekste të shkurtra), por mundësitë janë të kufizuara ose cilësia e përkthimit nuk është gjithmonë optimale, duke vështirësuar kuptimin e thellë.	përkthimin e materialeve mësimore (p.sh., softuerë përkthimi me cilësi të lartë, opsione të titrimit) për nxënësit që nuk flasin shqipen si gjuhë të parë, duke siguruar qasje të mirë në informacion.	gjuhësore me teknologji, duke përdorur mjete të përparuara të përkthimit dhe përshtatjes kulturore dhe udhëzon kolegët për t'i bërë materialet mësimore të arritshme për nxënësit me diversitet gjuhësor.
5.5.Mësuesi nxit zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve tek	5.5.1. Mësuesi udhëzon nxënësit të përdorin mjete digjitale për të kërkuar, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike	Nuk udhëzon nxënësit për vlerësimin kritik të informacionit digjital ose të atij të gjeneruar nga IA; nxënësit shpesh	Udhëzon ndonjëherë nxënësit për të vlerësuar burimet digjitale, por fokusi është bazik dhe mund të mos përfshijë burimet e gjeneruara	Udhëzon në mënyrë efektive nxënësit si të kërkojnë, analizojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike	Harton dhe zbaton aktivitete komplekse që fuqizojnë nxënësit të bëhen vlerësues kritikë të përparuar të informacionit



nxënësit përmes përdorimit të mjeteve digjitale.	informacionin nga burime të shumta online, përfshirë ato të gjeneruara nga IA, duke identifikuar besueshmërinë dhe paragjykimet.	përdorin informacion pa verifikim.	nga IA ose identifikimin e paragjykimeve.	informacionin nga burime të shumta online, përfshirë ato të gjeneruara nga IA, duke theksuar besueshmërinë dhe paragjykimet.	digjital, duke përfshirë analizën e thellë të IA-së dhe ndikimin e saj, dhe duke udhëzuar kolegët.
	5.5.2. Mësuesi nxit nxënësit të përdorin simulime digjitale, programe modelimi ose mjete vizualizimi për të eksploruar	Nuk nxit përdorimin e simulimeve digjitale, programeve të modelimit ose mjeteve të vizualizimit, ose përdorimi i tyre është shumë i rrallë dhe joefektiv për	Nxit ndonjëherë nxënësit të përdorin simulime ose mjete vizualizimi, por eksplorimi i skenarëve ose zhvillimi i zgjidhjeve të reja nuk janë gjithmonë pjesë	Nxit në mënyrë të rregullt nxënësit të përdorin simulime digjitale, programe modelimi ose mjete vizualizimi për të hulumtuar	Harton dhe integron mjete të përparuara digjitale (p.sh., VR/AR ¹⁴ për simulime) për të sfiduar nxënësit të adresojnë probleme të ndërlikuara, duke nxitur

¹⁴ VR/AR (Realitet Virtual dhe Realitet i Shtuar) ose teknologjitë zhytëse dhe të pasuruara me elementë digjitalë.



	skenarë, testuar hipoteza dhe zhvilluar zgjidhje të reja për problemet.	zhvillimin e zgjidhjes së problemeve.	integrale e veprimtarive.	skenarë, për të testuar hipoteza dhe për të zhvilluar zgjidhje të reja për problemet.	eksperimentimin, risi origjinale dhe zgjidhjen e problemeve në botën reale.
	5.5.3. Mësuesi zhvillon veprimtari që kërkojnë nga nxënësit të argumentojnë, vlerësojnë dhe reflektojnë në mënyrë kritike mbi informacionin dhe zgjidhjet e gjetura përmes burimeve digjitale.	Nuk zhvillon veprimtari që kërkojnë argumentim, vlerësim kritik ose reflektim mbi informacionin digjital ose zgjidhjet.	Zhvillon ndonjëherë veprimtari që përfshijnë argumentim ose vlerësim, por shpesh mungon thellësia e reflektimit kritik mbi procesin e gjetjes së zgjidhjeve digjitale.	Zhvillon në mënyrë të rregullt veprimtari që kërkojnë nga nxënësit të argumentojnë, vlerësojnë dhe reflektojnë në mënyrë kritike mbi informacionin dhe zgjidhjet e gjetura përmes burimeve digjitale, duke	Krijon mjedise mësimore që nxisin debat kritik dhe reflektim të thellë, duke përdorur portofole digjitale ose blogje reflektimi, ku nxënësit analizojnë në mënyrë kritike proceset e tyre të menduarit dhe zgjidhjes së problemeve.



				nxitur të menduarit vetënjohës.	
	5.5.4. Mësuesi udhëzon nxënësit të përdorin mjete digjitale për të mbledhur dhe analizuar të dhëna, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të informuara dhe të bazuar në fakte.	Nuk udhëzon nxënësit për përdorimin e mjeteve digjitale për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, ose përqendrohet vetëm në dhëna të gatshme, pa nxitur marrjen e vendimeve të informuara.	Udhëzon ndonjëherë nxënësit të mbledhin dhe analizojnë të dhëna digjitale, por procesi mund të jetë i kufizuar ose nuk lidhet gjithmonë me marrjen e vendimeve të informuara.	Udhëzon në mënyrë efektive nxënësit të përdorin mjete digjitale (p.sh., fletëllogaritëse, platforma sondazhesh) për të mbledhur dhe analizuar të dhëna, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të informuara dhe të bazuar në fakte.	Ndërthur analiza të përparuara të të dhënave (p.sh., vizualizime të ndërlikuara, baza të dhënash) në kurrikul, duke i fuqizuar nxënësit të bëjnë hulumtime origjinale dhe të zbatojnë analizat e të dhënave për të zgjidhur probleme e vështira të botës reale.
	5.5.5. Mësuesi nxit nxënësit të	Nuk nxit reflektimin e nxënësve mbi	Nxit herë pas here nxënësit të reflektojnë	Nxit në mënyrë të rregullt nxënësit	Krijon një kulturë të reflektimit të thellë



	reflektojnë mbi procesin e tyre të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve gjatë punës me mjete digjitale, duke identifikuar strategjitë e suksesshme dhe fushat për përmirësim.	procesin e tyre të të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve me mjete digjitale, ose ky reflektim është i rastësishëm dhe joefektiv.	mbi procesin e tyre, por mund të mos theksojë identifikimin e strategjive specifike të suksesshme ose fushat konkrete për përmirësim.	të reflektojnë mbi procesin e tyre të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve gjatë përdorimit të mjeteve digjitale, duke i ndihmuar ata të identifikojnë strategjitë efektive dhe fushat për përmirësim.	dhe vetëvlerësimit, duke përdorur mjete digjitale për portofole reflektimi ose ditarë digjitalë, ku nxënësit analizojnë në mënyrë kritike proceset e tyre të mendimit dhe zgjidhjes së problemeve, duke udhëzuar edhe të shokët.
	5.5.6. Mësuesi angazhon nxënësit në aktivitete ku ata vlerësojnë në mënyrë kritike	Nuk i angazhon nxënësit në vlerësimin kritik të informacionit ose zgjidhjeve të gjeneruara nga IA, ose i pranon ato pa	Angazhon herë pas here nxënësit në diskutime bazike rreth informacionit të gjeneruar nga IA, por mund të mos theksojë	Angazhon në mënyrë të rregullt nxënësit në aktivitete ku ata vlerësojnë në mënyrë kritike	Zhvillon veprimtari të avancuara, ku nxënësit analizojnë nw mwnyrw tw thelluar implikimet, etikën dhe



	informacionin dhe zgjidhjet e gjeneruara nga sistemet e Inteligjencës Artificiale (IA), duke dalluar saktësinë, paragjykimet dhe kufizimet e tyre.	diskutuar saktësinë, paragjykimet apo kufizimet.	thellësisht saktësinë, identifikimin e paragjykimeve ose kufizimet e këtyre sistemeve.	informacionin dhe zgjidhjet e gjeneruara nga sistemet e IA-së, duke i ndihmuar ata të dallojnë saktësinë, paragjykimet dhe kufizimet e tyre.	funksionimin e sistemeve të IA, duke zhvilluar aftësi për të punuar me IA si një mjet kritik dhe të përgjegjshëm dhe duke mentoruar kolegët.
	5.5.7. Mësuesi nxit nxënësit të përdorin IA-në si një mjet për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, duke formuluar pyetje efektive, duke kërkuar ide dhe	Nuk nxit nxënësit të përdorin IA-në si mjet për zgjidhjen e problemeve, ose e shmang përdorimin e saj.	Nxit herë pas here nxënësit të provojnë IA-në për zgjidhjen e problemeve, por nuk thekson formulimin e pyetjeve efektive, kërkimin e ideve origjinale ose sintezën e informacionit kompleks.	Nxit rregullisht nxënësit të përdorin IA-në si mjet për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, duke i udhëzuar ata të formulojnë pyetje efektive, të	Është një udhëheqës në integrimin e IA-së si mjet për zgjidhjen e problemeve, duke hartuar projekte të vështira ku nxënësit përdorin IA-në për kërkime të thelluara gjenerim të ideve të



	duke përmbledhur informacione të ndërlikuara për të arritur në zgjidhje të reja.			kërkojnë ide dhe të përmbledhin informacione të ndërlikuara për të arritur në zgjidhje të reja.	reja dhe sintezë thelbësore të të dhënave, duke shfaqur përdorim etik dhe të ri të teknologjisë.
--	--	--	--	---	--



Nivelet e vlerësimit të fushës 6: Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve

Treguesit	Përshkruesit	Nivelet e vlerësimit			
		Fillestar (1)	Zhvillues (2)	Kompetent (3)	Ekspert (4)
6.1.Nxënësit kërkojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin digjital.	6.1.1. Nxënësit përdorin strategji efektive kërkimi (fjalë kyçe të sakta, operatorë logjikë, filtra) për të gjetur informacion specifik dhe të përshtatshëm nga burime të shumta digjitale.	Nxënësit përdorin vetëm fjalë kyçe të përgjithshme dhe nuk shfrytëzojnë operatorë logjikë ose filtra, duke gjetur informacion të kufizuar dhe shpesh jo të duhurin.	Nxënësit përdorin fjalë kyçe bazike dhe ndonjëherë filtra të thjeshtë, por mund të kenë vështirësi në gjetjen e informacionit specifik dhe mund t'u duhet mbështetje.	Nxënësit përdorin në mënyrë efektive fjalë kyçe të sakta, operatorë logjikë dhe filtra bazikë për të gjetur informacion specifik dhe të duhur nga burime të shumta digjitale.	Nxënësit hartojnë dhe zbatojnë strategji të avancuara kërkimi, duke hulumtuar burime dhe metoda të reja (p.sh., kërkim brenda faqeve specifike, kërkim imazhesh), dhe mund të udhëzojnë shokët.



	6.1.2. Nxënësit analizojnë besueshmërinë dhe autoritetin e burimeve digjitale (përfshirë datën e publikimit dhe autorësinë) për të vlerësuar cilësinë e informacionit.	Nxënësit nuk analizojnë besueshmërinë e burimeve digjitale ose i pranojnë ato si të vërteta pa shqyrtim kritik. Nuk i kushtojnë rëndësi datës apo autorit.	Nxënësit përpiqen të analizojnë besueshmërinë, por u mungojnë kriteret e qarta ose vlerësimi është sipërfaqësor. Mund t'u duhet ndihmë për të kuptuar rëndësinë e datës dhe autorit.	Nxënësit analizojnë në mënyrë kritike besueshmërinë dhe autoritetin e burimeve digjitale, duke marrë parasysh datën e publikimit, autorësinë dhe burimet e tyre.	Nxënësit demonstrojnë ekspertizë në vlerësimin e burimeve, duke identifikuar nuancat e autoritetit dhe besueshmërisë (p.sh., paragjykimet e mundshme, qëllimin e faqes), dhe shërbejnë si model.
	6.1.3. Nxënësit dallojnë mes fakteve, opinionëve dhe informacioneve të rreme, si dhe	Nxënësit nuk dallojnë lehtësisht mes fakteve dhe opinionëve, ose bien pre e informacioneve të rreme	Nxënësit përpiqen të dallojnë faktet nga opinionet, por kanë vështirësi në identifikimin e	Nxënësit dallojnë në mënyrë efektive mes fakteve, opinionëve dhe	Nxënësit bëjnë analiza të thella të informacioneve të rreme dhe



	vlerësojnë paanësinë dhe saktësinë e atyre që kanë gjetur online.	pa e kuptuar burimin apo qëllimin.	informacioneve të rreme ose vlerësimin e paanësisë së informacionit.	informacioneve të rreme, duke vlerësuar paanësinë dhe saktësinë e informacionit të gjetur.	paragjyqimeve, duke kuptuar taktikat e mashtrimit, dhe mund të informojnë të tjerët rreth tyre.
	5.5.8. Nxënësit shfrytëzojnë burimet dhe mjetet e ndryshme (përfshirë IA-në) për të shqyrtuar informacionin nga më shumë se një burim dhe për të siguruar saktësinë e tij.	Nxënësit nuk verifikojnë informacionin ose bazohen në një burim të vetëm pa kontroll. Nuk dinë si të përdorin IA-në për këtë.	Nxënësit përpiqen të verifikojnë, por nuk përdorin mjete të shumta ose nuk dinë si të shfrytëzojnë IA-në në mënyrë efektive për verifikim, duke e lënë procesin jo të plotë.	Nxënësit përdorin në mënyrë efektive burime dhe mjete të ndryshme (përfshirë veçori bazike të IA-së) për të verifikuar informacionin nga burime të shumta dhe për	Nxënësit integrojnë metoda të avancuara verifikimi, duke përdorur IA-në strategjikisht për vetëkontroll dhe duke zhvilluar udhëzues ose praktika më të mira për



				të siguruar saktësinë.	verifikimin digjital.
6.2.Nxënësit krijojnë përmbajtje digjitale origjinale, të përshtatshme, etike dhe të sigurt.	6.2.1. Nxënësit përdorin mjete digjitale për të krijuar materiale të ndryshme (prezantime, video, audio, infografika, blogje) në funksion të rezultateve të të nxënit.	Nxënësit nuk krijojnë përmbajtje digjitale, ose krijojnë materiale shumë të thjeshta dhe joorigjinale pa lidhje të qartë me objektivat mësimore.	Nxënësit krijojnë disa lloje të përmbajtjes digjitale, por cilësia ose larmia e formateve është i kufizuar, dhe lidhja me rezultatet e të nxënit jo gjithmonë është e fortë.	Nxënësit përdorin në mënyrë efektive mjete digjitale për të krijuar materiale të ndryshme, duke siguruar origjinalitetin dhe cilësinë e përmbajtjes në funksion të rezultateve të të nxënit.	Nxënësit shfaqin krijimtari dhe risi në krijimin e përmbajtjes, duke hulumtuar formate të reja dhe duke shfrytëzuar mundësinë e plotë të mjeteve digjitale për të shprehur ide të ndërlikuara në mënyra të veçanta.
	6.2.2. Nxënësit zbatojnë parimet e origjinalitetit dhe	Nxënësit nuk respektojnë origjinalitetin, kryejnë plagjiaturë pa	Nxënësit përpiqen të respektojnë origjinalitetin, por kanë	Nxënësit zbatojnë në mënyrë	Nxënësit mbrojnë origjinalitetin



	shmangin plagjiaturën, duke respektuar të drejtat e autorit dhe duke cituar burimet siç duhet gjatë krijimit të përmbajtjes.	ndërgjegjësim, ose nuk citojnë burimet.	vështirësi në shmangien e plotë të plagjiaturës ose në citimin e duhur të burimeve në të gjitha rastet.	konsistente parimet e origjinalitetit, shmangin plagjiaturën dhe citojnë burimet saktë, duke treguar kuptim të drejtave të autorit.	dhe të drejtat e autorit, duke zhvilluar praktika të përparuara të citimit dhe ndajnë udhëzime ose këshilla me shokët dhe të tjerët.
	6.2.3. Nxënësit përdorin mjete të Inteligjencës Artificiale (IA) për të ndihmuar në procesin e krijimit të përmbajtjes digjitale, duke shqyrtuar dhe	Nxënësit nuk përdorin IA-në për krijim, ose e përdorin pa shqyrtuar produktin/rezultatit e saj, duke rrezikuar saktësinë ose origjinalitetin.	Nxënësit përdorin ndonjëherë mjete bazike të IA-së, por mund të mos e verifikojnë ose përshtatin produktin/rezultatit në mënyrë të thellë, ose nuk janë plotësisht të	Nxënësit përdorin në mënyrë efektive mjete të IA-së (p.sh., gjeneratorë teksti/imazhi) si ndihmë në krijimin e përmbajtjes,	Nxënësit integrojnë IA-në si një bashkëpunëtor afatgjatë për të krijuar përmbajtje digjitale komplekse dhe të reja, duke



	duke përshtatur në mënyrë kritike rezultatin (output) e IA-së.		ndërgjegjshëm për ndërlikimet etike.	duke theksuar përgjegjësinë për verifikimin, përshtatjen dhe sigurinë etike të produktit/rezultatit të IA-së.	shfaqur aftësi të larta në formulimin e udhëzimeve efektive për IA-në, vlerësimin kritik të produktit/rezultatit dhe duke udhëzuar shokët për përdorimin etik.
	6.2.4. Nxënësit shpërndajnë përmbajtjen digjitale në platforma të përshtatshme, duke marrë parasysh	Nxënësit nuk shpërndajnë përmbajtje, ose shpërndajnë në mënyrë të pakontrolluar, pa marrë parasysh audiencën, privatësinë ose sigurinë e të dhënave.	Nxënësit shpërndajnë ndonjëherë përmbajtje, por mund të mos zgjedhin platforma të përshtatshme, ose neglizhojnë disa aspekte të	Nxënësit shpërndajnë në mënyrë efektive përmbajtjen digjitale me audiencë të ndryshme përmes	Nxënësit hartojnë strategji të avancuara shpërndarjeje për të maksimizuar ndikimin e punës së tyre, duke zgjedhur kanalet



	audiencën e synuar dhe duke siguruar respektimin e çështjeve të privatësisë dhe sigurisë.		privatësisë/sigurisë (p.sh., lejet e ndarjes).	platformave të përshtatshme, duke respektuar të drejtat e autorit dhe çështjet e privatësisë (p.sh., licenca Creative Commons, cilësime privatësie).	më efektive dhe duke shërbyer si model për praktikat më të mira të të drejtave të autorit, privatësisë dhe sigurisë digjitale.
6.3.Nxënësit menaxhojnë dhe organizojnë efektivisht informacioni	6.3.1. Nxënësit përdorin aplikacione dhe mjete të menaxhimit të informacionit për të organizuar të dhënat, dokumentet dhe	Nxënësit nuk përdorin mjete për menaxhimin e informacionit ose e ruajnë atë në mënyrë të paorganizuar, duke bërë të vështirë gjetjen e tyre.	Nxënësit përdorin ndonjëherë aplikacione bazike, por organizimi është i kufizuar, jo i vazhdueshëm dhe jo gjithmonë efektiv për nevojat e tyre.	Nxënësit përdorin në mënyrë efektive aplikacione të menaxhimit të informacionit (p.sh., Google Drive,	Nxënësit personalizojnë dhe përmirësojnë përdorimin e mjeteve të menaxhimit, duke zhvilluar sisteme të



n dhe projektet digjitale.	skedarët e tyre digjitalë.			OneDrive) për të organizuar të dhënat, dokumentet dhe skedarët e tyre digjitalë.	ndërlikuara organizimi (p.sh., shenjime të përparuara, automatizime), dhe mund të ndihmojnë të tjerët.
	6.3.2. Nxënësit krijojnë dhe menaxhojnë dosje dhe nëndosje në mënyrë të strukturuar për ruajtjen dhe përdorimin e lehtë të informacionit.	Nxënësit nuk krijojnë dosje ose ato janë krejtësisht të paorganizuara, duke e bërë të pamundur gjetjen e informacionit të nevojshëm.	Nxënësit krijojnë dosje, por struktura është e dobët ose jo e vazhduar, duke vështirësuar qasjen efikas në informacionin specifik.	Nxënësit krijojnë dhe menaxhojnë në mënyrë të strukturuar dosje dhe nëndosje, duke përdorur një hierarki logjike për ruajtjen dhe përdorimin e lehtë të informacionit.	Nxënësit hartojnë dhe zbatojnë skema të reja të organizimit të dosjeve dhe skedarëve, duke rritur efikasitetin në gjetjen dhe ripërdorimin e informacionit në



					projekte të ndryshme.
	6.3.3. Nxënësit ruajnë informacionin digjital në mënyrë të sigurtë, duke përdorur mjete dhe platforma (p.sh., cloud storage ¹⁵) që mundësojnë kopje rezervë dhe rikthim të lehtë.	Nxënësit nuk ruajnë informacionin në mënyrë të sigurtë ose nuk dinë si të bëjnë kopje rezervë. Të dhënat mund të humbin lehtësisht.	Nxënësit ruajnë informacionin, por nuk përdorin platforma të sigurta ose nuk bëjnë kopje rezervë në mënyrë të rregullt, duke rrezikuar humbjen e të dhënave.	Nxënësit ruajnë informacionin në mënyrë të sigurtë, duke përdorur platforma (p.sh., cloud storage) për kopje rezervë të rregullta dhe rikthim të lehtë në rast nevojë.	Nxënësit shfaqin aftësi profesionale në sigurinë e të dhënave dhe strategjitë e kopjeve rezervë, duke zbatuar protokolle të përparuara dhe duke ndarë praktikat më të mira me shokët.
	6.3.4. Nxënësit analizojnë, vlerësojnë dhe	Nxënësit nuk analizojnë informacionin digjital ose nuk e përdorin atë pa	Nxënësit përpiqen të analizojnë informacionin, por nuk	Nxënësit analizojnë, vlerësojnë dhe	Nxënësit kryejnë analiza të përparuara dhe

¹⁵ Cloud storage është një mënyrë për të ruajtur të dhënat në internet, në mënyrë që t'i keni të mundshme për përdorim nga çdo pajisje dhe vend, për sa kohë keni lidhje me internetin.



	interpretojnë informacionin digjital në mënyrë objektive dhe të informuar për t'i përdorur në projekte të ardhshme ose vendimmarrje.	vlërësim kritik për projekte apo vendimmarrje.	e bëjnë këtë në mënyrë të paanshme ose nuk e lidhin qartë me vendimmarrjen/projektet, duke nxjerrë përfundime të dobëta.	interpretojnë në mënyrë të paanshme dhe të informuar informacionin digjital për përdorim në projekte dhe për të mbështetur vendimmarrjet.	interpretime të thella të informacionit digjital, duke zhvilluar argumente të bazuara në të dhëna dhe duke ndikuar në vendimmarrje të ndërlikuara.
6.4.Nxënësit komunikojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë efektive përmes mjeteve digjitale.	6.4.1. Nxënësit përdorin mjete digjitale (e-mail, mesazhe, video-konferenca) për të komunikuar qartë, në kohë reale dhe në mënyrë të respektueshme	Nxënësit nuk përdorin mjete digjitale për komunikim, ose komunikimi i tyre është i paqartë, i papërshtatshëm ose jo etik.	Nxënësit përdorin ndonjëherë mjete digjitale për komunikim, por me vështirësi në qartësi, përshtatshmëri ose respektimin e etikës në internet.	Nxënësit përdorin në mënyrë efektive mjete digjitale (e-mail, mesazhe, video-konferenca) për të komunikuar qartë, në kohë	Nxënësit tregojnë komunikim digjital të shkëlqyer, duke shfrytëzuar mjete të përparuara në mënyrë strategjike, duke



	me bashkëpunëtorët.			reale dhe me respekt, duke përshtatur stilin sipas rrethanave.	moderuar diskutime dhe duke shërbyer si model për komunikimin efektiv dhe etik.
	6.4.2. Nxënësit bashkëpunojnë në projekte grupore duke përdorur mjete digjitale (platforma ndarjeje dokumentesh, menaxhim projekti) për ndarjen e ideve,	Nxënësit nuk bashkëpunojnë me mjete digjitale, ose bashkëpunimi është i paorganizuar dhe joefektiv, pa ndarje të qartë detyrash apo feedback-u.	Nxënësit bashkëpunojnë ndonjëherë me mjete digjitale, por mund të kenë vështirësi në bashkërendimin e detyrave, menaxhimin e kohës ose dhënien/marrjen e feedback-ut në mënyrë efektive.	Nxënësit bashkëpunojnë në mënyrë efektive në projekte në grup duke përdorur mjete digjitale (p.sh., Google Docs, Teams, Trello ¹⁶), duke ndarë detyrat në mënyrë të drejtë	Nxënësit drejtojnë dhe sjellin risi në bashkëpunimin digjital, duke zhvilluar strategji për menaxhimin efikas të projekteve të ndërlikuara, duke nxitur

¹⁶ Google Docs, Microsoft Teams dhe Trello janë platforma digjitale bashkëkohore që mbështesin bashkëpunimin, komunikimin dhe menaxhimin efektiv të detyrave në mjedise arsimore dhe profesionale, duke mundësuar punë të bashkërenduar në kohë reale, organizim pamor dhe shpërndarje të burimeve.



	detyrave dhe feedback-ut.			dhe duke dhënë/marrë feedback të dobishëm.	zgjidhjen krijuese të problemeve në grup dhe duke mentoruar shokët në praktikat bashkëpunuese.
	6.4.3. Nxënësit komunikojnë në mënyrë të përshtatshme dhe profesionale përmes mjeteve të rrjeteve sociale, duke kuptuar ndikimin e gjurmës së tyre digjitale.	Nxënësit nuk komunikojnë në rrjetet sociale, ose komunikimi i tyre është i papërshtatshëm/joprofesional dhe nuk janë të vetëdijshëm për gjurmën digjitale.	Nxënësit përdorin rrjetet sociale, por kanë vështirësi në komunikimin profesional ose nuk janë plotësisht të ndërgjegjshëm për gjurmën e tyre digjitale dhe pasojat e saj.	Nxënësit komunikojnë në mënyrë të përshtatshme dhe profesionale në rrjetet sociale, duke kuptuar ndikimin e gjurmës së tyre digjitale dhe duke vepruar me përgjegjësi.	Nxënësit udhëheqin me shembull në komunikimin profesional online, duke zhvilluar një prani digjitale pozitive dhe duke këshilluar të tjerët për rëndësinë e besueshmërisë



					dhe etikës në rrjet.
	6.4.4. Nxënësit përdorin mjete digjitale për të bashkëpunuar dhe diskutuar në lidhje me projektet, duke ruajtur etikën, respektin për mendimet e të tjerëve dhe duke zgjidhur mosmarrëveshjet.	Nxënësit nuk përdorin mjete digjitale për diskutim grupor, ose diskutimet janë joetike/pa respekt dhe pa zgjidhje mosmarrëveshesh.	Nxënësit përpiqen të diskutojnë online, por kanë vështirësi në ruajtjen e etiketës ose zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë të dobishme përmes mjeteve digjitale.	Nxënësit përdorin në mënyrë efektive mjete digjitale për diskutime mbi projekte, duke ruajtur etikën, respektin dhe duke zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë të dobishme.	Nxënësit lehtësojnë diskutime të thella dhe të dobishme online, duke promovuar tolerancën dhe mirëkuptimin, dhe duke ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve digjitale.
6.5.Nxënësit mbrojnë sigurinë dhe privatësinë online dhe	6.5.1. Nxënësit krijojnë fjalëkalime të forta dhe i menaxhojnë ato në mënyrë të	Nxënësit nuk krijojnë fjalëkalime të forta, përdorin fjalëkalime të dobëta, ose nuk i menaxhojnë ato në mënyrë	Nxënësit krijojnë fjalëkalime disi të sigurt, por mund të mos kuptojnë plotësisht rëndësinë e	Nxënësit krijojnë në mënyrë të rregullt fjalëkalime të forta dhe i	Nxënësit zbatojnë praktika të avancuara të sigurisë së fjalëkalimeve



demonstrojnë sjellje etike digjitale.	sigurt, duke kuptuar rëndësinë e tyre.	të sigurt (p.sh., i ndajnë me të tjerët).	tyre ose kanë vështirësi në menaxhimin afatgjatë të sigurt.	menaxhojnë ato në mënyrë të sigurt, duke kuptuar rëndësinë e ruajtjes së tyre.	(p.sh., përdorues të menaxherëve të fjalëkalimeve, vërtetësisë me shumë faktorë), dhe mund të edukojnë të tjerët për rëndësinë e tyre.
	6.5.2. Nxënësit përdorin cilësimet e privatësisë në platformat online për të mbrojtur informacionin e tyre personal dhe janë të vetëdijshëm për gjurmën e tyre digjitale.	Nxënësit nuk përdorin cilësimet e privatësisë ose nuk janë të vetëdijshëm për informacionin personal që ndajnë online dhe gjurmën digjitale.	Nxënësit përdorin ndonjëherë cilësimet e privatësisë, por me ndërgjegjësim të kufizuar për përfshirjen e gjurmës së tyre digjitale ose se si mund të shfrytëzohet informacioni.	Nxënësit përdorin në mënyrë efektive cilësimet e privatësisë në platformat online për të mbrojtur informacionin e tyre personal dhe janë të vetëdijshëm për	Nxënësit analizojnë dhe optimizojnë cilësimet e tyre të privatësisë në platforma të shumta, duke kuptuar thellësisht përfshirjen ligjore dhe etike



				gjurmën e tyre digjitale.	të gjurmës digjitale dhe ndikimin e saj në të ardhmen.
	6.5.3. Nxënësit identifikojnë rreziqet e mundshme të përdorimit të internetit (p.sh., bullizmi kibernetik, mashtrimet, informacioni i rremë) dhe dinë si të mbrohen/raportojnë.	Nxënësit nuk identifikojnë rreziqet online ose bien pre e tyre lehtësisht. Nuk dinë si të mbrohen ose të raportojnë sjellje të pahijshme.	Nxënësit njohin disa rreziqe bazike online, por mund të jenë të pavendosur në shmangien e tyre ose në mënyrën e duhur të mbrojtjes/raportimit efektiv.	Nxënësit identifikojnë në mënyrë efektive rreziqet e mundshme të përdorimit të internetit, shmangin situatat e rrezikshme dhe dinë qartësisht si të mbrohen ose të raportojnë sjelljet e pahijshme dhe	Nxënësit parashikojnë dhe adresojnë rreziqet e reja online, duke zhvilluar strategji parashikuese për mbrojtjen (p.sh., njohjen e phishing-ut të përparuar, mashtrimeve të IA-së), dhe duke ndihmuar shokët



				veprimtaritë e dyshimta.	në situata sfiduese.
	6.5.4. Nxënësit shfaqin sjellje të përgjegjshme, etike dhe të sigurta në mjediset digjitale, duke respektuar të drejtat e të tjerëve dhe normat sociale online.	Nxënësit nuk shfaqin sjellje të përgjegjshme dhe etike online; mund të shfaqin sjellje bullizuese ose të papërshtatshme.	Nxënësit shfaqin disa elementë të sjelljes etike, por mund të mos kuptojnë plotësisht të drejtat e të tjerëve ose normat e ndërlikuara sociale të mjediseve digjitale.	Nxënësit shfaqin në mënyrë vazhdueshme sjellje të përgjegjshme, etike dhe të sigurta në mjediset digjitale, duke respektuar të drejtat e të tjerëve dhe normat sociale online.	Nxënësit përkrahin dhe udhëheqin sjelljen etike dhe përgjegjshmërinë digjitale, duke ndërtuar një besueshmëri pozitive online dhe duke frymëzuar edhe të tjerët përmes veprimeve.



METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Qasja e vlerësimit

Vlerësimi i kompetencave digjitale të mësuesve është një përbërës thelbësor për të kuptuar në mënyrë të qëndrueshme se sa efektivisht po ndërthuren teknologjitë në procesin arsimor. Në një kohë kur shkollat po përballen me ndryshime të thella digjitale, është e domosdoshme të zhvillohet një proces vlerësimi i mirëstrukturuar që jo vetëm vë në dukje nivelin e tanishëm të aftësive, por edhe udhëzon drejt përmirësimit të vazhdueshëm profesional. Kjo kërkon një qasje të barazpeshuar, gjithëpërfshirëse dhe reflektuese, e cila mbështet zhvillimin personal të mësuesve dhe përforcon cilësinë e mësimdhënies në epokën digjitale.

Qasja e përgjithshme për vlerësimin e kompetencave digjitale të mësuesve do të ndërtohet mbi një kombinim të qasjes së vazhdueshme dhe qasjes përmbyllëse, duke synuar mbështetjen dhe dokumentimin e zhvillimit profesional në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse. Kjo siguron një pamje të plotë, të balancuar dhe dinamike të zhvillimit të kompetencave digjitale. Qasja e vazhdueshme mbështet procesin e të nxënës dhe zhvillimit personal, ndërsa qasja përmbyllëse ofron të dhëna të qarta mbi arritjet e mësuesve.

Qasja e vazhdueshme: Gjatë gjithë procesit të zhvillimit të kompetencave digjitale, vlerësimi do të shërbejë si një mjet për monitorimin e ecurisë individuale të mësuesve, identifikimin e pikave të forta dhe të fushave që kërkojnë përmirësim, si dhe për ofrimin e feedback-ut të rregullt dhe ndihmues. Kjo qasje do të zbatohet nëpërmjet:

- Vetëvlerësimit të rregullt të mësuesve;
- Vlerësimit nga kolegët;
- Vëzhgimeve të ndërmjetme në praktikën mësimore.

Qëllimi i kësaj qasjeje është të nxisë reflektimin profesional, vetëdërgjegjësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të praktikës pedagogjike digjitale.

Qasja përmbyllëse: Në përfundim të një periudhe të caktuar (p.sh., një tremujori ose një viti shkollor), do të realizohet një vlerësim përfundimtar (përmbyllës) për të përcaktuar nivelin e përgjithshëm të kompetencave digjitale të mësuesve. Ky vlerësim do të bazohet në:



- Analizën e portofolit digjital të mësuesit;
- Vlerësimin e përbashkët nga kolegët dhe ekspertët.

Rezultatet e vlerësimit përmbyllës mund të përdoren për qëllime të certifikimit, përcaktimin e nevojave për trajnime të mëtejshme, zhvillimin e karrierës ose si bazë për planifikimin e ndërhyrjeve në nivel institucional dhe politikave arsimore.

Metodat e vlerësimit

Për të siguruar një proces vlerësimi të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të besueshëm, do të përdoren këto metoda:

- *Vetëvlerësimi:*

Mësuesit angazhohen në vetëvlerësim duke përdorur rubrika ose lista kontrolli të standardizuara për vlerësimin e aftësive të tyre digjitale në fusha si përdorimi i mjeteve TIK, integrimi pedagogjik, dhe zhvillimi profesional. Kjo metodë nxit reflektimin dhe vetëdijësimin.

- *Vlerësimi nga kolegët:*

Mësuesit vlerësojnë njëri-tjetrin në bazë të kriterëve të qarta, përmes vëzhgimeve të ndërsjella, analizës së materialeve digjitale ose shqyrtimit të portofolit. Kjo formë vlerësimi forcon bashkëpunimin, ndarjen e praktikave të mira dhe zhvillimin e bashkësive profesionale të të nxënësve.

- *Vëzhgimi i praktikës në klasë:*

Ekspertë të trajnuar ose drejtues të shkollës realizojnë vëzhgime të strukturuar gjatë orës mësimore, duke vlerësuar përdorimin efektiv të teknologjisë në procesin mësimor, ndërveprimin digjital me nxënësit dhe krijimin e një mjedisi të pasur për të nxënësit online.

- *Portofoli digjital i mësuesit:*

Çdo mësues do të mbajë një portofol digjital që dokumenton zhvillimin e kompetencave digjitale. Ai përfshin plane mësimore që integrojnë teknologjinë, materiale multimediale, dëshmi të përdorimit të platformave online dhe pjesëmarrje në trajnime. Portofoli vlerësohet sipas një skeme standarde të bazuar në rubrikën e kompetencave.




- *Vlerësimi nga ekspertët:*

Një grup ekspertësh të pavarur dhe të specializuar në fushën e arsimit dhe TIK-ut do të analizojnë të gjitha të dhënat e mbledhura dhe do të japin një vlerësim të standardizuar dhe objektiv. Nëse është e nevojshme, do të zhvillohen intervista të shkurtra me mësuesit për të thelluar kuptimin e praktikave të tyre digjitale.

Teknika për vlerësimin e kompetencave digjitale të mësuesve

Për të vlerësuar në mënyrë të plotë dhe efektive nivelin e kompetencave digjitale të mësuesve në shkolla, është e rëndësishme të përdoren qasje që ndërthurin mbledhjen e rregullt të të dhënave, përfshirjen e perceptimeve nga aktorë të ndryshëm dhe analizën kritike e strategjike. Në këtë kuadër, *Trekëndëshi i vlerësimit të cilësisë* dhe analiza *SWOT* janë dy teknika të fuqishme që, të ndërthurura, sigurojnë një vlerësim gjithëpërfshirës dhe një plan konkret për përmirësim të vazhdueshëm të kapaciteteve digjitale të mësuesve. Ndërthurja e *Analizës SWOT* dhe *Trekëndëshit të Vlerësimit* është një qasje shumë e fuqishme që siguron një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe strategjike mbi kompetencat digjitale të mësuesve. SWOT ndihmon në identifikimin e forcave dhe dobësive kryesore, ndërsa Trekëndëshi siguron mbledhjen e të dhënave të sakta dhe të detajuara që mund të përdoren për të krijuar një plan të bazuar në prova për përmirësimin e mëtejshëm të kompetencave digjitale.

Trekëndëshi i vlerësimit të cilësisë është një teknikë që përdoret për të krahasuar dhe për të sinkronizuar të dhënat e mbledhura nga burime të ndryshme. Në kontekstin e vlerësimit të nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve, “Trekëndëshi i vlerësimit të cilësisë” shërben si qasje gjithëpërfshirëse, për të siguruar që vlerësimi është objektiv, i saktë dhe i bazuar në të dhëna. Përdorimi i këtyre të dhënave siguron objektivitet, transparencë dhe vë në qendër përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve.



Trekëndëshi i vlerësimit të cilësisë përfshin tri burime të të dhënave, përkatësisht:

1. Të dhënat sasiore

Këto të dhëna ofrojnë informacion të matshëm mbi përdorimin dhe zotërimin e teknologjisë nga mësuesit, si p.sh.:

- Përqindja e mësuesve që përdorin rregullisht TIK në mësimdhënie.
- Numri i mësuesve të trajnuar në fushën digjitale gjatë 3 viteve të fundit.
- Llojet dhe temat e trajnimeve digjitale të ndjekura.
- Përdorimi i platformave online për komunikim, menaxhim të mësimin dhe vlerësim.
- Përqindja e mësuesve që përdorin mjete digjitale për vlerësim formativ dhe/ose përmbledhës.
- Shkalla e përfshirjes në bashkësitë profesionale online.
- Përdorimi i burimeve të hapura edukative (OER).

2. Perceptimet e aktorëve

Këto përfshijnë të dhëna cilësore të mbledhura përmes anketave, intervistave dhe diskutimeve të strukturuar me:

- Mësuesit, mbi vetëvlerësimin e kompetencave të tyre digjitale dhe vështirësitë që përjetojnë.
- Nxënësit, mbi përvojën e tyre në klasat ku përdoren ose jo teknologjitë digjitale.
- Prindërit, për perceptimin e përdorimit të teknologjisë në mësimdhënie.
- Drejtuesit shkollorë, mbi kapacitetin e stafit për të përdorur mjetet digjitale në mënyrë efektive.
- Koordinatorët e cilësisë/ mësuesit e TIK/ trajnerët, për përgatitjen, nevojat dhe sfidat që kanë mësuesit në lidhje me kompetencat digjitale.

3. Vëzhgimi i drejtpërdrejtë

Ky element siguron një panoramë realiste të mënyrës se si teknologjia përdoret në praktikë nga mësuesit:

- Vëzhgim i orëve të mësimin për të parë përdorimin e teknologjisë në klasë.



- Analizë e mjeteve dhe përmbajtjeve digjitale të përdorura (prezantime, video, platforma ndërvepruese, aplikacione).
- Vlerësim i ndërveprimit mes mësuesit dhe nxënësve në mjedise digjitale.
- Vlerësim i dokumentacionit profesional (plane mësimore digjitale, vlerësime online, portofolë).
- Monitorim i përdorimit të sistemeve të menaxhimit të të nxënësve (LMS).

Ndërthurja e këtyre tre përmasave ndihmon në krijimin e një pasqyre të balancuar, duke kapur jo vetëm atë që mësuesit “pohojnë” ose “dëshirojnë”, por edhe atë që ndodh realisht në praktikë.

Analiza SWOT (Sukseset, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet) është mjet i fuqishëm për vlerësimin dhe përmirësimin e nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve. Ajo ofron një kornizë të strukturuar, që ndihmon në identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, që ndikojnë në nivelin e kompetencave digjitale të mësuesve, dhe mundëson zhvillimin e strategjive për përmirësimin e tyre.

<i>Sukseset (Forcat)</i>	<i>Dobësitë</i>
• Zotërimi bazik i mjeteve digjitale nga shumica e mësuesve. • Pjesëmarrje e vazhdueshme në trajnime dhe vetë-iniciativë për zhvillim profesional. • Përdorimi i platformave kombëtare (si Akademia.al, portalet TIK etj.). • Mbështetja e drejtuesve të shkollës për përdorimin e TIK në mësimdhënie.	• Mungesë e thellimit në kompetenca të përparura digjitale (si krijimi i përmbajtjes, analiza e të dhënave, etiketa digjitale). • Mungesë pajisjesh teknologjike të mjaftueshme në klasë ose shkollë. • Vetëbesim i ulët i disa mësuesve për përdorimin e mjeteve digjitale. • Përdorim sipërfaqësor i teknologjisë, pa ndikim të thellë në të nxënësve.
<i>Mundësitë</i>	<i>Kërcënimet</i>
• Programe kombëtare ose ndërkombëtare për zhvillimin profesional digjital të mësuesve. • Bashkëpunimi me universitete, OJF dhe qendra trajnimi. • Mundësi për të përdorur inteligjencën artificiale në personalizimin e mësimdhënies. • Integrimi i mëtejshëm i platformave online për mësim të përzier dhe e-learning.	• Hendeu digjital mes brezave të mësuesve dhe nxënësve që mund të ndikojë në cilësinë e komunikimit. • Mungesë financimesh për pajisje dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm. • Rezistenca ndaj ndryshimit dhe përdorimit të teknologjisë nga një pjesë e stafit. • Politika arsimore jo të qëndrueshme që ndikojnë zhvillimin afatgjatë të kompetencave digjitale.



Procesi i vlerësimit

Procesi i vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve synon të sigurojë një pamje të qartë dhe gjithëpërfshirëse të nivelit të tyre profesional në përdorimin e teknologjisë në arsim, në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënësve. Ky proces nuk ka për qëllim vetëm identifikimin e nivelit aktual të njohurive dhe aftësive teknologjike të mësuesve, por shërben gjithashtu si bazë për zhvillimin e qëndrueshëm profesional, planifikimin e trajnimeve të përshtatura dhe përmirësimin e politikave arsimore.

Përmes një vlerësimi të mirëstrukturuar dhe gjithëpërfshirës, mund të nxiten reflektimi profesional, ndarja e praktikave të mira dhe krijimi i një kulture mësimdhënieje inovative që përgatit më mirë nxënësit për kërkesat e shekullit 21.

Procesi i vlerësimit do të zhvillohet në fazat e mëposhtme:

1. Planifikimi:

Përcaktimi i qëllimeve dhe objektivave të vlerësimit: Saktësimi i asaj që synohet të arrihet përmes vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve (p.sh., identifikimi i nivelit aktual të kompetencave, nevojave për zhvillim profesional, përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies digjitale).

Zgjedhja dhe përshtatja e instrumenteve të vlerësimit: Hartimi ose përshtatja e mjeteve të vlerësimit si: rubrika për kompetencat digjitale, lista kontrolli, udhëzues për vëzhgim të orës mësimore, pyetësorë për vetëvlerësim dhe vlerësim nga kolegët.

Planifikimi i kohës dhe burimeve të nevojshme: Hartimi i një kalendari të qartë për realizimin e çdo faze të vlerësimit dhe identifikimi i burimeve njerëzore, teknologjike dhe financiare që nevojiten për një proces të suksesshëm.

Trajnimi i vlerësuesve (nëse është e nevojshme): Organizimi i seancave informuese dhe trajnimeve për vlerësuesit (kolegë, drejtues, ekspertë të jashtëm), për të siguruar një kuptim të përbashkët të kriterëve të vlerësimit dhe përdorimit të instrumenteve.



Komunikimi i procesit të vlerësimit: Informimi i qartë dhe transparent i mësuesve në lidhje me qëllimin, metodologjinë, instrumentet dhe kohën e zbatimit të vlerësimit, për të siguruar angazhim dhe bashkëpunim të plotë.

2. Zbatimi

Faza e zbatimit është thelbësore për mbledhjen e të dhënave konkrete mbi nivelin e kompetencave digjitale të mësuesve. Ajo përfshin përdorimin e instrumenteve të përgatitura në fazën e planifikimit dhe organizimin praktik të vlerësimeve. Kjo fazë ndahet në këto nënhapa:

Kryerja e vetëvlerësimit nga mësuesit

- Mësuesit plotëson instrumentin e vlerësimit (shtojca 1) në lidhje me nivelin e kompetencave digjitale të tyre.
- Vetëvlerësimi përfshin reflektim mbi aftësitë teknike, përdorimin e mjeteve digjitale në mësimdhënie, menaxhimin e mjedisit të të nxënës digjital dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm.
- Ky proces ndihmon në rritjen e vetëdijes së mësuesve për pikat e forta dhe nevojat për zhvillim.

Vlerësimi nga kolegët (peer review)

- Mësuesit vlerësojnë njëri-tjetrin duke përdorur të njëjtën rubrikë dhe duke u bazuar në materiale të ndara, bashkëpunim në projekte digjitale ose vëzhgime të ndërsjella.
- Kjo ndihmon në ndarjen e praktikave të mira dhe krijon një kulturë reflektimi dhe bashkëpunimi profesional në shkollë.

Vëzhgimi i praktikës mësimore në klasë

- Vlerësuesit (drejtuesit e shkollës, institucionet vlerësuese) realizojnë vëzhgime të strukturuar të orëve të mësimi.
- Ata përdorin këtë metodologji për të vlerësuar përdorimin efektiv të teknologjisë në procesin e të nxënës, ndërveprimin me nxënësit dhe integrimin pedagogjik të mjeteve digjitale.
- Vëzhgimi shoqërohet me reflektim pas orës nga ana e mësuesit.



Mbledhja dhe shqyrtimi i portofolit digjital të mësuesit

- Çdo mësues dorëzon një portofol digjital që përfshin: plane mësimore që integrojnë teknologjinë, projekte digjitale të realizuara me nxënësit, materiale multimediale të krijuara nga mësuesi, përdorimin e platformave online (LMS, Google Classroom, etj.), dhe dëshmi të pjesëmarrjes në trajnime.
- Portofoli vlerësohet sipas kriterëve të qarta që lidhen me rubrikën e kompetencave.

Analiza e të dhënave:

- Përmbledhja dhe analizimi i të dhënave të mbledhura nga të gjitha burimet.
- Identifikimi i modeleve, tendencave dhe dallimeve në kompetencat digjitale të mësuesve.
- Interpretimi i rezultateve të vlerësimit në kontekstin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara.

Raportimi i rezultateve:

- Përgatitja e raporteve të vlerësimit (formati në shtojcë) që përmbajnë një përmbledhje të rezultateve, pikat e forta dhe dobësitë e mësuesve, dhe rekomandime për zhvillim profesional të mëtejshëm.
- Shpërndarja e raporteve tek mësuesit, drejtuesit e shkollave dhe palët e tjera të interesuara.
- Dhënia e feedback-ut të detajuar dhe konstruktiv mësuesve.
- Përdorimi i rezultateve të vlerësimit për planifikimin e zhvillimit profesional, përmirësimin e programeve të trajnimit dhe politikave arsimore. Rezultatet e vlerësimit nuk kanë vetëm funksion individual, por shërbejnë gjithashtu si bazë për planifikimin strategjik të zhvillimit digjital të shkollave.

Kjo metodologji e detajuar siguron një proces të drejtë, transparent dhe të besueshëm të vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve, duke ofruar një bazë të fortë për zhvillimin e tyre të vazhdueshëm dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Instrumentet e vlerësimit të kompetencave digjitale

Për të realizuar një vlerësim sa më të plotë, të drejtë dhe gjithëpërfshirës të kompetencave digjitale të mësuesve, është e nevojshme përdorimi i një kombinimi instrumentesh vlerësimi, të cilët matin si dimensionin njohuror dhe praktik, ashtu edhe reflektimin profesional të



mësuesit mbi përdorimin e teknologjisë në arsim. Më poshtë paraqiten instrumentet kryesore që rekomandohen për këtë proces:

Instrumenti i vetëvlerësimit

Instrumenti i vetëvlerësimit (Shtojca 1) është një ndër instrumentet më të rëndësishme në vlerësimin e kompetencave digjitale të mësuesve.

Ai ofron një pasqyrë të vlefshme mbi vetëdijen që mësuesi ka për njohuritë, qëndrimet dhe mënyrën e përdorimit të teknologjisë në praktikën mësimore dhe zhvillimin profesional. Duke qenë një instrument i lehtë për t'u administruar dhe që mund të plotësohet në mënyrë të pavarur, ai ndihmon në mbledhjen e të dhënave në shkallë të gjerë dhe në një kohë të shkurtër. Për më tepër, nxit reflektimin individual të mësuesve mbi përvojat dhe nevojat e tyre për përmirësim, çka përbën një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit profesional të qëndrueshëm.

Megjithatë, përkundër këtyre përfitimeve, instrumenti i vetëvlerësimit ka disa kufizime që duhen pasur parasysh gjatë interpretimit të të dhënave.

Së pari, ai bazohet në perceptimin personal të mësuesit, duke e bërë procesin subjektiv dhe potencialisht të pasaktë. Në mungesë të një vetëdijeje të qartë mbi performancën e tyre reale, mësuesit mund të mbivlerësojnë ose nënvlerësojnë aftësitë e tyre digjitale. Kjo prirje mund të ndikohet edhe nga faktorë të jashtëm, si dëshira për të dhënë përgjigje që duken më të pranueshme profesionalisht apo për t'u përshtatur me pritshmëritë e institucioneve.

Së dyti, ky instrument nuk ofron dëshmi konkrete për mënyrën se si mësuesi përdor realisht teknologjinë në klasë. Ai më tepër shpreh bindjet dhe qëndrimet personale, dhe jo domosdoshmërisht sjelljen faktike në situata të vërteta mësimore. Kjo e bën të vështirë të matet boshllëku ndërmjet njohurive të deklaruara dhe aftësive praktike.

Për këto arsye, përdorimi i instrumentit të vetëvlerësimit është i vlefshëm si një përbërës i rëndësishëm në procesin e vlerësimit të brendshëm të shkollës, si dhe në vlerësimin e performancës vjetore të mësuesit, në mënyrë që të sigurohet një pamje më e balancuar, objektive dhe e besueshme mbi kompetencat digjitale të mësuesve.

Forma: Online (Google Forms, SurveyMonkey) ose letër.



Vëzhgimi në Klasë

Vëzhgimi në klasë është një nga instrumentet më të fuqishme për të vlerësuar mënyrën reale se si mësuesit integrojnë teknologjinë në procesin mësimor. Duke siguruar dëshmi të drejtpërdrejta dhe konkrete, ky instrument e ndihmon vlerësuesin të kuptojë më mirë se si konceptet e kompetencës digjitale përkthehen në sjellje pedagogjike të prekshme. Vëzhgimi ofron një mundësi të rrallë për të parë në kohë reale ndërveprimin mes mësuesit, teknologjisë dhe nxënësve, si dhe aftësinë e mësuesit për të menaxhuar një klasë të digjitalizuar dhe për të përdorur teknologjinë në mënyrë të përshtatshme nga ana didaktike.

Megjithatë, përkundër vlerës së lartë që ka, vëzhgimi në klasë përballet me disa kufizime të natyrshme që mund të ndikojnë në objektivitetin dhe qëndrueshmërinë e të dhënave që siguron. Një nga kufizimet kryesore është fakti që zakonisht përfshin një ose dy orë të izoluar mësimi, të cilat nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht sjelljen e përditshme të mësuesit. Sjellja e tij mund të ndryshojë ndjeshëm në varësi të përmbajtjes së lëndës, dinamikës së klasës, ose faktorëve të tjerë kontekstualë që nuk janë të dukshëm gjatë një vëzhgimi të vetëm.

Një tjetër kufizim i njohur është efekti i pranisë së vëzhguesit, i cili mund të ndryshojë sjelljen natyrale të mësuesit. I ashtuquajtur *efekt Hawthorne* nënkupton që individët kanë prirjen të sillen ndryshe kur e dinë se po vëzhgohen. Në këtë rast, mësuesi mund të përpiqet të japë një performancë më të strukturuar apo më të kujdesshme sesa ajo që është pjesë e praktikës së zakonshme.

Gjithashtu, cilësia e të dhënave të mbledhura varet ndjeshëm nga përgatitja dhe profesionalizmi i vëzhguesit. Interpretimi i sjelljeve të mësuesit, vlerësimi i situatave dhe zgjedhjet metodologjike gjatë analizës varen nga përvoja dhe aftësia e vëzhguesit për të qenë objektiv. Çdo luhatje në këto elemente mund të sjellë paragjykime të pavetëdijshme apo vlerësime të njëanshme, ndaj nevojitet një standardizim i qartë i rubrikës së vlerësimit dhe trajnime specifike për vlerësuesit.

Së fundi, vëzhgimi në klasë është një proces që kërkon kohë dhe burime logjistike. Organizimi i vëzhgimeve, koordinimi me mësuesit, dokumentimi dhe analizimi i të dhënave kërkojnë angazhim të konsiderueshëm nga ana e institucioneve apo ekipeve vlerësuese. Kjo e bën metodën më të kushtueshme dhe më të vështirë për t'u aplikuar në shkallë të gjerë, veçanërisht në sisteme me kapacitete të kufizuara.



Për këto arsye, edhe pse vëzhgimi në klasë mbetet një mjet i vyer për të matur komponentin praktik të kompetencave digjitale, IA duhet të përdoret në bashkërendim me instrumente të tjera që e plotësojnë dhe e balancojnë pasqyrën e përgjithshme të vlerësimit.

Forma: Treguesit e vlerësimit të përcaktuar në këtë metodologji.

Portofoli Digjital

Portofoli digjital është një instrument i rëndësishëm dhe gjithnjë e më i përdorur në vlerësimin e kompetencave digjitale të mësuesve, pasi ofron prova të drejtpërdrejta dhe të dokumentuara të praktikës së tyre.

Ai lejon që mësuesit të paraqesin materiale të vërteta të krijuara ose të përdorura në mësimdhënie, si plane mësimore, ushtrime ndërvepruese, platforma online, ose mjete të vlerësimit të nxënësve. Ai mund të shoqërohet me reflektime personale mbi procesin mësimor, duke thelluar kuptimin mbi mënyrën se si teknologjia përdoret në përditshmëri.

Përkundër vlerës së tij të madhe, portofoli digjital përballet me disa kufizime që mund të ndikojnë në besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e të dhënave që ofron. Një nga sfidat kryesore lidhet me përzgjedhjen e materialeve që mësuesi vendos të përfshijë. Shpesh, portofoli përmban vetëm punët më të suksesshme dhe të përzgjedhura, duke lënë jashtë përvojat më të vështira apo më pak të arrira, të cilat megjithatë janë pjesë thelbësore e zhvillimit profesional. Kjo krijon një pasqyrë të pjesshme, që nuk e reflekton gjithmonë praktikën reale dhe të përditshme të mësuesit.

Një tjetër kufizim i rëndësishëm është fakti që krijimi i portofolit kërkon një sërë aftësish digjitale teknike, që nuk janë domosdoshmërisht të barabarta të të gjithë mësuesit. Kjo do të thotë se ata me më pak përvojë ose me kompetenca më të ulëta digjitale mund ta kenë të vështirë të hartojnë një portofol të strukturuar dhe përfaqësues, duke u ndëshkuar jo për mungesë përmbajtjeje apo përprjekjeje, por për shkak të vështirësive teknologjike.

Procesi i përgatitjes dhe vlerësimit të portofolit është gjithashtu i ngadaltë dhe kërkon kohë të mjaftueshme, si nga ana e mësuesit për ta ndërtuar, ashtu edhe nga ana e vlerësuesit për ta shqyrtuar me kujdes. Në shkallë të gjerë, kjo mund të kthehet në një barrë organizative dhe të ndikojë në qëndrueshmërinë e zbatimit të instrumentit.



Për këto arsye, ndonëse portofoli digjital është një mjet i vlefshëm për të dokumentuar kompetencat digjitale të mësuesve, ai duhet të shoqërohet me mbështetje teknike dhe pedagogjike, si dhe të ndërthuren me instrumente të tjera vlerësimi për të ndërtuar një pasqyrë sa më të plotë dhe të drejtë.

Forma: Prezantim online (p.sh., Google Sites, OneDrive folder, Padlet) ose fizik, sipas mundësive teknologjike.

Intervista e Strukturuar / Gjysmë e strukturuar

Intervista e strukturuar apo gjysmë e strukturuar përfaqëson një nga instrumentet më të vlefshme për të hulumtuar përmasën reflektuese dhe përvojat personale të mësuesit në përdorimin e teknologjisë në arsim.

Ajo i jep zë vetë mësuesit për të treguar mënyrën se si i koncepton dhe i përjeton praktikën e tij digjitale, duke i ofruar vlerësuesit një kuptim më të thelluar dhe kontekstual të kompetencës së tij.

Një nga pikat më të forta të këtij instrumenti është aftësia për të zbuluar motivimin, qëndrimet dhe sfidat reale me të cilat përballet mësuesi në punën e përditshme. Ndryshe nga pyetësorët standardë, intervista lejon ndërtimin e një narrative individuale, që shkon përtej pohimeve të thata dhe ndihmon vlerësuesin të kuptojë jo vetëm *çfarë* bën mësuesi, por edhe *pse* e bën atë. Për më tepër, ajo mund të përshtatet në mënyrë fleksibile sipas profilit të mësuesit apo fushave që kërkojnë eksplorim më të thelluar.

Gjithashtu, intervista mund të zbulojë aspekte që nuk dokumentohen dot lehtësisht në forma të tjera, si për shembull reflektimi i brendshëm, mëdyshjet profesionale ose rrethanat specifike institucionale që ndikojnë në përdorimin e teknologjisë. Ajo ndihmon gjithashtu në verifikimin apo sqarimin e gjetjeve që dalin nga instrumente të tjera, duke ofruar një pasqyrë të plotësuar dhe të hollësishme.

Megjithatë, intervista ka edhe kufizime që duhet të merren parasysh. ***Së pari***, ajo kërkon kohë të mjaftueshme, si për zhvillimin ashtu edhe për analizën e të dhënave të mbledhura. Në varësi të numrit të mësuesve të përfshirë, kjo mund të bëhet një proces i ngadalshëm dhe kërkon burime njerëzore.



Së dyti, cilësia e të dhënave varet nga aftësia e intervistuesit, si në drejtimin e bisedës, ashtu edhe në interpretimin e përgjigjeve. Pa një përgatitje të mirë paraprake dhe pa një strukturë të qartë, ekziston rreziku i shmangies nga temat kryesore ose i interpretimeve subjektive.

Gjithashtu, intervista mund të ndikojë nga qëndrimi i mësuesit ndaj vlerësimit. Disa mësues mund të ndihen në siklet, të përpiqen të japin përgjigje “të sakta” ose të shmangin diskutimin mbi vështirësitë reale, veçanërisht nëse procesi nuk garanton një klimë besimi dhe ruajtjes së të dhënave.

Për këto arsye, ndonëse shumë e vlefshme, intervista duhet të përdoret në mënyrë plotësuese me instrumente të tjera më objektive, duke garantuar standardizim në pyetjet kryesore, trajnimin e intervistuesve dhe analizën e rregullt të të dhënave për të ruajtur vlefshmërinë dhe besueshmërinë e vlerësimit.

Forma: Ballë për ballë, online (google forms) ose me shkrim, me pyetje të hapura/të mbyllura dhe të përgatitura më parë.

Zbatimi i suksesshëm i çdo metodologjie të re has rreziqe dhe sfida të caktuara. Identifikimi paraprak dhe hartimi i strategjive për adresimin e tyre është shumë i rëndësishëm për garantimin e efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së këtij vlerësimi.



SFIDAT NË VLERËSIMIN E KOMPETENCAVE DIGJITALE TË MËSUESVE

Vlerësimi i kompetencave digjitale të mësuesve është një proces i ndërlikuar, që synon të sigurojë një pamje të qartë të aftësive të tyre në përdorimin e teknologjisë në procesin mësimor. Megjithëse kjo metodologji ofron një kornizë të detajuar dhe të strukturuar, është e rëndësishme të njihen dhe të adresohen rreziqet dhe sfidat e mundshme që mund të ndikojnë në vlefshmërinë, besueshmërinë dhe efektivitetin e procesit të vlerësimit.

Sfidat e infrastrukturës dhe qasjes ndaj teknologjisë digjitale:

Në kuadër të procesit të vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve në Shqipëri, një nga pengesat kryesore që mund të haset është pabarazia e theksuar në infrastrukturë dhe qasjen në teknologji. Kjo krijon një mjedis të pabarabartë mundësish dhe vështirëson përparimin e njëjtësuar drejt integritit efikas të teknologjisë në praktikën mësimore.

Në thelb të kësaj pabarazie qëndron qasja e kufizuar në pajisje. Realiteti dëshmon se shumë institucione arsimore, veçanërisht ato të vendosura në zonat rurale, karakterizohen nga mungesa e mjeteve bazë. Kompjuterët, projektorët dhe pajisjet e tjera digjitale, të cilat shihen si thelbësore për një mësimdhënie bashkëkohore dhe tërheqëse, shpesh mungojnë ose janë të pamjaftueshme. Kjo mangësi nuk ndikon vetëm në procesin mësimor brenda mjedisit shkollor. Mësuesit, të cilët mund të mos kenë në përdorim pajisje të përshtatshme as në banesat e tyre, gjenden në një situatë të dyfishtë vështirësie. Zhvillimi i kompetencave të tyre digjitale, një proces që kërkon praktikë të vazhdueshme dhe eksperimentim, paraqitet si një sfidë që duhet marrë parasysh. Ilustrim i kësaj situatë është mësuesi i përkushtuar, i cili synon të integrojë elemente digjitale në planifikimin e orës mësimore, por i mungon si kompjuteri për të përgatitur materialet, ashtu edhe projektori për t'i prezantuar ato para nxënësve.

Një faktor tjetër që e rëndon këtë situatë është lidhja e paqëndrueshme e internetit. Në epokën digjitale, interneti shërben si arteria kryesore që furnizon institucionet arsimore dhe mësuesit me burime, informacione dhe mundësi zhvillimi profesional.



Megjithatë, shpesh cilësia e lidhjes së internetit është e ndryshueshme, e paparashikueshme dhe shpeshherë jo e duhura. Kjo paqëndrueshmëri përbën një pengesë të mjaftueshme për përdorimin efikas të mjeteve dhe burimeve online. Mësuesit, të cilët mund të jenë të motivuar për të hulumtuar platformat e reja arsimore ose për të marrë pjesë në trajnime online, shpesh përballen me vështirësi si ndërprerjet e lidhjes, shpejtësia e ulët dhe pamundësia për të shkarkuar materialet e nevojshme. Kjo situatë jo vetëm që pengon zhvillimin e kompetencave të tyre digjitale, por mund të ndikojë negativisht edhe në motivimin e tyre për të integruar teknologjinë në praktikën mësimore.

Për më tepër, sfidat e infrastrukturës komplikohen nga mungesa e mbështetjes teknike. Institucionet arsimore mund të mos kenë personel të specializuar për të ofruar mbështetje teknike për mësuesit. Si rrjedhojë, mësuesit, kur hasin probleme teknike, nga mosfunksionimi i kompjuterit deri te vështirësitë në instalimin e programeve, shpesh detyrohen t'i zgjidhin ato në mënyrë të pavarur. Kjo mungesë e mbështetjes, jo vetëm që shton ngarkesën e punës së mësuesve, por mund të gjenerojë edhe një ndjenjë zhgënjimi dhe të zvogëlojë besimin e tyre në përdorimin e teknologjisë. Në vend që ta perceptojnë teknologjinë si një mjet të dobishëm për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, ata mund ta konsiderojnë atë si një burim stresi dhe ndërlikimesh.

Strategjitë për adresimin e sfidave:

- Nxitja e investimeve afatgjata nga autoritetet qeveritare dhe bashkitë për modernizimin e infrastrukturës TIK në të gjitha shkollat, duke përfshirë qasje në internet me shpejtësi të lartë dhe furnizim me pajisje përkatëse.
- Zhvillimi i veprimtarive trajnuese dhe instrumenteve të vlerësimit që mund të përdoren pjesërisht ose plotësisht offline, për të siguruar që mësuesit në zonat me lidhje të dobët të mos kenë probleme.
- Ngritja e qendrave në nivel vendor ose bashkiak, ku mësuesit mund të kenë qasje të garantuar në kompjutera, internet dhe mbështetje teknike.
- Krijimi i një sistemi të qartë dhe efikas të mbështetjes teknike për shkollat, qoftë përmes specialistëve përkatës në nivel shkolle/rajoni,



qoftë përmes linjave të mbështetjes online, për të adresuar problemet teknike.

Sfidat e trajnimit dhe zhvillimit profesional:

Pavarësisht përpjekjeve të ndërmarra për të ofruar trajnime për mësuesit në fushën e kompetencave digjitale, disa sfida të rëndësishme vazhdojnë të ekzistojnë, duke penguar efektivitetin e këtyre nismave dhe zhvillimin e qëndrueshëm të kapaciteteve të mësuesve.

Një nga këto sfida është natyra e trajnimeve jo të mjaftueshme ose jo përkatëse. Shpesh, trajnimet e ofruara karakterizohen nga kohëzgjatje të shkurtra, mungesë të vazhdueshmërisë ose mospërputhshmëri me nevojat specifike të mësuesve. Kjo mund të rezultojë në një trajnim sipërfaqësor, i cili nuk arrin të thellohet në aspektet praktike të integritit të teknologjisë në mësimdhënie. Në mënyrë të veçantë, mund të konstatohet një mungesë e trajnimeve që përqendrohen në integrimin pedagogjik të teknologjisë, duke u përqendruar më tepër në mësimin e përdorimit të mjeteve specifike, sesa në aplikimin e tyre efektiv në rrethanat arsimore. Kjo qasje e kufizuar mund të mos i pajisë mësuesit me aftësitë e nevojshme për të shfrytëzuar potencialin e plotë të teknologjisë në përmirësimin e procesit mësimor.

Një sfidë tjetër e rëndësishme është mungesa e motivimit dhe angazhimit nga ana e disa mësuesve. Mund të ekzistojë një rezistencë ndaj ndryshimit ose një mungesë e motivimit për të investuar kohë dhe përpjekje në zhvillimin e kompetencave digjitale. Kjo mund të jetë rezultat i faktorëve të ndryshëm, siç janë mungesa e kohës së mjaftueshme për trajnime, mungesa e një kuptimi të qartë të përfitimeve të integritit të teknologjisë në mësimdhënie, ose frika nga teknologjia dhe ndjenja e pasigurisë në përdorimin e saj. Adresimi i kësaj sfide kërkon një qasje të shumëanshme, e cila përfshin rritjen e ndërgjegjësimit për vlerën e kompetencave digjitale, ofrimin e mbështetjes dhe inkurajimit për mësuesit, si dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për risi dhe eksperimentim.

Së fundi, duhet të njihet ekzistenca e dallimeve në nivelet e kompetencës digjitale midis mësuesve. Duke ardhur nga përvoja të ndryshme me teknologjinë, mësuesit paraqesin nivele të ndryshme të aftësive digjitale. Kjo ndryshueshmëri kërkon që trajnimet të jenë të diferencuara dhe të personalizuar, në mënyrë që të adresojnë në mënyrë efektive nevojat e secilit. Trajnimet duhet të ofrojnë mundësi për të gjithë mësuesit, nga fillestarët që kanë nevojë



për një hyrje në konceptet bazë të teknologjisë, deri tek përdoruesit e përparuar që kërkojnë të thellojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në fusha specifike. Një qasje e tillë do të sigurojë që trajnimet të jenë relevante dhe të dobishme për të gjithë pjesëmarrësit, duke rritur kështu ndikimin e tyre në zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve.

Strategjitë për adresimin e sfidave:

- Ofrimi i aktiviteteve trajnuese të planifikuara për kohëzgjatje të mjaftueshme, me vëmendje të theksuar në aplikimin praktik të teknologjisë në kontekstin pedagogjik dhe me mundësi për ndjekje dhe thellim të vazhdueshëm.
- Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuere që theksojnë përfitimet konkrete të kompetencave digjitale për mësuesit dhe nxënësit.
- Krijimi i sistemeve të motivimit, përfshirë njohjen e arritjeve, mundësitë për zhvillim karriere dhe përfshirjen në rrjete profesionale.
- Ofrimi i veprimtarive trajnuese të diferencuara, të përshtatura sipas niveleve ekzistuese të kompetencave digjitale të mësuesve, duke siguruar që çdo mësues të marrë mbështetjen e nevojshme për përparim.
- Krijimi i një grupi trajnerësh (TOT) specialistë në TIK dhe pedagogji digjitale, të cilët mund të përcjellin njohuritë dhe të ofrojnë mbështetje të vazhdueshme në nivel shkolle dhe ZVAP-je/DRAP-i.

Sfidat metodologjike dhe të vlerësimit:

Vetë procesi i vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve paraqet disa sfida metodologjike që kërkojnë vëmendje të kujdesshme dhe strategji të përshtatshme për t'u zbutur. Një nga këto sfida është subjektiviteti në vlerësim. Vlerësimi i kompetencave digjitale, veçanërisht kur përfshin vlerësimin e produkteve të punës ose praktikave të mësimdhënies, mund të jetë i ndjeshëm ndaj interpretimeve subjektive. Kjo mund të cenojë objektivitetin dhe besueshmërinë e rezultateve të vlerësimit. Për të zvogëluar subjektivitetin, është e domosdoshme të përcaktohen kritere të qarta dhe të standardizuara për vlerësim, si dhe të



ofrohet trajnim i duhur për vlerësuesit. Trajnimi duhet të përqendrohet në zhvillimin e një kuptimi të përbashkët të kritereve të vlerësimit dhe në sigurimin e vijueshmërisë në zbatimin e tyre.

Një sfidë tjetër e dukshme është vështirësia në matjen e ndikimit në nxënie. Në fund të fundit, qëllimi kryesor i integritetit të teknologjisë në arsim është përmirësimi i rezultateve të nxënësve. Megjithatë, matja e drejtpërdrejtë e ndikimit të kompetencave digjitale të mësuesve në nxënien e nxënësve paraqitet si një detyrë e ndërlikuar. Kjo vështirësi buron nga fakti se nxënia e nxënësve është një dukuri shumëfaktoriale, i cili ndikohet nga një sërë variablash të ndryshme, përveç kompetencave digjitale të mësuesve. Faktorë të tillë si motivimi i nxënësve, stilet e të nxënësve, mjedisi familjar dhe burimet e disponueshme arsimore mund të luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në rezultatet e nxënies. Për rrjedhojë, izolimi dhe matja e ndihmesës specifike të kompetencave digjitale të mësuesve në të nxënin e nxënësve kërkon metodologji kërkimore të përparuara dhe analiza të kujdesshme të të dhënave.

Strategjitë për adresimin e sfidave:

- Ofrimi i trajnimeve të thelluara për vlerësuesit (drejtuesit e shkollave, specialistët e ZVAP/DRAP), duke u siguruar atyre aftësitë për të aplikuar kriteret e vlerësimit në mënyrë të njëjtë dhe të paanshme.
- Përdorimi i një qasjeje me metoda të ndryshme vlerësimi (vetëvlerësim, vlerësim nga kolegët, vëzhgime në klasë, analiza e produkteve) për të marrë një pamje sa më të plotë dhe të balancuar të kompetencave.
- Theksimi i natyrës formuese të vlerësimit, duke përdorur rezultatet kryesisht si një mjet për të ofruar feedback konstruktiv dhe për të drejtuar zhvillimin profesional të mësuesve, në vend të një qëllimi përmbledhës.
- Angazhimi në monitorim të vazhdueshëm dhe kërkime për të zbuluar lidhjen midis rritjes së kompetencave digjitale të mësuesve dhe ndikimit në rezultatet e nxënies së nxënësve.



Sfidat kulturore dhe organizative:

Përveç sfidave të përmendura më parë, ekzistojnë edhe faktorë të tjerë rrethanorë dhe organizativë që mund të ndikojnë ndjeshëm në procesin e vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve.

Së pari, kultura e shkollës luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin ose pengimin e integritetit të teknologjisë në mësimdhënie dhe, rrjedhimisht, në zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve. Një kulturë shkollore që vlerëson risinë, bashkëpunimin dhe eksperimentimin krijon një mjedis të favorshëm për mësuesit të hulumtojnë dhe të përdorin teknologjinë në mënyra të reja dhe efektive. Në një mjedis të tillë, mësuesit janë më të prirur të ndajnë praktikën e mira, të marrin pjesë në trajnime dhe të angazhohen në zhvillim profesional të vazhdueshëm. Në të kundërt, një kulturë shkollore që është rezistente ndaj ndryshimit, që i përmbahet metodave tradicionale të mësimdhënies ose që nuk ofron mbështetje për përdorimin e teknologjisë, mund të pengojë përparimin e mësuesve në këtë fushë.

Së dyti, drejtori i shkollës ushtron një ndikim me peshë në përkrahjen e përdorimit efektiv të teknologjisë dhe në krijimin e një mjedisi mbështetës për zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve. Drejtuesit e shkollave duhet të jenë të angazhuar aktivisht në këtë proces, të informuar për përfitimet e integritetit të teknologjisë dhe të gatshëm të ofrojnë mbështetje të vazhdueshme për mësuesit. Kjo mbështetje mund të marrë formë të ndryshme, siç janë shpërndarja e burimeve të nevojshme, krijimi i mundësive për zhvillim profesional, nxitjen e bashkëpunimit midis mësuesve dhe njohja e arritjeve në përdorimin e teknologjisë.

Së treti, ngarkesa e punës së mësuesve paraqet një sfidë të rëndësishme për zhvillimin e kompetencave digjitale. Mësuesit shpesh përballen me një sasi të madhe detyrash, duke përfshirë planifikimin e orëve mësimore, vlerësimin e nxënësve, komunikimin me prindërit dhe pjesëmarrjen në veprimtari të ndryshme shkollore. Kjo ngarkesë e tepërt mund të lërë pak ose aspak kohë për mësuesit që të marrin pjesë në trajnime, të eksperimentojnë me teknologjinë në klasë ose të reflektojnë mbi praktikën e tyre mësimore. Për të adresuar këtë sfidë, është e nevojshme të shqyrtohen mënyra për të lehtësuar ngarkesën e punës së mësuesve, për shembull, duke ofruar mbështetje shtesë, duke thjeshtuar detyrat administrative ose duke krijuar mundësi për bashkëpunim dhe ndarje të punës midis mësuesve.



Strategjitë për adresimin e sfidave:	▶ Përkrahja e një kulture shkollore që vlerëson dhe mbështet risinë digjitale dhe bashkëpunimin mes mësuesve. Kjo mund të arrihet përmes nismave të drejtorit, programeve të mentorimit dhe krijimit të komuniteteve të praktikës. ▶ Fuqizimi i drejtorëve të shkollave si udhëheqës digjitalë, duke u ofruar atyre trajnime specifike mbi menaxhimin e TIK-ut në shkollë dhe përkrahjen e kulturës digjitale mes stafit. ▶ Identifikimi i mënyrave për të krijuar hapësirë për zhvillim profesional dhe eksperimentim me teknologjinë, duke përfshirë thjeshtimin e burokracisë dhe ndarjen e detyrave. ▶ Krijimi i sistemeve të njohjes dhe shpërblimit (jo domosdoshmërisht monetare) për mësuesit që angazhohen aktivisht në zhvillimin e kompetencave digjitale dhe përdorimin efektiv të teknologjisë në mësimdhënie.
---	--

Rreziqet e interpretimit dhe përdorimit të rezultateve:

Është e domosdoshme të ushtrohet kujdes i veçantë në procesin e interpretimit dhe përdorimit të rezultateve të vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve, në mënyrë që të sigurohet një qasje etike dhe konstruktive.

Së pari, rezultatet e vlerësimit duhet të interpretohen me kujdes dhe në rrethanat përkatëse. Është e rëndësishme të shmangët çdo formë e interpretimit subjektiv ose keqinterpretimit të të dhënave, duke njohur vështirësinë e procesit të vlerësimit dhe faktorët e ndryshëm që mund të ndikojnë në rezultate. Rezultatet e vlerësimit nuk duhet të përdoren për të etiketuar ose gjykuar mësuesit në mënyrë negative, por përkundrazi, duhet të shërbejnë si një mjet për të identifikuar nevojat specifike për zhvillim profesional dhe për të ofruar mbështetje të personalizuar për përmirësimin e kompetencave digjitale.

Së dyti, rezultatet e vlerësimit nuk duhet të përdoren për qëllime ndëshkuese. Përdorimi i rezultateve të vlerësimit për të vlerësuar performancën e mësuesve për qëllime shpërblimi ose



ndëshkimi mund të krijojë një mjedis të tensionuar dhe të dëmtojë motivimin e mësuesve për t'u angazhuar në zhvillim profesional.

Përkundrazi, rezultatet e vlerësimit duhet të përdoren si një burim informacioni për të informuar vendimmarrjen në nivel shkolle dhe në nivel më të gjerë arsimor, me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet integritetit efektiv të teknologjisë.

Kjo qasje e dobishme do të ndihmojë në krijimin e një kulture të përmirësimit të vazhdueshëm dhe do të mbështetë zhvillimin e kompetencave digjitale të mësuesve si një proces pozitiv dhe përkrahës.

<i>Strategjitë për adresimin e sfidave:</i>	▸ Sigurimi i transparencës sa më të madhe në lidhje me qëllimin e vlerësimit, metodologjinë dhe mënyrën se si do të përdoren rezultatet. Komunikimi i qartë me mësuesit se vlerësimi është për qëllime zhvillimore, jo ndëshkuese. ▸ Krijimi i një kulture ku feedback-u i bazuar në rezultatet e vlerësimit është i detajuar, specifik, dhe i orientuar drejt përmirësimit, duke theksuar pikat e forta dhe duke ofruar sugjerime konkrete për zhvillim. ▸ Përdorimi i rezultateve të vlerësimit si bazë për të hartuar plane zhvillimi profesional individuale për çdo mësues, duke adresuar nevojat e identifikuar. ▸ Sigurimi i fshehtësisë së të dhënave të vlerësimit dhe respektimi i ligjeve për mbrojtjen e të dhënave personale, duke ndërtuar besim te mësuesit
--	---

Vlerësimi i kompetencave digjitale të mësuesve paraqet sfida të mjaftueshme, por edhe mundësi të mëdha për të përmirësuar cilësinë e arsimit. Duke njohur dhe adresuar këto sfida në mënyrë paraprake, mund të sigurojmë që procesi i vlerësimit të jetë i drejtë, i besueshëm dhe i dobishëm për të gjithë të interesuarit. Kjo kërkon një qasje tërësore, që përfshin investime në infrastrukturë, trajnime të vazhdueshme dhe mbështetje për mësuesit, si dhe një kulturë shkollore që vlerëson risinë dhe bashkëpunimin.



PËRKUFIZIMET DHE TERMINOLOGJIA

Për të garantuar qartësi dhe kuptueshmëri, në këtë dokument përkufizohen disa terma kyç, me qëllim që të sigurohet një interpretim dhe zbatim i njëtrajtshëm i vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve në arsimin parauniversitar.

Aftësi digjitale (Digital Skills): Aftësitë praktike dhe funksionale të nevojshme për të përdorur teknologjitë digjitale dhe mjetet e tyre për të kryer detyra specifike (p.sh., përdorimi i softuerit të prezantimit, dërgimi i një emaili, redaktimi i një dokumenti, kërkimi në internet).

Angazhimi profesional digjital: Përdorimi i teknologjive dhe platformave digjitale nga mësuesit për zhvillimin e tyre profesional të vazhdueshëm, komunikimin, bashkëpunimin me kolegët dhe prindërit, pjesëmarrjen në rrjete profesionale online, shkëmbimin e burimeve dhe praktikave më të mira, si dhe kontributin në komunitetin arsimor.

Arsimi i hapur (Open Education): Një filozofi dhe praktikë arsimore që promovon qasje të lirë dhe të hapur në burime, mjete dhe praktika edukative, duke shfrytëzuar potencialin e teknologjive digjitale për të rritur aksesin dhe barazinë në arsim.

Mësimdhënie e përzier (Blended Learning): Një qasje e përshtatshme e të nxënit që ndërthur elemente të mësimdhënies dhe të të nxënit tradicional në mjedise fizike (klasa) me veprimtari të të nxënit në distancë (online), duke shfrytëzuar teknologjitë digjitale për të përmirësuar përvojën arsimore.

Burime arsimore të hapura (OER - Open Educational Resources): Materiale mësimore, burime kërkimore ose përmbajtje të tjera edukative të cilat janë në hapësira publike ose janë certifikuar nën një licencë të hapur, duke lejuar përdorimin, modifikimin dhe shpërndarjen e tyre të lirë dhe pa pagesë.

Burime digjitale: Materiale dhe informacione në format elektronik (si tekste, imazhe, audio, video, animacione, simulime, aplikacione, platforma etj.) në të cilat mund të hyhet në internet, të shkarkohen, të modifikohen ose të përdoren përmes teknologjisë për qëllime mësimdhënieje, të nxëni, kërkimi ose qëllime të tjera profesionale.



Cilësia e Informacionit digjital: Karakteristikat e informacionit që gjendet në mjedisin digjital, të cilat e bëjnë atë të besueshëm, të saktë, aktual, të vlefshëm, objektiv dhe të përshtatshëm për qëllimin e caktuar.

DigCompEdu: Korniza Evropiane për Kompetencën Digjitale të Edukatorëve. Është një mjet referencë që përshkruan 6 fusha kyçe dhe nivele të ndryshme të kompetencave digjitale që edukatorët (përfshirë mësuesit) duhet të zotërojnë për të përdorur teknologjinë në mënyrë efektive në praktikën e tyre profesionale.

E-learning: Mësimi përmes internetit, i cili realizohet plotësisht ose pjesërisht nëpërmjet teknologjive digjitale dhe internetit, shpesh duke përdorur platforma dhe burime online.

Etika digjitale: Parimet morale dhe vlerat që udhëheqin sjelljen e përgjegjshme, të ndershme dhe respektuese gjatë përdorimit të teknologjive digjitale, duke përfshirë çështjet e privatësisë, sigurisë, të drejtave të autorit, pronësisë intelektuale dhe ndikimit social.

Fusha e kompetencës (Competence area): Një grup i madh dhe i veçantë i kompetencave të lidhura së bashku, të cilat përbëjnë një dimension të veçantë të një kornize kompetencash. DigCompEdu, për shembull, ndahet në 6 fusha kompetencash për edukatorët.

Kompetenca digjitale (e mësuesit): Tërësia dinamike e njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave që një mësues duhet të zotërojë dhe të zbatojë me siguri, në mënyrë kritike, etike dhe përgjegjëse, përmes teknologjive digjitale. Kjo përfshin aftësinë për të integruar efektivisht mjetet dhe burimet digjitale në të gjitha dimensionet e profesionit arsimor: nga planifikimi dhe zhvillimi kurrikular, mësimdhënia dhe vlerësimi, te komunikimi, bashkëpunimi, zhvillimi profesional i vazhdueshëm dhe promovimi i qytetarisë digjitale tek nxënësit.

Mësimdhënia dhe të nxënit e pajisur me teknologji: Një qasje pedagogjike që integron qëllimisht teknologjitë digjitale për të përmirësuar, pasuruar dhe transformuar proceset e mësimdhënies, të nxënit dhe vlerësimit. Kjo shkon përtej përdorimit thjesht instrumental të teknologjisë, duke theksuar aplikimin e saj pedagogjik dhe transformues.

Mjet digjital: Çdo program softuerik, aplikacion, platformë online, pajisje elektronike ose instrument tjetër teknologjik që lehtëson kryerjen e detyrave, përpunimin e informacionit, komunikimin ose krijimin e përmbajtjes (p.sh., platformat LMS, softuerët për prezantime, aplikacionet edukative, tabletët, laptopët, tabelat interaktive).



Model i progresionit (Progression model): Një përshkrim i niveleve të ndryshme të zhvillimit dhe zotërimit të një kompetence, duke treguar një rrugëtim nga niveli fillestar drejt atij më të avancuar (p.sh., 6 nivelet e DigCompEdu: A1, A2, B1, B2, C1, C2).

Mjedis virtual i të nxënit (VLE - Virtual Learning Environment): Sistem online që ofron mjete dhe burime për mësimdhënie, të nxënë dhe menaxhim të kurseve. Shpesh përdoret si sinonim i Platformave të Menaxhimit të të Nxënit (LMS), por mund të ketë një shtrirje më të gjerë.

Mësim i personalizuar (Personalized Learning): Një qasje arsimore që përshtat mësimin me nevojat, interesat, pëlqimet dhe ritmin individual të çdo nxënësi, shpesh duke shfrytëzuar teknologjitë digjitale për të ofruar përmbajtje, veprimtari dhe vlerësim të diferencuar.

Mirëqenia digjitale: Aspekti i shëndetit fizik, mendor dhe emocional i lidhur me përdorimin e teknologjive digjitale. Përfshin menaxhimin e kohës para ekranit, mbrojtjen nga përmbajtjet e dëmshme, ndërgjegjësimin për privatësinë, menaxhimin e varësisë digjitale dhe përkrahjen e barazpeshës midis jetës online dhe asaj offline. Për mësuesit, kjo përfshin si mirëqenien e tyre vetjake, ashtu edhe aftësinë për të ndihmuar nxënësit të arrijnë mirëqenien digjitale.

Platformë e menaxhimit të të nxënit (LMS - Learning Management System): Sistem softuerik i bazuar në ueb, i projektuar për të administruar, dokumentuar, gjurmuar, raportuar dhe shpërndarë kurse edukative ose programe trajnimi. LMS-të u mundësojnë mësuesve të ngarkojnë materiale, të krijojnë detyra, të administrojnë kuize, të komunikojnë me nxënësit dhe të monitorojnë progresin e tyre (p.sh., Google Classroom, Moodle, Microsoft Teams).

Privatësia digjitale: E drejta dhe aftësia e individëve për të kontrolluar mbledhjen, përdorimin dhe shpërndarjen e të dhënave të tyre personale dhe informacioneve të tjera në mjedisin digjital.

Qytetaria digjitale: Tërësia e normave të sjelljes së përshtatshme, etike dhe përgjegjshme kur përdoret teknologjia. Kjo përfshin etikën online, të drejtat dhe përgjegjësitë digjitale, respektin për pronësinë intelektuale, sigurinë personale dhe pjesëmarrjen pozitive e konstruktive në komunitetet online.

Realiteti i shtuar (AR - Augmented Reality): Një teknologji që mbivendos informacionin digjital (imazhe, tinguj, të dhëna) mbi botën reale, duke e pasuruar perceptimin e përdoruesit për mjedisin fizik.



Realiteti virtual (VR - Virtual Reality): Një teknologji që krijon një mjedis virtual të krijuar nga kompjuteri, tërësisht simulues, në të cilin përdoruesi mund të zhytet plotësisht dhe të ndërveprojë, shpesh duke përdorur pajisje të veçanta si kufjet VR.

Robotika arsimore: Përdorimi i robotëve dhe sistemeve robotike si mjete edukative për të nxitur të nxënit interaktiv, zhvillimin e aftësive shkencore, teknologjike, inxhinierike dhe matematikore (STEM), si dhe aftësitë e zgjidhjes së problemeve dhe programimit.

Siguria digjitale: Mbrojtja e sistemeve, rrjeteve, pajisjeve dhe të dhënave digjitale nga qasja e paautorizuar, dëmtimi, modifikimi ose vjedhja. Për mësuesit, kjo përfshin gjithashtu përgjegjësinë për të edukuar nxënësit mbi praktikën e sigurta dhe të përgjegjshme në mjediset online (p.sh., mbrojtja nga viruset, mashtrimet, bullizmi kibernetik).

Simulime arsimore: Përdorimi i programeve kompjuterike ose mjediseve virtuale për të riprodhuar situata, procese ose sisteme reale, duke u ofruar nxënësve dhe mësuesve përvoja të nxëni ndërvepruese dhe praktike në një mjedis të sigurt dhe të kontrolluar.

Teknologji arsimore (EdTech - Educational Technology): Fusha që merret me studimin dhe zbatimin e mjeteve, metodave dhe proceseve teknologjike për të përmirësuar mësimdhënien, të nxënit dhe menaxhimin arsimor.

Vlerësim digjital: Përdorimi i mjeteve, platformave dhe metodave digjitale për të mbledhur, analizuar dhe interpretuar të dhëna rreth të nxënit të nxënësve ose performancës së mësuesve, si dhe për të ofruar reagime (feedback). Kjo mund të përfshijë teste online, kuize ndërvepruese, rubrika digjitale, portofol elektronik dhe mjete monitoruese.

Prirjet globale në digjitalizimin e arsimit

Disa pritje globale po formësojnë peizazhin e digjitalizimit të arsimit dhe po ndikojnë në nevojat për kompetenca digjitale të mësuesve.

Mësimi i Përzier (Blended Learning): Ndërthurja e mësimit ballë për ballë me mësimin në distancë (online) po bëhet gjithnjë e më i zakonshëm. Kjo kërkon që mësuesit të jenë të aftë të ndërtojnë dhe të lehtësojnë mjedise mësimore të përziera që shfrytëzojnë mundësitë e teknologjisë.



Teoria e të nxënit të personalizuar (Personalized Learning Theory): Kjo teori thekson rëndësinë e përshtatjes së mësimimit me nevojat, interesat dhe ritmin individual të çdo nxënësi. Mësuesit duhet të jenë të aftë të përdorin teknologjinë për të mbledhur dhe analizuar të dhënat e nxënësve, për të ofruar udhëzime të diferencuara dhe për të mbështetur vetërregullimin e nxënësve. Teknologjia mund të ndihmojë në personalizimin e mësimimit duke ofruar burime të ndryshme, veprimtari të përshtatura dhe rrugë të ndryshme të të nxënit.

Modeli TPACK (Technological Pedagogical Content Knowledge): Ky model thekson rëndësinë e integritetit të njohurive teknologjike, pedagogjike dhe të përmbajtjes për një mësimdhënie efektive me teknologji. Mësuesit duhet të kenë njohuri të thella për lëndën që japin, për metodat pedagogjike të mësimdhënies dhe për mënyrën se si teknologjia mund t'i mbështesë këto dyja.

Teoria e të nxënit social (Social Learning Theory): Kjo teori thekson rëndësinë e bashkëpunimit dhe ndërveprimit social në procesin e të nxënit. Teknologjia mund të lehtësojë bashkëpunimin midis nxënësve dhe mësuesve, duke krijuar një mjedis mësimor më interaktiv dhe tërheqës.

Teoria e të nxënit të vetërregulluar (Self-Regulated Learning Theory): Kjo teori thekson rëndësinë e aftësisë së nxënësve për të planifikuar, monitoruar dhe vlerësuar procesin e tyre të të nxënit. Teknologjia mund të ndihmojë nxënësit të zhvillojnë aftësitë e vetë-rregullimit duke ofruar mjete për të ndjekur përparimin e tyre, për të marrë reagimin (feedback-un) dhe për të reflektuar mbi të nxënit e tyre.

Teoria e të nxënit të bazuar në projekte (Project-Based Learning Theory): Kjo teori thekson rëndësinë e të nxënit përmes projekteve sfiduese dhe tërheqëse që i angazhojnë nxënësit në zgjidhjen e problemeve reale. Teknologjia mund të mbështesë mësimin e bazuar në projekte duke u ofruar nxënësve mjete për të bashkëpunuar, për të komunikuar, për të krijuar dhe për të ndarë punën e tyre. Mësuesit duhet të jenë të aftë të lehtësojnë projektet që shfrytëzojnë potencialin e teknologjisë.

Vlerësimi i vërtetë: Teknologjia ofron mundësi për të vlerësuar nxënësit në mënyra më të vërteta dhe kuptimplote, si p.sh., përmes portofoleve digjitale, simulimeve dhe projekteve. Mësuesit duhet të jenë të aftë të përdorin teknologjinë për të përgatitur dhe zbatuar vlerësime të vërteta.



Zhvillimi profesional në distancë: Teknologjia ofron mundësi për zhvillim profesional të vazhdueshëm për mësuesit, si p.sh., përmes kurseve në distancë (online), komuniteteve të praktikës dhe burimeve të hapura arsimore. Mësuesit duhet të jenë të aftë të angazhohen në

Inteligjenca Artificiale (IA - Artificial Intelligence): Një degë e shkencës kompjuterike që zhvillon sisteme dhe programe të afta të kryejnë detyra që normalisht kërkojnë inteligjencë njerëzore, si të mësuarit, zgjidhja e problemeve, perceptimi dhe të kuptuarit e gjuhës natyrore. Në arsim, IA shërben si një mjet për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënit, duke e pasuruar atë, pa zëvendësuar rolin e mësuesit.



BAZA LIGJORE

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Bashkimit Evropian, të përfaqësuar nga Komisioni, për rregullimet specifike për zbatimin e mbështetjes së Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të facilitetit për reforma dhe rritje”.
- Plani kombëtar i veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2021-2025).
- Strategjia digjitale e edukimit dhe plani i veprimit 2025-2029.
- Vendimi nr. 733, datë 20.10.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore dhe të planit të veprimit”.
- Vendimi nr. 98, datë 27.02.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)”.
- Vendimi nr. 99, datë 27.02.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, mënyrën e organizimit e funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar (DPAP)”.
- Vendimi nr. 276, datë 12.5.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025”.
- Vendimi nr. 621, datë 22.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe planin e veprimit për zbatimin e saj”.
- VKM-së Nr. 621, datë 10.10.2024, “Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda kombëtare e reformave 2024–2027”.
- VKM-në Nr. 252, datë 02.05.2025, “Për përcaktimin e funksioneve, të përgjegjësisë e të marrëdhënieve midis autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin, sipas parashikimeve të marrëveshjes së facilitetit.



- Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Udhëzim nr. 15, datë 12.07.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar.
- Udhëzimi nr. 26, datë 02.08.2013, “Për përcaktimin e detyrave dhe funksioneve të Këshillit të Mësuesve”.
- Udhëzimi nr. 30, datë 02.08.2013, “Për rregulloren Tip të institucioneve arsimore”.
- Udhëzimi nr. 43, datë 21.08.2013, “Për planifikimin e fondeve buxhetore, prokurimin dhe blerjen e mjeteve mësimore për institucionet arsimore publike”.
- Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014, “Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë”.
- Udhëzimi nr. 10, datë 25.02.2015, katërministror midis Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Shëndetësisë “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik, për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës”.
- Udhëzimi nr. 12, datë 27.04.2015 “Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe nxënësve, si dhe përmbajtjen e dosjeve të tyre personale”, i ndryshuar.
- Udhëzim nr. 25, datë 25.07.2018, “Për ngritjen dhe funksionimin e Bordit të institucionit arsimor”.
- Udhëzimi nr. 34, datë 16.11.2018, “Për ndalimin e telefonit celular në institucionet arsimore parauniversitare”.
- Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019, “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.
- Udhëzimi nr. 12, datë 10.06.2021, “Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 23, datë 1.12.2021; nr. 28 datë 3.8.2022 dhe nr. 17, datë 26.7.2023.
- Udhëzimi nr. 10, datë 06.05.2022, i ministrit të Arsimit dhe Sportit, “Për ngritjen, funksionimin dhe zhvillimin profesional të rrjetit kombëtar të monitoruesve, vlerësuesve dhe vlerësuesve me bazë risku për institucionet arsimore parauniversitare”.
- Udhëzimi nr. 2, datë 08.02.2023. “Për kriteret dhe procedurat e kualifikimit të mësuesve”.



- Udhëzimi nr. 22, datë 13.11.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për emërimin, uljen në detyrë, pezullimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe nëndrejtorit të institucionit publik arsimor parauniversitar”.
- Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, për “Numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- Udhëzimi nr. 16, datë 22.07.2024, “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimorë”.
- Urdhër nr. 313, datë 20.10.2020, “Për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit psiko-social, në institucionet e arsimit parauniversitar dhe procedurat e emërimit, pezullimit dhe largimit në shërbimin psiko-social”.
- Urdhër nr. 100, datë 25.2.2022, “Për organizimin dhe zhvillimin e praktikave profesionale për profesionin e rregulluar të mësuesit”.
- Memorandumi i Bashkëpunimit nr. 363 prot., datë 25.1.2016 dhe nr. 600 prot., datë 25.1.2016, “Për edukimin mbi dhe përmes arteve dhe trashëgimisë”, ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.



BURIME DHE REFERENCA

- ASCAP - Standardet profesionale të mësuesit për përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe-të komunikimit: <https://www.ascap.edu.al/standardet-profesionale-te-mesuesit-per-perdorimin-e-teknologjise-se-informacionit-dhe-te-komunikimit/>;
- ASCAP- Manuali-i-trajnit-për-ICT: <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2020/10/FINAL-MANUALI-I-TRAJNIMIT-PER-ICT-16.03.2021-1.pdf>
- Aftësitë praktike digjitale për mësuesit-e-shkollave në Kosovë: <file:///C:/Downloads/07-Report-ToT-mbi-aftesite-praktike-digjitale-per-mesuesit-e-shkollave-ne-kosove-01.pdf>;
- ISTE STANDARDS: file:///C:/ISTE_STANDARDS_2024.pdf;
- UNESCO ICT - Korniza e kompetencave për mësuesit: https://teachertaskforce.org/sites/default/files/2020-07/ict_framework.pdf;
- DigCompEdu: Korniza evropiane për kompetencën digjitale të edukatorëve: <https://publications.jrc.ec.europa.eu/repository/handle/JRC107466>;
- UNESCO ICT- *Korniza e kompetencave për mësuesit*, 2018 https://teachertaskforce.org/sites/default/files/2020-07/ict_framework.pdf;
- Information and Communication Technology - Vazhdimësia e të mësuarit të aftësive: <https://www.australiancurriculum.edu.au/media/1074/general-capabilities-information-and-communication-ict-capability-learning-continuum.pdf>;
- Briefing on ICT - *Standardet e Kompetencës*; https://www.unapcict.org/sites/default/files/2018-12/Briefing%20on%20ICT%20Competency%20Standards_FINAL.pdf;
- The Department of Education and Training of Western Australia – *Korniza e kompetencave për mësuesit*: <https://www.education.wa.edu.au/dl/oj1qqk2>;
- Komisionit për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve – *Plani i veprimit të arsimit digjital*: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52018SC0012>
- DIGITAL COMPETENCY FRAMEWORK: https://www.education.gouv.qc.ca/fileadmin/site_web/documents/ministere/Cadre-reference-competence-num-AN.pdf;
- EDUCATORS' DIGITAL COMPETENCY FRAMEWORK <https://www.unicef.org/eca/media/24526/file/Educators%20Digital%20Competence%20Framework.pdf>



- Digital Competence in Teacher Education: <https://dicte.oslomet.no/wp-content/uploads/sites/1188/2019/03/DICTE-Digital-Competence-in-Teacher-Ed.-literature-review.pdf>;
- Common digital competence framework for teachers: https://aprende.intef.es/sites/default/files/2018-05/2017_1024-Common-Digital-Competence-Framework-For-Teachers.pdf;
- Professional development framework for digital learning <https://www.education.gov.za/Portals/0/Documents/Publications/Digital%20Learning%20Framework.pdf?ver=2018-07-09-101748-953>;
- Digital Competence Framework for Teachers: https://www.udir.no/globalassets/filer/in-english/pfdk_framework_en_low2.pdf Professional
- Digital teaching professional framework Full reference guide: <https://www.et-foundation.co.uk/wp-content/uploads/2024/10/ETF-DTPF-Full.pdf>
- Australia: ICT Competency Framework for Teachers https://www.unapcict.org/sites/default/files/2018-12/Briefing%20on%20ICT%20Competency%20Standards_FINAL.pdf
- Dutch ICT Knowledge Base. <https://www.european-agency.org/sites/default/files/Netherlands.pdf>
- Teachers Competencies and Qualifications Framework for EU countries <https://europass.europa.eu/system/files/2020-05/EQF%20Brochure-EN.pdf>
- Chris Dede . *Implications of New Media for K-12 Education, Virtual Communities.* <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED561254.pdf>
- *Computer Technology Standards of Learning for Virginia's Public Schools:* www.doe.virginia.gov/.../standards.../computer_technology/;
- Georgia Technology Standards for Educators. <https://www.gapsc.com/EducatorPreparation/Downloads/Documents/OldTechStandards.pdf>
- International Federation for Information Processing. <https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/sof-international-fed-info-processing-input-zero-draft-pact-for-future.pdf>
- *Technology Standards For All Teachers:* www.castletechnology.com/CPS/.../techstrand/techstrand.html;



- UNESCO: Technology in education <https://www.ictworks.org/wp-content/uploads/2021/11/unesco-technology-in-education.pdf>
- Les Foltos, Director, K-12 Program. *Technology and Academic Achievement, Technology and Learning: Two Pieces of the Puzzle*. Puget Sound Center for Teaching, Learning and Technology
- Louisiana Department of Education , *Louisiana K-12 Educational Technology Standards*: http://www.doe.state.la.us/divisions/tech/technology_standards.html;
- Muthu Kuma. *Learning with the Internet*. Senior Officer for the Centre for Research in Pedagogy and Practice at Nanyang Technological University, Singapore.
- *National ICT competency standards (NICS) for teachers*. (Tetor 2006): <http://www.nc.gov.ph/nics/files/NICS-Teachers>;
- *Ohio Standards for the Teaching Profession*: www.tygerpride.com/uploaded/.../Ohio_Teacher_Standards;
- Res. Ass. Tuba Gokçek, Karadeniz. *Standards for implementation of ict's (information and communication technologies) in teacher education*.
- *Teaching with Technology*, Chapman University College California Technology Standards for Teachers, Approved on May 5, 2000.
- Computer Technology Standards of Learning for Virginia's Public Schools, June 22, 2005. <https://files.eric.ed.gov/fulltext/ED498209.pdf>
- *International Society for Technology in Education* (U.S. & Canada): <http://www.iste.org>;
- Education Development Center. IT Career Cluster Initiative Foundation Knowledge and Skills. Ohio Department of Education. <https://careertech.org/wp-content/uploads/sites/default/files/K%26S-CareerCluster-IT-2008.pdf>
- Georgia Technology Standards for Educators. <https://www.gapsc.com/EducatorPreparation/Downloads/Documents/OldTechStandards.pdf>
- IFIP . Curriculum Professional Development of Teachers. <http://www.edu.ge.ch/cptic/prospective/projets/unesco/en/teachers.html>;
- International Computer Driving License Syllabus https://www.ecdl.ch/fileadmin/ECDL/CH/Dokumente/English/Syllabus_ECDL_Standard_e_web.pdf
- Version 4.0. Dublin 4, Ireland. European Computer Driving License: Foundation Ltd.
- ISBE: Technology Standards For All Teachers.



- Muthu Kuma. Learning with the Internet. Senior Officer for the Centre for Research in
- Pedagogy and Practice at Nanyang Technological University, Singapore.
- ISTE: National Educational Technology Standards for Teachers (NETS-T)



SHTOJCA

Instrumenti i vlerësimit/vetëvlerësimit

Ky instrument është një mjet gjithëpërfshirës dhe fleksibël për vlerësimin e kompetencave digjitale. Ai i shërben në radhë të parë mësuesit për *vetëvlerësimin* e nivelit individual të këtyre kompetencave. Ky proces i vetëvlerësimit, duke përdorur të njëjtin instrument, është një gur themeli i *vlerësimit të brendshëm të shkollës*. Ai ndihmon në krijimin e një pasqyre të qartë dhe objektive të pikave të forta dhe fushave për përmirësim jo vetëm në nivel individual, por edhe kolektiv. Të dhënat e grumbulluara nga vetëvlerësimi bëhen pjesë integrale e procesit të vlerësimit të brendshëm, duke ndihmuar shkollën të hartojë strategji zhvillimore të mirëinformuara dhe të përshtatura me nevojat reale të mësuesve.

Përveç kësaj, ky instrument përdoret nga drejtori i shkollës për *vlerësimin e performancës së mësuesit*, duke ofruar një bazë objektive për zhvillimin profesional.

Po ashtu, i njëjti instrument përdoret nga *institucionet vlerësuese në proceset e tyre të monitorimit dhe vlerësimit të jashtëm*, duke u përshtatur me fokusin specifik të çdo vlerësimi për të siguruar të dhëna të besueshme dhe të vlefshme.

Fusha 1: Angazhimi profesional					
Treguesit	Përshkruesit	Nivelet e vlerësimit			
		1	2	3	4
1.1. Mësuesi përdor në mënyrë efektive teknologjinë e informacionit për të komunikuar dhe	1.1.1. Mësuesi përdor platforma dhe mjete digjitale (e-mail, rrjete sociale profesionale, platforma bashkëpunimi) për të komunikuar qartë, në kohë dhe me respekt me kolegët, nxënësit dhe prindërit.				
	1.1.2. Mësuesi përshtat stilin dhe mjetin e komunikimit digjital sipas audiencës, qëllimit				

bashkëpunuar me kolegët, nxënësit, prindërit dhe komunitetin e gjerë, duke ndërtuar marrëdhënie të shëndetshme dhe duke nxitur një mjedis arsimor bashkëpunues.	dhe mundësive të palëve (p.sh., ofron alternativa për qasje të kufizuar në internet).				
	1.1.3. Mësuesi merr pjesë dhe ndihmon aktivisht në bashkëpunime online me kolegët (brenda/jashtë shkollës) për shkëmbimin e ideve, burimeve dhe praktikave të mira, duke përdorur mjete bashkëpunimi.				
	1.1.4. Mësuesi shfaq etikë profesionale dhe sjellje të përgjegjshme në të gjitha ndërveprimet digjitale, duke ndërtuar marrëdhënie pozitive dhe duke ruajtur të dhënat vetjake dhe privatësinë.				
Vlerësimi i treguesit: $((P^{17}1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					
1.2. Mësuesi angazhohet në zhvillimin profesional të vazhdueshëm duke shfrytëzuar teknologjinë.	1.2.1. Mësuesi ndjek rregullisht dhe angazhohet aktivisht në kurse online seminare web dhe veprimtari të tjera digjitale të zhvillimit profesional.				
	1.2.2. Mësuesi identifikon, vlerëson në mënyrë kritike dhe përdor burime arsimore të hapura (OER) dhe literaturë shkencore online për përmirësimin e kompetencave lëndore, pedagogjike dhe digjitale.				
	1.2.3. Mësuesi reflekton në mënyrë të vazhdueshme mbi praktikën e tij/saj profesionale duke përdorur mjete digjitale (blogje, platforma reflektimi, portofolin digjital) për të				

¹⁷ Niveli i vlerësimit të përshkruesit

	dokumentuar përparimin dhe për të marrë feedback.				
	1.2.4. Mësuesi është i vetëdijshëm për licencat e hapura (p.sh., Creative Commons) dhe të drejtat e autorit në kontekstin digjital, duke i respektuar dhe zbatuar ato gjatë përdorimit të materialeve dhe burimeve.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					
1.3. Mësuesi ndihmon në risinë pedagogjike dhe shfaq udhëheqjen në arsimin digjital.	1.3.1. Mësuesi është i hapur dhe eksperimenton me metoda të reja të mësimdhënies me teknologji, duke marrë parasysh rreziqe të llogaritura dhe duke mësuar nga rezultatet.				
	1.3.2. Mësuesi ndan në mënyrë të vetëdijshme praktikatat e mira dhe burimet e reja me kolegët, duke ndihmuar në zhvillimin e kurrikulave dhe materialeve mësimore të reja.				
	1.3.3. Mësuesi merr pjesë në projekte kombëtare ose ndërkombëtare që mbështetin rinisë në arsimin digjital, duke kërkuar vazhdimisht mundësi për zhvillim.				
	1.3.4. Mësuesi tregon aftësi udhëheqëse duke ndihmuar kolegët të zhvillojnë kompetencat digjitale dhe duke ndikuar në procesin e vendimmarrjes në shkollë në lidhje me integrimin e teknologjisë.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					
Vlerësimi i fushës: $(T^{18}1+T2+T3)/3 =$					

¹⁸ Norma e vlerësimit të treguesit.



Fusha 2: Burimeve digjitale

2.1.Mësuesi njeh dhe përdor motorë kërkimi dhe të dhëna arsimore, për të gjetur burime digjitale të përshtatshme, në funksion të mësimdhënies dhe të të nxënit.	2.1.1. Mësuesi përdor në mënyrë efektive motorë kërkimi të ndryshëm dhe baza të të dhënave arsimore (ERIC, JSTOR etj.).				
	2.1.2. Mësuesi përdor fjalë kyçe të duhura dhe strategji të përparuara kërkimi.				
	2.1.3. Mësuesi njeh dhe përdor platforma të ndryshme dhe burime të nxëni arsimore të hapura për të gjetur materiale mësimore, video, imazhe dhe lloje të tjera burimesh.				
	2.1.4. Mësuesi përdor burime në gjuhë të ndryshme ose shfrytëzon përkthyesit online për të kuptuar dhe përdorur burime në gjuhë të tjera.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					
2.2.Mësuesi vlerëson, identifikon dhe përdor burime digjitale të sakta, të besueshme dhe të përshtatshme.	2.2.1. Mësuesi vlerëson në mënyrë kritike saktësinë e informacionit nga burimet digjitale, duke shqyrtuar faktet dhe duke krahasuar me të paktën dy burime të tjera të besueshme.				
	2.2.2. Mësuesi analizon burimin e informacionit (autorin, datën e publikimit, besueshmërinë e platformës/faques së internetit) për të siguruar cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit.				
	2.2.3. Mësuesi vlerëson vlefshmërinë dhe aktualitetin e informacionit në raport me qëllimet mësimore dhe standardet kurrikulare, duke siguruar që burimi është i rëndësishëm dhe i përditësuar.				

	2.2.4. Mësuesi përzgjedh burime digjitale që janë të përshtatshme për nivelin e moshës, aftësitë, interesat dhe sfidat e të nxënësve, duke marrë parasysh larminë e tyre.				
	2.2.5. Mësuesi ndërthur burime digjitale që nxisin ndërveprimin, angazhimin dhe të nxënësve aktiv të nxënësve, të cilat janë lehtësisht të përdorshme dhe nga ana teknologjike të përshtatshme me pajisjet në dispozicion.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4+P5)/5) \times 100 =$					
2.3.Mësuesi shfaq aftësinë për të vlerësuar aspektet teknike dhe pedagogjike të burimeve digjitale.	2.3.1. Mësuesi vlerëson burimet digjitale duke marrë parasysh lehtësinë e përdorimit të tyre, integrimin efektiv në procesin mësimor.				
	2.3.2. Mësuesi vlerëson ndikimin e burimeve digjitale në ndërveprimin, angazhimin dhe të nxënësve aktiv të nxënësve.				
	2.3.3. Mësuesi shqyrton cilësinë teknike të burimeve, duke analizuar faktorin pamor si qartësia e imazheve, cilësia e audios dhe videos.				
	2.3.4. Mësuesi shqyrton përshtatshmërinë e burimeve digjitale me pajisjet që ka në dispozicion shkolla apo nxënësit.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					
2.4.Mësuesi shfaq aftësinë për të krijuar materiale mësimore	2.4.1. Mësuesi krijon materiale mësimore digjitale (p.sh., prezantime interaktive, video, kuice) të përshtatshme për nevojat e nxënësve dhe objektivat e kurrikulës, duke siguruar cilësinë				

digjitale, si dhe aftësinë për t'i shpërndarë ato me kolegët dhe nxënësit.	e përmbajtjes dhe përshtatshmërinë pedagogjike.				
	2.4.2. Mësuesi krijon dhe shpërndan burime të hapura edukative (OER), duke përdorur licenca të hapura dhe ndihmon aktivisht në komunitetin arsimor duke i bërë ato të mundshme për përdorim nga të tjerët.				
	2.4.3. Mësuesi shpërndan burime digjitale përmes platformave të ndryshme (p.sh., faqet e internetit të shkollave, LMS, rrjetet sociale profesionale) dhe zgjedh mjetet/platformën më të përshtatshme për audiencën dhe qëllimin.				
	2.4.4. Mësuesi është i vetëdijshëm për rëndësinë e burimeve digjitale të hapura dhe bashkëpunimit në përmirësimin e cilësisë së arsimit.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					
Vlerësimi i fushës: $(T1+T2+T3+T4)/4 =$					
Fusha 3: Mësimdhënia dhe të nxënit e pajisur me teknologji					
3.1.Mësuesi planifikon dhe zgjedh në mënyrë strategjike mjetet dhe platformat digjitale për të arritur qëllimet e qarta të të nxënit dhe për të	3.1.1. Mësuesi përcakton qëllime SMART (<i>Specifike, të Matshme, të Arritshme, të Rëndësishme, të Kufizuara në Kohë</i>) të të nxënit për çdo njësi mësimore dhe planifikon përdorimin e teknologjisë si një mjet thelbësor për arritjen e tyre.				
	3.1.2. Mësuesi përzgjedh në mënyrë të ndërgjegjshme mjetet dhe platformat digjitale (aplikacione, programe, faqe interneti, LMS)				

mbështetur një integrim funksional të teknologjisë.		që mbështesin më mirë arritjen e objektivave të të nxënit dhe i njeh përparësitë/vështirësitë e secilës.				
	3.1.3.	Mësuesi siguron që përdorimi i teknologjisë të jetë i integruar në mënyrë funksionale dhe pedagogjike, jo thjesht si një shtesë, duke ndihmuar në transformimin e qasjes mësimore.				
	3.1.4.	Mësuesi vlerëson rregullisht (p.sh., në fund të çdo kapitulli/teme) ndikimin e teknologjisë në procesin e të nxënit, angazhimin dhe ecurinë e nxënësve, duke përdorur feedback zyrtar dhe jozyrtar.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$						
3.2. Mësuesi zbaton me efektivitet mësimin e përzier (blended learning), duke përshtatur metodologjitë dhe burimet digjitale me infrastrukturën dhe qasjen e nxënësve në teknologji.	3.2.1.	Mësuesi planifikon dhe zbaton qasje të mësimin të përzier, duke drejtpeshuar metodat tradicionale me ato digjitale për të rritur efektivitetin e të nxënit.				
	3.2.2.	Mësuesi analizon dhe merr parasysh realitetin e infrastrukturës digjitale në shkollë dhe qasjen e nxënësve në pajisje dhe internet gjatë planifikimit, duke përshtatur planet mësimore.				
	3.2.3.	Mësuesi ofron në mënyrë paraprake alternativa për nxënësit që nuk kanë qasje të rregullt në teknologji (p.sh., materiale offline, orë shtesë, punë në grup), duke siguruar qasje të barabartë për të gjithë.				



	3.2.4. Mësuesi monitoron dhe vlerëson efektivitetin e metodave të përziera në fund të çdo moduli ose projekti të madh, duke analizuar të dhënat e performancës dhe feedback-un për përmirësim të vazhdueshëm.				
	3.2.5. Mësuesi hulumton risi teknologjike dhe përshtat praktikatat e tij për të përmirësuar përvojën mësimore.				
	3.2.6. Mësuesi planifikon dhe zbaton qasje të mësimin të përzier, duke drejtpeshuar metodat tradicionale me ato digjitale për të rritur efektivitetin e të nxënësit.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4+P5+P6)/6) \times 100 =$					
3.3. Mësuesi krijon dhe menaxhon mjedise mësimore interaktive, tërheqëse dhe të sigurta duke përdorur teknologjinë, duke nxitur bashkëpunimin dhe krijimtarinë.	3.3.1. Mësuesi përdor teknologjinë për të krijuar paraqitje tërheqëse, video edukative, infografi dhe materiale të tjera që e bëjnë mësimin më vizual, ndërveprues dhe tërheqës për nxënësit.				
	3.3.2. Mësuesi shfrytëzon platforma online dhe aplikacione për të ofruar mundësi për të nxënë ndërveprues (p.sh., kuice, lojëra edukative, simulime) dhe krijon veprimtari që nxitin nxënësit të zbulojnë në mënyrë të pavarur.				
	3.3.3. Mësuesi menaxhon në mënyrë efektive pajisjet digjitale, siguron qasje të barabartë dhe mban një mjedis të sigurt dhe respektueshëm online, duke përfshirë menaxhimin e vëmendjes së nxënësve.				
	3.3.4. Mësuesi përdor mjete digjitale për të ofruar detyra sfiduese dhe të personalizuar që				

	adresojnë nevojat dhe nivelet e ndryshme të nxënësve, duke nxitur të nxënit e diferencuar.				
	3.3.5. Mësuesi përdor mjete bashkëpunimi online (p.sh., Google Docs, Teams etj.) për t'i lejuar nxënësit të punojnë së bashku në projekte, të shkëmbejnë ide dhe të ndajnë materiale, duke nxitur kreativitetin e tyre nëpërmjet krijimit të produkteve digjitale.				
	3.3.6. Mësuesi përdor platforma online për të krijuar dhe administruar kuice, teste dhe detyra, duke ofruar feedback të menjëhershëm dhe duke vlerësuar përparimin e nxënësve në mënyrë efikase.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4+P5+P6)/6) \times 100 =$					
Vlerësimi i fushës: $(T1+T2+T3)/3 =$					
Fusha 4: Vlerësimi					
4.1.Mësuesi zhvillon dhe zbaton vlerësimin formues digjital, duke e përshtatur nga ana pedagogjike dhe duke përdorur të dhënat për të përmirësuar në mënyrë dinamike mësimdhënien.	4.1.1. Mësuesi përdor platforma online dhe aplikacione (si Google Forms, Kahoot, Mentimeter, Socrative) për të krijuar dhe menaxhuar veprimtari të vlerësimit të vazhduar ndërvepruese.				
	4.1.2. Mësuesi harton detyra vlerësimi formues që monitorojnë ecurinë e nxënësve, duke përfshirë lloje të ndryshme pyetjesh (p.sh., të hapura, me alternativa, zgjidhje problemesh).				
	4.1.3. Mësuesi siguron që veprimtaritë e vlerësimit të jenë të përshtatura me nivelin dhe nevojat individuale të nxënësve, duke marrë parasysh ndryshueshmërinë e klasës.				

	4.1.4. Mësuesi ndërthur metodat tradicionale të vlerësimit (p.sh., vëzhgimi, diskutimi në klasë) me ato digjitale për të mbledhur informacion të gjithanshëm mbi të nxënit.				
	4.1.5. Mësuesi përdor të dhënat nga vlerësimet formuese për të identifikuar vështirësitë e nxënësve dhe i adreson ato në kohë reale.				
	4.1.6. Mësuesi përshtat teknikat e vlerësimit për të nxitur pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe për të rritur motivimin e tyre.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4+P5+P6)/6) \times 100 =$					
4.2. Mësuesi ofron feedback të menjëhershëm, të personalizuar dhe cilësor duke shfrytëzuar mjetet digjitale.	4.2.1. Mësuesi përdor aplikacione dhe platforma për të dhënë feedback të shpejtë dhe specifik mbi performancën e nxënësve.				
	4.2.2. Mësuesi ofron feedback në formate të ndryshme (p.sh., komente të shkruara, mesazhe zanore, video) për të siguruar qartësi dhe përshtatje me stilin e të nxënit të nxënësve.				
	4.2.3. Mësuesi përdor mjete automatike të korrigjimit për të dhënë përgjigje të menjëhershme dhe për të liruar kohë për feedback cilësor.				
	4.2.4. Mësuesi ofron mundësi për vlerësim nga bashkëmoshatarët dhe vetëvlerësim përmes platformave digjitale, duke nxitur reflektimin e nxënësve.				



	4.2.5. Mësuesi siguron që feedback-u digjital të jetë i dobishëm, i kuptueshëm dhe i orientuar drejt përmirësimit të aftësive dhe njohurive.				
	4.2.6. Mësuesi monitoron mënyrën si nxënësit përdorin feedback-un dhe përshtat strategjitë bazuar në efektivitetin e tij.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4+P5+P6)/6) \times 100 =$					
4.3. Mësuesi analizon thellësisht të dhënat e vlerësimit digjital dhe i përdor ato në mënyrë të planifikuar për të përshtatur dhe diferencuar mësimdhënien.	4.3.1. Mësuesi përdor teknologjinë për të mbledhur, ruajtur, organizuar dhe analizuar të dhënat e vlerësimit në mënyrë efektive.				
	4.3.2. Mësuesi analizon prirjet dhe modelet në performancën e nxënësve për të identifikuar konceptet dhe aftësitë ku ata kanë nevojë për mbështetje shtesë.				
	4.3.3. Mësuesi përdor të dhënat për të diferencuar mësimin dhe për të personalizuar strategjitë mësimore sipas nevojave individuale të nxënësve.				
	4.3.4. Mësuesi planifikon dhe zbaton ndërhyrje specifike për nxënësit me performancë të ulët ose nevoja të veçanta, duke përdorur të dhënat me efikasitet.				
	4.3.5. Mësuesi përdor vizualizime të të dhënave (grafikë, tabela, raporte nga sistemet digjitale) për të reflektuar mbi sukseset, sfidat dhe për të komunikuar ecurinë.				
	4.3.6. Mësuesi ndërvepron me nxënësit dhe prindërit duke përdorur platforma të				

	përshtatshme digjitale për të ndarë rezultatet dhe për të diskutuar strategjitë për përmirësim.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4+P5+P6)/6) \times 100 =$					
4.4. Mësuesi përdor portofolin digjital si një mjet gjithëpërfshirës për vlerësimin e vërtetë, reflektimin dhe komunikimin e ecurisë së nxënësve.	4.4.1. Mësuesi përdor platforma të dedikuara (p.sh., Seesaw, Google Sites, OneNote) për të krijuar dhe menaxhuar portofolet digjitale të nxënësve.				
	4.4.2. Mësuesi nxit dhe udhëzon nxënësit të ruajnë dhe organizojnë në portofol materiale të ndryshme që pasqyrojnë zhvillimin dhe thellësinë e të nxënit (p.sh., ese, projekte, video, prezantime, refleksione).				
	4.4.3. Mësuesi vlerëson performancën e nxënësve bazuar në përmbajtjen e portofolit digjital, duke marrë parasysh zhvillimin e tyre kohor dhe cilësinë e punës.				
	4.4.4. Mësuesi përdor portofolin digjital për të nxitur reflektimin e nxënësve mbi arritjet dhe sfidat e tyre akademike.				
	4.4.5. Mësuesi shfrytëzon mundësinë e portofoleve digjitale për të mbështetur një qasje të vlerësimit alternativ, duke lejuar nxënësit të tregojnë aftësitë dhe përparimin në mënyra krijuese dhe të ndryshme.				
	4.4.6. Mësuesi përdor portofolet digjitale si një mjet transparent dhe bashkëpunues për të ndarë				



	ecurinë e nxënësve me prindërit dhe palët e tjera të interesuara.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4+T5+T6)/6) \times 100 =$					
Vlerësimi i fushës: $(T1+T2+T3+T4)/4 =$					
Fusha 5: Fuqizimi i nxënësve					
5.1.Mësuesi përdor teknologjinë për të fuqizuar aftësitë e nxënësve për të komunikuar dhe bashkëpunuar.	5.1.1. Mësuesi përdor platforma digjitale që mundësojnë komunikimin në kohë reale dhe punën në grup, siç janë forume dhe biseda online.				
	5.1.2. Mësuesi nxit nxënësit të përdorin mjetet digjitale për të ndarë ide, krijuar projekte të përbashkëta dhe për të bashkëpunuar në mënyrë efektive.				
	5.1.3. Mësuesi siguron mundësi për nxënësit të komunikojnë me mësuesit dhe njëri-tjetrin përmes mjeteve digjitale në mënyrë të sigurt dhe të kontrolluar.				
	5.1.4. Mësuesi organizon veprimtari bashkëpunimi që nxisin përdorimin e teknologjisë për të zhvilluar ide të reja dhe për të zgjidhur probleme në grup.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					
5.2.Mësuesi nxit nxënësit të zhvillojnë aftësitë e tyre digjitale për të krijuar, menaxhuar dhe shpërndarë	5.2.1. Mësuesi integron mjete dhe aplikacione për krijimin e materialeve digjitale (video, blogje, prezantime multimediale, infografika, etj.) në funksion të rezultateve të të nxënit.				
	5.2.2. Mësuesi siguron mundësi për nxënësit të krijojnë dhe të shpërndajnë përmbajtje digjitale që lidhen me lëndën e përkatëse,				

përmbajtje digjitale.	duke përdorur platforma të ndryshme (LMS, blogje, galeri online etj.).				
	5.2.3. Mësuesi ndihmon nxënësit të organizojnë dhe menaxhojnë efektivisht përmbajtjen digjitale që ata krijojnë, duke përdorur mjete dhe strategji për ruajtjen, renditjen dhe përdorimin e informacionit.				
	5.2.4. Mësuesi planifikon aktivitete që lejojnë nxënësit të ndajnë punën e tyre me audienca të ndryshme (bashkëmoshatarë, prindër, komuniteti), duke nxitur ndërveprimin dhe marrjen e feedback-ut.				
	5.2.5. Mësuesi vlerëson cilësinë dhe krijimtarinë në përmbajtjen digjitale të nxënësve si një mënyrë për të treguar kuptimin e lëndës dhe zotërimin e aftësive digjitale.				
	5.2.6. Mësuesi udhëzon nxënësit si të përdorin mjete të Inteligjencës Artificiale (IA) (p.sh., gjeneratorë teksti, imazhi, apo prezantimesh) për të ndihmuar në procesin e krijimit të përmbajtjes digjitale, duke theksuar përgjegjësinë për verifikimin dhe përshtatjen e rezultatit të IA-së.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4+P5+P6)/6) \times 100 =$					
5.3.Mësuesi nxit nxënësit për të krijuar përmbajtje digjitale	5.3.1. Mësuesi udhëzon nxënësit për rëndësinë e origjinalitetit, shmangien e plagjiaturës dhe respektimin e etikës digjitale dhe të drejtave të autorit gjatë krijimit dhe ndarjes së përmbajtjes.				

origjinale, të sigurt dhe etike.	5.3.2. Mësuesi nxit nxënësit të jenë të kujdesshëm në shpërndarjen e informacionit vetjk në internet dhe të përdorin mjete të sigurta për komunikim.				
	5.3.3. Mësuesi zhvillon veprimtari që nxisin ndërgjegjësimin për sigurinë online, siç janë trajnimet mbi ndihmën për të identifikuar rreziqe dhe për të shmangur bullizmin kibernetik.				
	5.3.4. Mësuesi përfshin nxënësit në diskutime mbi rregullat dhe përgjegjësitë e përdorimit të teknologjisë dhe internetit në mënyrë të etike.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					
5.4.Mësuesi përdor teknologjinë për të krijuar mjedise mësimore gjithëpërfshirëse dhe të arritshme.	5.4.1. Mësuesi përdor mjete për të përkthyer dhe përshtatur materialet mësimore për nxënësit me nevoja të veçanta.				
	5.4.2. Mësuesi përdor teknologji të përshtatshme që mundësojnë qasje për nxënësit me vështirësi në shikim, dëgjim ose aftësi motorike.				
	5.4.3. Mësuesi krijon mundësi për nxënësit që kanë aftësi të veçanta të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësim, duke ofruar mundësi për mësim të personalizuar.				
	5.4.4. Mësuesi përdor teknologji që mundësojnë përkthimin e materialeve mësimore në gjuhë të tjera për nxënësit që nuk flasin shqipen si gjuhë të parë.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					

5.5.Mësuesi nxit zhvillimin e aftësive të të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve tek nxënësit përmes përdorimit të mjeteve digjitale.	5.5.1. Mësuesi udhëzon nxënësit të përdorin mjete digjitale për të kërkuar, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë kritike informacionin nga burime të shumta online, përfshirë ato të gjeneruara nga IA, duke identifikuar besueshmërinë dhe paragjykimet.				
	5.5.2. Mësuesi nxit nxënësit të përdorin simulime digjitale, programe modelimi ose mjete vizualizimi për të eksploruar skenarë, testuar hipoteza dhe zhvilluar zgjidhje të reja për problemet.				
	5.5.3. Mësuesi zhvillon veprimtari që kërkojnë nga nxënësit të argumentojnë, vlerësojnë dhe reflektojnë në mënyrë kritike mbi informacionin dhe zgjidhjet e gjetura përmes burimeve digjitale.				
	5.5.4. Mësuesi udhëzon nxënësit të përdorin mjete digjitale për të mbledhur dhe analizuar të dhëna, duke i ndihmuar ata të marrin vendime të informuara dhe të bazuar në fakte.				
	5.5.5. Mësuesi nxit nxënësit të reflektojnë mbi procesin e tyre të mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve gjatë punës me mjete digjitale, duke identifikuar strategjitë e suksesshme dhe fushat për përmirësim.				
	5.5.6. Mësuesi angazhon nxënësit në aktivitete ku ata vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin dhe zgjidhjet e gjeneruara nga sistemet e Inteligjencës Artificiale (IA), duke				



	dalluar saktësinë, paragjykimet dhe kufizimet e tyre.				
	5.5.7. Mësuesi nxit nxënësit të përdorin IA-në si një mjet për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve, duke formuluar pyetje efektive, duke kërkuar ide dhe duke përmbledhur informacione të ndërlikuara për të arritur në zgjidhje të reja.				
Vlerësimi i treguesit: ((P1+P2+P3+P4+P5+P6+P7)/7)x100=					
Vlerësimi i fushës: (T1+T2+T3+T4+T5)/5=					
Fusha 6: Lehtësimi i kompetencës digjitale të nxënësve					
6.1.Nxënësit kërkojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike informacionin digjital.	6.1.1. Nxënësit përdorin strategji efektive kërkimi (fjalë kyçe të sakta, operatorë logjikë, filtra) për të gjetur informacion specifik dhe të përshtatshëm nga burime të shumta digjitale.				
	6.1.2. Nxënësit analizojnë besueshmërinë dhe autoritetin e burimeve digjitale (përfshirë datën e publikimit dhe autorësinë) për të vlerësuar cilësinë e informacionit.				
	6.1.3. Nxënësit dallojnë mes fakteve, opinioneve dhe informacioneve të rreme, si dhe vlerësojnë paanësinë dhe saktësinë e atyre që kanë gjetur online.				
	6.1.4. Nxënësit shfrytëzojnë burimet dhe mjetet e ndryshme (përfshirë IA-në) për të shqyrtuar informacionin nga më shumë se një burim dhe për të siguruar saktësinë e tij.				
Vlerësimi i treguesit: ((P1+P2+P3+P4)/4)x100=					



6.2.Nxënësit krijojnë përmbajtje digjitale origjinale, të përshtatshme, etike dhe të sigurt.	6.2.1. Nxënësit përdorin mjete digjitale për të krijuar materiale të ndryshme (prezantime, video, audio, infografika, blogje) në funksion të rezultateve të të nxënit.				
	6.2.2. Nxënësit zbatojnë parimet e origjinalitetit dhe shmangin plagjiaturën, duke respektuar të drejtat e autorit dhe duke cituar burimet siç duhet gjatë krijimit të përmbajtjes.				
	6.2.3. Nxënësit përdorin mjete të Inteligjencës Artificiale (IA) për të ndihmuar në procesin e krijimit të përmbajtjes digjitale, duke shqyrtuar dhe duke përshtatur në mënyrë kritike rezultatin (output) e IA-së.				
	6.2.4. Nxënësit shpërndajnë përmbajtjen digjitale në platforma të përshtatshme, duke marrë parasysh audiencën e synuar dhe duke siguruar respektimin e çështjeve të privatësisë dhe sigurisë.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					
6.3.Nxënësit menaxhojnë dhe organizojnë efektivisht informacionin dhe projektet digjitale.	6.3.1. Nxënësit përdorin aplikacione dhe mjete të menaxhimit të informacionit për të organizuar të dhënat, dokumentet dhe skedarët e tyre digjitalë.				
	6.3.2. Nxënësit krijojnë dhe menaxhojnë dosje dhe nëndosje në mënyrë të strukturuar për ruajtjen dhe përdorimin e lehtë të informacionit.				
	6.3.3. Nxënësit ruajnë informacionin digjital në mënyrë të sigurtë, duke përdorur mjete dhe platforma (p.sh., cloud storage) që				



	mundësojnë kopje rezervë dhe rikthim të lehtë.				
	6.3.4. Nxënësit analizojnë, vlerësojnë dhe interpretojnë informacionin digjital në mënyrë objektive dhe të informuar për t'i përdorur në projekte të ardhshme ose vendimmarrje.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					
6.4. Nxënësit komunikojnë dhe bashkëpunojnë në mënyrë efektive përmes mjeteve digjitale.	6.4.1. Nxënësit përdorin mjete digjitale (e-mail, mesazhe, video-konferenca) për të komunikuar qartë, në kohë reale dhe në mënyrë të respektueshme me bashkëpunëtorët.				
	6.4.2. Nxënësit bashkëpunojnë në projekte grupore duke përdorur mjete digjitale (platforma ndarjeje dokumentesh, menaxhim projekti) për ndarjen e ideve, detyrave dhe feedback-ut.				
	6.4.3. Nxënësit komunikojnë në mënyrë të përshtatshme dhe profesionale përmes mjeteve të rrjeteve sociale, duke kuptuar ndikimin e gjurmës së tyre digjitale.				
	6.4.4. Nxënësit përdorin mjete digjitale për të bashkëpunuar dhe diskutuar në lidhje me projektet, duke ruajtur etikën, respektin për mendimet e të tjerëve dhe duke zgjidhur mosmarrëveshjet.				
	Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$				



6.5.Nxënësit mbrojnë sigurinë dhe privatësinë online dhe demonstrojnë sjellje etike digjitale.	6.5.1. Nxënësit krijojnë fjalëkalime të forta dhe i menaxhojnë ato në mënyrë të sigurt, duke kuptuar rëndësinë e tyre.				
	6.5.2. Nxënësit përdorin cilësimet e privatësisë në platformat online për të mbrojtur informacionin e tyre personal dhe janë të vetëdijshëm për gjurmën e tyre digjitale.				
	6.5.3. Nxënësit identifikojnë rreziqet e mundshme të përdorimit të internetit (p.sh., bullizmi kibernetik, mashtrimet, informacioni i rremë) dhe dinë si të mbrohen/raportojnë.				
	6.5.4. Nxënësit shfaqin sjellje të përgjegjshme, etike dhe të sigurta në mjediset digjitale, duke respektuar të drejtat e të tjerëve dhe normat sociale online.				
Vlerësimi i treguesit: $((P1+P2+P3+P4)/4) \times 100 =$					
Vlerësimi i fushës: $(T1+T2+T3+T4+T5)/5 =$					
Vlerësimi i përgjithshëm: $(F^{19}1+F2+F3+F4+F5+F6)/6 =$					

¹⁹ Norma e vlerësimit të fushës

Formati i platformës së vlerësimit

Platforma vlerësimit hartohet në përputhje të plotë me “Metodologjinë e Vlerësimit të Jashtëm të Shkollës, ASCAP, 2020”, duke siguruar një qasje koherente dhe standardizuar në procesin e vlerësimit të kompetencave digjitale të mësuesve. Fushat dhe treguesit e përzgjedhur reflektojnë fokusin specifik të vlerësimit të nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

PLATFORMË VLERËSIMI

A. QËLLIMI

Vlerësimi i shkollës për nivelin e kompetencave digjitale të mësuesve, me qëllim identifikimin e pikave të forta dhe dobësive, mbështetjen e zhvillimit profesional të mësuesve në përdorimin e TIK në mësimdhënie, si dhe përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe të nxënësve nëpërmjet integritetit efektiv të teknologjisë.

B. BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSh”, i ndryshuar.
- “Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”.



- Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar.
- Udhëzimi i përbashkët nr. 13, datë 10.07.2024, “Për vitin shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar”.
- Metodologjia e vlerësimit të nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve.
- Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës, ASCAP 2020.
- Udhëzuesi “Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës”, ASCAP, 2020.
- “Metodologjia e vlerësimit të jashtëm të shkollës”, ASCAP, 2020.
- “Metodologjia e vlerësimit të brendshëm të shkollës”, ASCAP, 2020.
- Etj.....

C. DREJTIMET E VLERËSIMIT

Fusha 1: Angazhimi profesional

Treguesit:

- Mësuesit përdorin mjete digjitale për komunikimin profesional.
- Etj.....

Fusha 2: Burimet digjitale

Treguesit:

- Mësuesit kërkojnë dhe zgjedhin burime digjitale të përshtatshme për mësimdhënien.
- Etj.....

Fusha 3: Mësimdhënia dhe të nxënit e pajisur me teknologji

Treguesit:

- Mësuesit planifikojnë mësimdhënien duke integruar teknologjinë.
- Etj.....

Fusha 4: Vlerësimi i nxënësve

Treguesit:



- Mësuesit përdorin mjete digjitale për vlerësimin formues të nxënësve.
- Etj.....

Fusha 5: Fuqizimi i nxënësve

Treguesit:

- Mësuesit ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë kompetencat e tyre digjitale.
- Etj.....

Fusha 6: Zgjidhja e problemeve dhe zhvillimi i kompetencave të reja

Treguesit:

- Mësuesit identifikohen me problemet teknike dhe kërkojnë zgjidhje.
- Etj.....

D. METODOLOGJIA

- Takime me drejtues të shkollës, ekipet lëndore, mësues, nxënës dhe prindër;
- Studimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit;
- Vëzhgime dhe analiza të orëve mësimore.
- Zhvillimi i pyetësorëve, anketave, fokusgrupeve me nxënës, mësues dhe prindër;
- Takim përmbyllës me drejtorinë e shkollës dhe stafin e shkollës.
- Etj....

E. INSTITUCIONI QË DO TË VLERËSOHET

- _____

F. KOHA E REALIZIMIT TË VLERËSIMIT

- _____

G. PËRBËRJA E EKIPIT TË VLERËSIMIT



H. RAPORTI I VLERËSIMIT DO T'I DORËZOHET

- Ministrisë së Arsimit dhe Sportit
- Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
- Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar
- Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, përkatëse
- Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, përkatëse
- Shkollës së vlerësuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

EMËR MBIEMËR

*Për të siguruar transparencë dhe qartësi maksimale, kësaj platforme i **bashkëlidhet gjithmonë instrumenti i detajuar i vlerësimit**, i cili përmban **fushat dhe treguesit specifikë të përzgjedhur**. Kjo qasje garanton që procesi i vlerësimit të jetë tërësisht i kuptueshëm dhe i verifikueshëm për të gjitha palët e interesuara.*



Formati i raportit të vlerësimit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DREJTORIA E VLERËSIMIT TË CILËSISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.2024

Lënda: Raporti i vlerësimit i shkollës për nivelin e kompetencave digjitale të mësuesve, me qëllim identifikimin e pikave të forta dhe dobësive, mbështetjen e zhvillimit profesional të mësuesve në përdorimin e TIK në mësimdhënie, si dhe përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe të nxënës, nëpërmjet integritetit efektiv të teknologjisë.

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

Rruga e Durrësit, nr. 23

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Rruga “Aleksandër Moisiu”, Tiranë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____

Rruga “_____”

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____

Rruga _____

SHKOLLËS “_____”

Rruga: “_____”

A. Qëllimi i vlerësimit: Vlerësimi i shkollës për nivelin e kompetencave digjitale të mësuesve, me qëllim identifikimin e pikave të forta dhe dobësive, mbështetjen e zhvillimit profesional të mësuesve në përdorimin e TIK në mësimdhënie, si dhe përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe të nxënës nëpërmjet integritetit efektiv të teknologjisë.

I. BAZA LIGJORE

- Ligji nr. 69, datë 21.06.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSh”, i ndryshuar.



- “Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020.
- Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, “Për numrin e nxënësve për klasë dhe ngarkesën mësimore të punonjësve arsimorë në institucionet e arsimit parauniversitar”.
- Udhëzimi nr. 17, datë 05.07.2022, “Për vlerësimin e nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar”, i ndryshuar.
- Udhëzimi i përbashkët nr. 13, datë 10.07.2024, “Për vitin shkollor 2024-2025 në sistemin arsimor parauniversitar”.
- Metodologjia e vlerësimit të nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve.
- Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Shkollës, ASCAP 2020.
- Udhëzuesi “Vlerësimi i jashtëm dhe i brendshëm i shkollës”, ASCAP, 2020.
- “Metodologjia e vlerësimit të jashtëm të shkollës”, ASCAP, 2020.
- “Metodologjia e vlerësimit të brendshëm të shkollës”, ASCAP, 2020.
- Etj.....

B. DREJTIMET E VLERËSIMIT

Fusha 1: Angazhimi profesional

Treguesit:

- Mësuesit përdorin mjete digjitale për komunikimin profesional.
- Etj.....

Fusha 2: Burimet digjitale

Treguesit:

- Mësuesit kërkojnë dhe zgjedhin burime digjitale të përshtatshme për mësimdhënien.
- Etj.....

Fusha 3: Mësimdhënia dhe të nxënit e pajisur me teknologji

Treguesit:

- Mësuesit planifikojnë mësimdhënien duke integruar teknologjinë.



- Etj.....

Fusha 4: Vlerësimi i nxënësve

Treguesit:

- Mësuesit përdorin mjete digjitale për vlerësimin formues të nxënësve.
- Etj.....

Fusha 5: Fuqizimi i nxënësve

Treguesit:

- Mësuesit ndihmojnë nxënësit të zhvillojnë kompetencat e tyre digjitale.
- Etj.....

Fusha 6: Zgjidhja e problemeve dhe zhvillimi i kompetencave të reja

Treguesit:

- Mësuesit identifikohen me problemet teknike dhe kërkojnë zgjidhje.
- Etj.....

J. METODOLOGJIA

- Takime me drejtues të shkollës, ekipet lëndore, mësues, nxënës dhe prindër;
- Studimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit;
- Vëzhgime dhe analiza të orëve mësimore.
- Zhvillimi i pyetësorëve, anketave, fokusgrupeve me nxënës, mësues dhe prindër;
- Takim përmbyllës me drejtorinë e shkollës dhe stafin e shkollës.
- Etj....

K. INSTITUCIONI I VLERËSUAR

- _____

L. KOHA E REALIZIMIT TË VLERËSIMIT



- _____

▪ INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Në këtë rubrikë jepet një informacion i përgjithshëm i shkollës, duke u fokusuar edhe në trajnimet e mësuesve për kompetencat digjitale dhe infrastrukturën digjitale të shkollës.

▪ GJETJE DHE GJYKIME

Në këtë rubrikë jepen gjetjet dhe gjykimet për secilën fushë dhe tregues të përzgjedhur, bazuar në të gjitha të dhënat e mbledhura dhe të analizuara, përkatësisht:

Fusha 1: Angazhimi profesional

Treguesit:

- Mësuesit përdorin mjete digjitale për komunikimin profesional.
- Etj.....

Gjetje dhe gjykime për secilin tregues

Vlerësimi i treguesve sipas shkallës së cilësisë.

Vlerësimi i fushës sipas shkallës së cilësisë

Etj.....

Fusha 2: Burimet digjitale

Treguesit:

- Mësuesit kërkojnë dhe zgjedhin burime digjitale të përshtatshme për mësimdhënien.
- Etj.....

Gjetje dhe gjykime për secilin tregues

Vlerësimi i treguesve sipas shkallës së cilësisë.

Vlerësimi i fushës sipas shkallës së cilësisë



Etj.....

Në fund të rubrikës “Gjetje dhe gjykime”, jepet vlerësimi i përgjithshëm i shkollës, sipas shkallës së cilësisë.

▪ **PËRFUNDIME**

Në këtë rubrikë jepet një përmbledhje e pikave të forta dhe dobësitë të mësuesve në lidhje me nivelin e kompetencave digjitale të tyre, për çdo fushë, sipas treguesve të përzgjedhur..

▪ **REKOMANDIME**

Në këtë rubrikë jepen udhëzime konkrete për fuqizimin e nivelit të kompetencave digjitale të mësuesve, duke përcaktuar personat përgjegjës dhe afatet kohore.

GRUPI I VLERËSIMIT

*Për të siguruar transparencë dhe qartësi maksimale, raporti i **bashkëlidhet gjithmonë instrumenti i detajuar i vlerësimit**, i cili përmban **fushat dhe treguesit specifikë të përzgjedhur dhe të vlerësuar sipas shkallës së vlerësimit të përcaktuar në këtë metodologji.***



Pyetësorë për prindërit, nxënësit dhe mësuesit

Pyetësorë me prindërit në lidhje perceptimet e tyre mbi kompetencat digjitale në arsim

Të nderuar prindër,

Ky pyetësor është hartuar me qëllim që të mbledhë informacione të vlefshme mbi perceptimet tuaja në lidhje me integrimin e teknologjisë digjitale në edukimin e fëmijëve tuaj në arsimin parauniversitar. Mendimi juaj është thelbësor për të kuptuar më mirë rolin e teknologjisë në procesin mësimor dhe për të vlerësuar kompetencat digjitale të mësuesve, si faktor kyç në përgatitjen e brezit të ri për sfidat e epokës digjitale. Ju lutemi të përgjigjeni me sinqeritet në secilën pyetje, duke zgjedhur variantin që reflekton më së miri mendimin tuaj. Për pyetjet që përdorin shkallë vlerësimi, ju lutemi të ndiqni udhëzimet e dhëna.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj të çmuar.

1. Deri në çfarë mase jeni të njohur me termin “kompetenca digjitale” në kontekstin e arsimit?

- a) Aspak i/e njohur
- b) Pak i/e njohur
- c) Mesatarisht i/e njohur
- d) Shumë i/e njohur
- e) Shumë tepër i/e njohur

2. Sipas jush, sa e rëndësishme është që mësuesit e fëmijës/fëmijëve tuaj të kenë kompetenca të larta digjitale?

- a) Aspak e rëndësishme
- b) Pak e rëndësishme
- c) Mesatarisht e rëndësishme
- d) Shumë e rëndësishme
- e) Shumë tepër e rëndësishme

3. A keni vënë re përdorimin e mjeteve digjitale nga mësuesit në procesin mësimor të fëmijës/fëmijëve tuaj?



- a) Gjithmonë
- b) Shpesh
- c) Ndonjëherë
- d) Asnjëherë

4. Nëse po, cilat nga mjetet e mëposhtme digjitale keni vënë re më shpesh të përdoren nga mësuesit? (Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)

- a) Platforma online për shpërndarjen e materialeve
- b) Aplikacione interaktive për mësim
- c) Mjete për vlerësim online
- d) Programe për prezantime
- e) Mjete për bashkëpunim (p.sh., Google Docs)
- f) Të tjera (Ju lutemi specifikoni)

5. Sa shpesh komunikoni me mësuesit e fëmijës/fëmijëve tuaj përmes mjeteve digjitale (p.sh., email, platforma shkollore)?

- a) Gjithmonë
- b) Shpesh
- c) Ndonjëherë
- d) Asnjëherë

6. Sipas jush, a i përdorin mësuesit në mënyrë efektive mjetet digjitale për të përmirësuar angazhimin e nxënësve në mësim?

- a) Gjithmonë
- b) Shpesh
- c) Ndonjëherë
- d) Asnjëherë

7. A mendoni se mësuesit e fëmijës/fëmijëve tuaj kanë aftësitë e nevojshme për të krijuar materiale mësimore digjitale cilësore?

- a) Gjithmonë
- b) Shpesh



- c) Ndonjëherë
- d) Asnjëherë

8. *Sa të sigurt ndiheni që mësuesit i udhëzojnë fëmijët tuaj për përdorimin e sigurt dhe etik të internetit?*

- a) Shumë i sigurt
- b) I sigurt
- c) Mesatarisht i sigurt
- d) Pak i sigurt
- e) Aspak i sigurt

9. *A mendoni se përdorimi i teknologjisë nga mësuesit ndihmon në personalizimin e mësimit për fëmijën/fëmijët tuaj?*

- a) Shumë i sigurt
- b) I sigurt
- c) Mesatarisht i sigurt
- d) Pak i sigurt
- e) Aspak i sigurt

10. *Sa të kënaqur jeni me mënyrën se si shkolla përdor teknologjinë për të komunikuar me ju si prindër?*

- a) Shumë i kënaqur
- b) I kënaqur
- c) Mesatarisht i kënaqur
- d) I pakënaqur
- e) Shumë i pakënaqur

11. *A keni vënë re ndonjë ndryshim në motivimin e fëmijës/fëmijëve tuaj për të mësuar si rezultat i përdorimit të teknologjisë në klasë?*

- a) Rritje të motivimit
- b) Pak ndryshim
- c) Rënie të motivimit



d) Nuk kam vënë re ndryshim

12. A mendoni se mësuesit e fëmijës/fëmijëve tuaj janë të përgatitur mirë për të përdorur teknologjinë në rast të mësimit në distancë?

- a) Plotësisht dakord
- b) Dakord
- c) Pjesërisht dakord
- d) Nuk jam dakord
- e) Aspak dakord

13. Sa e rëndësishme mendoni se është që shkolla të investojë në zhvillimin profesional të mësuesve në fushën e kompetencave digjitale?

- a) Shumë e rëndësishme
- b) E rëndësishme
- c) Mesatarisht e rëndësishme
- d) Pak e rëndësishme
- e) Aspak e rëndësishme

14. A keni marrë ndonjëherë informacion nga shkolla në lidhje me përdorimin e sigurt të internetit për fëmijët?

- a) Gjithmonë
- b) Shpesh
- c) Ndonjëherë
- d) Asnjëherë

15. Sipas jush, a i përdorin mësuesit mjetet digjitale për të vlerësuar progresin e nxënësve në mënyra inovative dhe tërheqëse?

- a) Gjithmonë
- b) Shpesh
- c) Ndonjëherë
- d) Asnjëherë



16. A mendoni se mësuesit e fëmijës/fëmijëve tuaj e kuptojnë ndikimin e teknologjisë në zhvillimin njohës dhe social të fëmijëve?

- a) Shumë i sigurt
- b) I sigurt
- c) Mesatarisht i sigurt
- d) Pak i sigurt
- e) Aspak i sigurt

17. Sa e rëndësishme mendoni se është që nxënësit të zhvillojnë kompetenca digjitale gjatë arsimimit të tyre parauniversitar?

- a) Shumë e rëndësishme
- b) E rëndësishme
- c) Mesatarisht e rëndësishme
- d) Pak e rëndësishme
- e) Aspak e rëndësishme

18. Sa të informuar ndiheni në lidhje me politikat e shkollës për përdorimin e teknologjisë digjitale?

- a) Shumë i informuar
- b) I informuar
- c) Mesatarisht i/e informuar
- d) Pak i/e informuar
- e) Aspak i informuar

19. Në përgjithësi, sa të kënaqur jeni me integrimin e teknologjisë digjitale në arsimin e ofruar nga shkolla e fëmijës/fëmijëve tuaj?

- a) Shumë i kënaqur
- b) I kënaqur
- c) Mesatarisht i/e kënaqur
- d) I pakënaqur
- e) Shumë i pakënaqur



20. A keni ndonjë sugjerim specifik për shkollën ose mësuesit në lidhje me përmirësimin e përdorimit të teknologjisë në arsim? (Përgjigje e hapur)



Pyetësorë me nxënësit, në lidhje me përvojat e tyre përdorimin e TIK në mësim

Të dashur nxënës,

Ky pyetësor është krijuar për të dëgjuar zërin tuaj në lidhje me përdorimin e teknologjisë në shkollë. Ne duam të kuptojmë se si mësuesit tuaj përdorin mjetet digjitale dhe si ndikon kjo në mënyrën tuaj të të nxënit. Përgjigjet tuaja do të jenë shumë të vlefshme për të bërë mësimin me teknologji sa më të mirë për të gjithë. Ju lutemi të jeni sa më të sinqertë dhe të zgjidhni përgjigjen që ju duket më e drejtë. Për pyetjet me numra, zgjidhni numrin që tregon më mirë mendimin tuaj. Ju falënderojmë për bashkëpunimin!

1. Sa shpesh përdorni pajisje digjitale (si kompjuter, tablet, telefon) për të mësuar në shkollë?

- a) Çdo ditë
- b) Shpesh
- c) Rrallë
- d) Asnjëherë

2. A përdorin mësuesit tuaj shpesh mjete digjitale gjatë orës së mësimi?

- a) Çdo ditë
- b) Shpesh
- c) Rrallë
- d) Asnjëherë

***3. Cilat nga mjetet e mëposhtme digjitale përdorin më shpesh mësuesit tuaj në klasë?
(Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)***

- a) Platforma online për materialet e mësimi
- b) Aplikacione interaktive për ushtrime dhe lojëra
- c) Mjete për të bërë teste dhe kuize online
- d) Software për prezantime (p.sh., PowerPoint)
- e) Mjete për të punuar së bashku me shokët (p.sh., Google Docs)
- f) Video dhe animacione edukative
- g) Të tjera (Ju lutemi specifikoni)



4. *Sa e lehtë është për ju të përdorni mjetet digjitale që përdorin mësuesit tuaj?*
- a) Shumë e lehtë
 - b) E lehtë
 - c) E vështirë
 - d) Shumë e vështirë
5. *A ju ndihmojnë mjetet digjitale të kuptoni më mirë materialin e mësimit?*
- a) Më ndihmojnë plotësisht
 - b) Më ndihmojnë shpesh
 - c) Më ndihmojnë ndonjëherë
 - d) Nuk më ndihmojnë aspak
6. *A i bëjnë mësimit më interesante dhe argëtuese mjetet digjitale?*
- a) Gjithmonë
 - b) Shpesh
 - c) Ndonjëherë
 - d) Asnjëherë
7. *A ju japin mësuesit tuaj mundësi të përdorni teknologjinë për të krijuar projektet tuaja?*
- a) Po, shpesh
 - b) Ndonjëherë
 - c) Rrallë
 - d) Asnjëherë
8. *A ju kanë mësuar mësuesit tuaj se si të përdorni internetin në mënyrë të sigurt dhe të përgjegjshme?*
- a) Po, shumë
 - b) Po, pak
 - c) Jo
 - d) Nuk e mbaj mend



9. A ju ndihmojnë mjetet digjitale të merrni reagime nga mësuesit tuaj për punën tuaj?

- a) Po, shpesh
- b) Ndonjëherë
- c) Rrallë
- d) Asnjëherë

10. A ju pëlqen kur mësuesit përdorin teknologjinë për të vlerësuar njohuritë tuaja (p.sh., teste online, kuize interaktive)?

- a) Po, shumë
- b) Po, pak
- c) Jo
- d) Nuk më intereson

11. A ju japin mësuesit tuaj mundësi të bashkëpunoni me shokët tuaj duke përdorur mjete digjitale?

- a) Po, shpesh
- b) Ndonjëherë
- c) Rrallë
- d) Asnjëherë

12. A mendoni se mësuesit tuaj janë të aftë të përdorin teknologjinë për të shpjeguar gjëra të ndryshme në mënyra të reja (për shembull, video, simulime)?

- a) Po, shumë
- b) Po, pak
- c) Jo
- d) Nuk e di

13. A ju ndihmojnë mjetet digjitale të organizoni më mirë detyrat dhe materialet e shkollës?

- a) Po, shumë
- b) Po, pak
- c) Jo
- d) Nuk e di



14. A mendoni se shkolla juaj ka pajisje dhe internet të mjaftueshëm për të përdorur teknologjinë në mësim?

- a) Po, shumë
- b) Po, pak
- c) Jo
- d) Nuk e di

15. A ju kanë kërkuar ndonjëherë mësuesit tuaj të vlerësoni burimet digjitale që përdorni (p.sh., nëse janë të besueshme)?

- a) Po, shpesh
- b) Ndonjëherë
- c) Rrallë
- d) Asnjëherë

16. A mendoni se mësuesit tuaj e kuptojnë rëndësinë e zhvillimit të aftësive tuaja digjitale për të ardhmen?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk e di

17. A ju pëlqen të përdorni teknologjinë për të mësuar në shkollë?

- a) Po, shumë
- b) Po, pak
- c) Jo
- d) Nuk më intereson

18. Në përgjithësi, sa ju ndihmon teknologjia në shkollë të mësoni më mirë?

- a) Shumë
- b) Majftueshëm
- c) Pak
- d) Aspak



19. Cilat janë disa gjëra që mësuesit tuaj bëjnë mirë kur përdorin teknologjinë në mësim?

20. Çfarë mund të bëjnë mësuesit tuaj më mirë kur përdorin teknologjinë në mësim?



Pyetësorë me mësuesit, në lidhje me përvetësimin e kompetencave digjitale të tyre

Të nderuar mësues,

Ju ftojme të merrni pjesë në këtë pyetësor, i cili ka për qëllim të vlerësojë kompetencat digjitale tona si profesionistë të arsimit parauniversitar. Përgjigjet tuaja do të jenë të vlefshme për të kuptuar më mirë nivelin aktual të përdorimit të teknologjisë në praktikën mësimore dhe për të nxitur përmirësimin e vazhdueshëm. Ju lutemi të lexoni çdo pyetje me kujdes dhe të zgjidhni opsionin që ju përshtatet më mirë, duke përdorur shkallën e vlerësimit kur është e aplikueshme. Ju falënderojmë për kohën dhe kontributin tuaj të vyer.

1. Cila është mosha juaj?

- a) Nën 30 vjeç
- b) 30-40 vjeç
- c) 41-50 vjeç
- d) 51-60 vjeç
- e) Mbi 60 vjeç

2. Cila është eksperiencia juaj në mësimdhënie?

- a) Nën 5 vjet
- b) 5-15 vjet
- c) 16-25 vjet
- d) Mbi 25 vjet

3. Cila është lënda/lëndët tuaja të mësimdhënies?

4. Sa vetëvlerësoni nivelin tuaj të përgjithshëm të kompetencave digjitale për përdorim në kontekstin arsimor?

- a) Shumë i lartë (Ekspert)
- b) I lartë (Kompetent)
- c) Mesatar (Zhvillues)
- d) I ulët (Fillestar)
- e) Shumë i ulët (Nuk kam fare kompetenca digjitale)



5. Sa shpesh përdorni teknologjinë digjitale në praktikën tuaj të përditshme mësimore?

- a) Gjithmonë (çdo ditë dhe në shumicën e orëve)
- b) Shpesh (disa herë në javë)
- c) Nganjëherë (disa herë në muaj)
- d) Rrallë (më pak se një herë në muaj)
- e) Asnjëherë

6. Në cilat nga aktivitetet e mëposhtme përdorni rregullisht mjetet digjitale? (Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)

- a) Kërkimi i burimeve arsimore online (p.sh., artikuj, video, simulime)
- b) Përgatitja e materialeve mësimore (p.sh., prezantime digjitale, fletore pune interaktive)
- c) Komunikimi me nxënësit dhe prindërit (p.sh., email, platforma shkollore, grupe komunikimi)
- d) Vlerësimi formues/i vazhduar (p.sh., kuize online, sondazhe, forume diskutimi)
- e) Vlerësimi përmbledhës (p.sh., teste online, dorëzimi i detyrave në platforma digjitale)
- f) Bashkëpunimi me kolegët (p.sh., shkëmbimi i burimeve, projekte të përbashkëta online)
- g) Menaxhimi i klasës (p.sh., regjistri digjital, njoftime online, planifikimi i orës)
- h) Zhvillimi profesional (p.sh., kurse online, webinare, konferenca virtuale)
- i) Krijimi i përmbajtjeve interaktive (p.sh., video, audio, animacione, simulime)
- j) Të tjera (Ju lutemi specifikoni): _____

7. Sa i aftë ndiheni në përdorimin e platformave online për menaxhimin e të nxënit (LMS) si Moodle, Google Classroom etj.?

- a) Shumë i aftë
- b) I aftë
- c) Mjaftueshëm
- d) Dobët
- e) Aspak i aftë



8. *Sa i aftë ndiheni në krijimin dhe modifikimin e burimeve arsimore digjitale (p.sh., video, audio, infografika, prezantime me animacione)?*
- a) Shumë i aftë
 - b) I aftë
 - c) Mjaftueshëm
 - d) Dobët
 - e) Aspak i aftë
9. *Sa i sigurt ndiheni në përdorimin e internetit dhe mjeteve digjitale në lidhje me sigurinë kibernetike dhe privatësinë e të dhënave (p.sh., njohja e phishing-ut, fjalëkalimet e forta, cilësimet e privatësisë)?*
- a) Shumë i sigurt
 - b) I sigurt
 - c) Mesatarisht i sigurt
 - d) Pak i sigurt
 - e) Aspak i sigurt
10. *Sa shpesh i ndihmoni nxënësit tuaj të zhvillojnë kompetencat e tyre digjitale (p.sh., kërkimi i informacionit online, vlerësimi i besueshmërisë së burimeve, sjellja etike online)?*
- a) Gjithmonë (Në çdo orë mësimi ku ka vend)
 - b) Shpesh (Disa herë në javë)
 - c) Nganjëherë (Disa herë në muaj)
 - d) Rrallë (Më pak se një herë në muaj)
 - e) Asnjëherë
11. *Sa i aftë ndiheni në përdorimin e mjeteve digjitale për vlerësimin formativ dhe feedback-un e menjëhershëm për nxënësit?*
- a) Shumë i aftë
 - b) I aftë
 - c) Mjaftueshëm
 - d) Dobët
 - e) Aspak i aftë



12. Sa i aftë ndiheni në personalizimin e mësimin për nxënësit me nevoja të ndryshme përmes teknologjisë digjitale?

- a) Shumë i aftë (Mund të përdor teknologjinë për të përshtatur mësimin për çdo nxënës)
- b) I aftë (Mund të përdor teknologjinë për disa grupe nxënësish)
- c) Mjaftueshëm (Mund të përdor teknologjinë për nevoja shumë bazë)
- d) Dobët (Nuk e di si ta bëj)
- e) Aspak i aftë

13. A keni marrë pjesë në trajnime specifike për zhvillimin e kompetencave digjitale në mësimdhënie gjatë 3 viteve të fundit?

- a) Po, shpesh
- b) Po, disa herë
- c) Po, një herë
- d) Jo, asnjëherë

14. Nëse po, sa efektiv i keni vlerësuar këto trajnime?

- a) Shumë efektiv
- b) Efektiv
- c) Mesatarisht efektiv
- d) Pak efektiv
- e) Jo efektiv

15. Cilat janë fushat kryesore në të cilat ndjeni nevojë për trajnim shtesë në lidhje me kompetencat digjitale? (Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)

- a) Përdorimi i platformave të menaxhimit të të nxënës (LMS)
- b) Krijimi i materialeve interaktive (video, audio, simulime)
- c) Vlerësimi digjital dhe feedback-u
- d) Siguria kibernetike dhe privatësia online
- e) Kërkimi dhe vlerësimi i burimeve digjitale
- f) Përdorimi i teknologjisë për bashkëpunim dhe projekte me nxënësit
- g) Inkluziviteti digjital (përshtatja e teknologjisë për nxënësit me nevoja të veçanta)
- h) Programimi bazik/mendimi kompjuterik
- i) Përdorimi i inteligjencës artificiale (AI) në mësimdhënie
- j) Të tjera (Ju lutemi specifikoni): _____



16. Cilat janë sfidat kryesore me të cilat përballeni në integrimin e teknologjisë digjitale në mësimdhënie? (Mund të zgjidhni më shumë se një përgjigje)

- a) Mungesa e pajisjeve/infrastrukturës së duhur (internet i dobët, pajisje të vjetra)
- b) Mungesa e trajnimeve të mjaftueshme
- c) Mungesa e kohës për të planifikuar dhe përgatitur orë mësimi me teknologji
- d) Rezistenca nga kolegët ose nxënësit/prindërit
- e) Kurrikula nuk e mbështet mjaftueshëm përdorimin e teknologjisë
- f) Mungesa e mbështetjes teknike
- g) Shqetësimet rreth sigurisë dhe privatësisë së të dhënave
- h) Vështirësi në gjetjen e burimeve cilësore digjitale
- i) Mungesa e motivimit personal
- j) Të tjera (Ju lutemi specifikoni): _____

17. Në ç'masë mendoni se përdorimi i teknologjisë digjitale rrit angazhimin e nxënësve në mësim?

- a) Shumë
- b) Mjaftueshëm
- c) Pak
- d) Aspak

18. Në ç'masë ndiheni të mbështetur nga institucioni juaj (shkolla/drejtoria) për zhvillimin e kompetencave tuaja digjitale?

- a) Shumë i mbështetur
- b) I mbështetur
- c) Mesatarisht i mbështetur
- d) Pak i mbështetur
- e) Aspak i mbështetur

19. Në ç'masë mendoni se kompetencat digjitale janë thelbësore për mësuesit në ditët e sotme?

- a) Plotësisht thelbësore
- b) Shumë thelbësore
- c) Mesatarisht thelbësore
- d) Pak thelbësore
- e) Aspak thelbësore



20. Cili është sugjerimi juaj kryesor ose dëshira më e madhe në lidhje me mbështetjen e mësuesve për të përmirësuar kompetencat digjitale në shkollën tuaj ose në nivel kombëtar?

21. A ka diçka tjetër që dëshironi të shtoni në lidhje me përvojën tuaj me teknologjinë digjitale në mësimdhënie, që nuk u mbulua nga pyetjet e mësipërme?





www.ascap.edu.al